

1 E enjte, 7 dhjetor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare, ju lutemi paraqitni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita të nderuar

8 Gjykatës, kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-06, Prokurori i

9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep

10 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit, të nderuar

11 Gjykatës.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ende jo.

13 Z. KEHOE: [Mikrofoni çaktivizuar]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kërkesa e

15 Thaçit dhe Krasniqit për të shtuar materialet në listën e

16 prezantimit do të pranohet, do të lejohet, nuk është dorëzuar

17 asnjë kundërshtim nga Prokuroria. Ka dy materiale nga ekipi i

18 Krasniqit dhe një material nga ekipi i Thaçit.

19 Mundet, po. Materiali juaj.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Desha vetëm t'ju kërkoj në bazë të

21 sugjerimit të Gjykatësit Gaynor për të korrigjuar artikullin e

22 gazetës, e kemi në fakt korrigjuar, të nderuar Gjykatës, dhe e

23 kemi shtuar dhe ngarkuar me numër DNT02782 [Sipas përkthimit]

24 deri në DHT02782. Dhe për referencën, është përkthim i një

25 artikulli të *Kurir*, të nderuar Gjykatës, e përdorëm si

1 referencë dje, do ta ofrojmë këtë për prova me kopje të
2 korrigjuar.

3 Kërkoj ndjesë dhe për gabimin në shkrimin e kësaj.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të
5 fillojmë me dëshmitarin, Trupi Gjykses do të trajtojë disa
6 çështje të tjera që kanë të bëjnë me kërkesat për leje për
7 apel të cilat ende nuk kanë marrë përgjigje në formë vendimi.

8 Së pari, e kam fjalën për kërkesën e përbashkët të
9 Mbrojtjes për leje për të apeluar vendimin e Trupit Gjykses me
10 numër 1963 për pranimin e dokumenteve që i janë treguar
11 dëshmitarit të Prokurorisë me numër 4769.

12 Trupi Gjykses mban parasysh periudhën e ardhshme të
13 pushimit të Gjykatës dhe vëren se sipas Rregullores dhe sipas
14 kalendarit kjo do të kishte mbivendosje me periudhën e
15 pushimit dhe do të përbënte një pamundësi serioze për
16 përfaqësuesit e të dyja palëve.

17 Kështu që në varësi të ndonjë kundërshtimi, Trupi Gjykses
18 mban parasysh zgjatjen, mban parasysh edhe kalendarin në formë
19 *proprio motu*. Trupi Gjykses propozon që të caktojë afatin për
20 përgjigjen e ZPS-së deri më 12 janar 2024, e cila do të
21 thoshte se kundërpërgjigjet do të duhet që të dorëzoheshin
22 brenda të martës 16 janar.

23 Kjo është ideja. Ka ndonjë kundërshtim?

24 Asnjë prej palëve nuk ka kundërshtim. Në rregull,
25 vazhdojmë atëherë. Ju faleminderit shumë.

1 Në vartësi të urdhrit të parë gojor sipas rregullës
2 99(5) (a) të Rregullores, Trupi Gjykses zgjat afatin për çdo
3 përgjigje ndaj parashtrimit të protokolluar F01892 deri të
4 martën 9 janar 2024, dhe urdhëron që kundërpërgjigjet të
5 dorërohen brenda të martës 16 janar 2024.

6 Duhet informuar Mbrojtja -- Mbrojtja duhet të informojë
7 Trupin Gjykses jo më vonë se 11 janar 2024 nëse dëshiron që të
8 dorëzojë një kundërpërgjigje.

9 Këtu mbyllet ky urdhri i lëshuar gojarisht.

10 Së dyti, Trupi Gjykses ka përpara tij kërkesat e
11 Mbrojtjes për z. Krasniqi dhe Selimi për, ku kërkohet leje për
12 të apeluar një vendim të Trupit Gjykses me numër 1917 për
13 pranimin e deklaratave të të akuzuarve.

14 Trupi Gjykses dëshiron të informojë palët se pavarësisht
15 nga periudha e pushimit të Gjykatës, që pritet të fillojë tani
16 shpejt, Trupi Gjykses synon që të mbajë të njëjtin kalendar
17 informues sipas rregullave 76 dhe 77 dhe Trupi Gjykses do të
18 lëshojë vendimin në përputhje me rregullën 77(3).

19 Trupi Gjykses dëshiron gjithashtu të dëgjojë shkurtimisht
20 nga z. Kehoe dhe nga Avokatët e tjerë për çmuarjet që kanë për
21 pyetjet që do ia bëjnë dëshmitarit të palës thirrëse në
22 veçanti për këtë dëshmitar në mënyrë që, pra, që do të kthehet
23 javën e ardhshme.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, dëshiroj që ne
25 ta bëjmë sa më shpejt, por do të jetë më së shumti, por do të

1 marrë shumicën e ditës.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shumicën e
3 ditës sot?

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Po.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë, në
6 rregull.

7 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, duke parë
8 siç është tani, është rreth 30 deri 40 minuta. 30 deri në 40
9 minuta.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jam gjithashtu midis një ore dhe
11 një orë e gjysmë në vartësi të kësaj se sa varet.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, në
13 rregull. E kuptoj.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, përpara se të
15 vijë dëshmitari, pra të hyjë në sallë, dua të ngre një çështje
16 ose të bëj një përditësim që ka të bëjë me çështjen e
17 kontakteve me familjen.

18 Synimi është që t'i jap Gjykatës një shpjegim me shkrim
19 nëse është e pranueshme, dhe mos të zë kohën e seancës këtu në
20 Gjykatë, për të shpjeguar rrethanat e nevojshme.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
22 shoqëroni dëshmitarin të hyjë në sallë.

23 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita,
25 znj. Dëshmitare, më dëgjoni mirë?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 5

1 DËSHMITARJA: [Përkthim] Po.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do të
3 vijojmë me pyetjet që do ju bëjë pala tjetër, duke filluar me
4 Mbrojtjen e z. Thaçi.

5 Ju rikujtoj për betimin solemn që keni bërë për të thënë
6 të vërtetën.

7 Z. Kehoe keni fjalën.

8 DËSHMITARJA: SANDRA MITCHELL [Vijon]

9 Dëshmitarja përgjigjet për mes përkthimit

10 Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe: [Vazhdim]

11 Z. KEHOE: [Përkthim]

12 PY. Mirëdita, znj. Mitchell, do përpiqem që ta kaloj, që të
13 kalojmë sa më shpejt duke mos përsëritur ato që u thanë
14 përpara.

15 E lamë dje tek armatosja e civilëve nga ana e
16 autoriteteve serbe.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Dua që të fillojmë me dokumentin
18 DHT07525 deri në DHT07537.

19 PY. Do t'ju tregoj faqen e parë. Është një akt-ekspertizë nga
20 një çështje e Sllobodan Millosheviqit për të cilën ju keni
21 dëshmuar, por dua t'ju tregoj faqen e parë fillimisht. Për
22 t'ju orientuar, znj. Mitchell, besoj se e keni lexuar këtë
23 raport, por ky është një raport -- nuk besoj se do ta keni
24 lexuar këtë raport -- por ky është një raport i zyrës së një
25 analisti ushtarak të zyrës së Prokurorisë në TPNJ, Philip Co,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 6

1 në çështjen Millosheviq në të cilën ju keni dëshmuar.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe të kalojmë tani fillimisht te
3 DHT07536. Të kalojmë te paragrafi 25.

4 PY. Dhe ky është një urdhër i Ministrisë Federative Serbe të
5 Mbrojtjes i majit të vitit 1998, ku thuhet se:

6 "Është vënë re se për shkak të numrit të rritur të
7 sulmeve nga terroristët shqiptarë kundër organeve ligjore të
8 qeverisë dhe kundër serbëve, malazezëve dhe shtetasve me
9 kombësi të tjera që janë besnikë të Republikës së Serbisë edhe
10 Republikës Federative të Jugosllavisë, banorët e këtyre
11 komunave po organizohen vetë me qëllim mbrojtjen. Në lidhje me
12 ketë:

13 "Urdhëroj

14 "1. Shefat e drejtorive dhe shefat e seksioneve që
15 menjëherë të vihen në kontakt me drejtuesit komunalë dhe të
16 sigurojnë që të përpilohen lista me qëllim armatosjen e
17 popullatës që do të kryhet nga Ministria Federative e
18 Mbrojtjes përmes njësive organizative të saj në të gjithë
19 territorin..."

20 Pra, kjo këtu bëhet fjalë për qëllimin e armatosjes së
21 popullatës.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Nëse kthehem dy faqe mbrapa te
23 numri DHT07532. Dhe nëse kalojmë poshtë, në paragrafin në mes
24 që fillon me fjalën "Me qëllim..." që ka të bëjë me pikat e
25 vëzhgimit dhe bazat e vëzhgimit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 7

1 PY. Është një urdhër nga Ministria Serbe e Mbrojtjes:

2 "Me qëllim integrimin e ndërlidhjes" --

3 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtim, besoj se e kemi
4 diskutuar gjatë që mos të lexohen të gjitha paragrafët
5 dëshmitares nëse nuk ka pyetje.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka pyetje?

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, doja t'i jap mundësinë që ta
8 lexojë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po s'e ka
10 përpara?

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Po nëse duhet -- desha t'i jap
12 mundësinë që ta lexojë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta
14 lexojë dhe vetë ose mund të kaloni, t'i tregoni se çfarë të
15 lexojë.

16 Z. KEHOE: [Përkthim]

17 PY. Znj. Mitchell, ju lutem kaloni poshtë të lexoni deri në
18 fund të faqes, kur të kaloni aty kaloni në faqen tjetër.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
20 mund të kaloni në faqen tjetër.

21 Z. KEHOE: [Përkthim]

22 PY. Më thoni kur keni mbaruar me pjesën e parë të paragrafit.

23 PË. Kam mbaruar.

24 PY. Pra ky është një urdhër, siç e shihni, për të ngritur
25 pika të ndërlidhjes me radio në shtëpitë e civilëve. Pra është

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 8

1 një urdhër që vjen nga Ministria e Mbrojtjes për të armatosur
2 civilët, nga Ministria e Mbrojtjes Serbe, për të armatosur
3 civilët. Dhe për të vendosur pikat e ndërlydhjes me radio në
4 shtëpitë e individëve. Dinit gjë për këtë asokohe?

5 PË. Është hera e parë që e shoh.

6 PY. Kalojmë në diçka tjetër, për t'u larguar nga, për t'u
7 larguar nga faji që serbët u vendosnin shqiptarëve të Kosovës
8 për krime. Desha që të flas për bisedat tuaja, dëshminë tuaj
9 më saktë, për, me ZPS-në lidhur me disa prej komandantëve që
10 keni takuar, e të tjerë.

11 Kemi folur pra për UÇK-në dhe ju -- ta lexoj, më mirë ta
12 lexoj.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Kalojmë me numrin SPOE00198 deri në
14 SPOE00198366, faqen 151 dhe 152. Duhet të jetë në fund të
15 faqes të njëjës faqe dhe vazhdon në fillimin e faqes tjetër.
16 151. Ju kërkohet ndjesë. 151 dhe jo 158.

17 PY. Në fund të faqes, shikojmë, është:

18 "Vendosja e organizatës së UÇK-së në një format ushtarak
19 standard mund të jetë keq-orientues. 'Kompanitë' në disa raste
20 ishin më të mëdha në shifra sesa një 'brigadë'."

21 Kjo është pak e pazakontë për çdo lloj ushtrie që të ketë
22 një kompani më të madhe sesa një brigadë, besoj se e pranoni
23 këtë?

24 PË. Nuk e di.

25 PY. Këtu vazhdon të thuhet:

1 "Nën-njësitet e UÇK-së ishin organizuar përgjithësisht
2 rreth një bashkimi fshatrash të madhësive dhe dispozitave të
3 ndryshme. Në përgjithësi këto ishin të paqarta, linjat e
4 organizimit."

5 Pra, pak a shumë është kjo, është ky mendimi juaj si i
6 shihnit ju në OSBE UÇK-në asokohe, pra kështu e konsideronit?
7 PË. Mund të ktheheni pak, sepse ju e lëvizët ndërkohë që unë
8 po e lexoja?

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Të kalojmë në fund të faqes edhe një
10 herë.

11 PY. Nëse do të keni më shumë kohë na e thoni.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju përdorët
13 termin asokohe, për cilën kohë bëhet fjalë?

14 Z. KEHOE: [Përkthim]

15 PY. Kur erdhi KVM-ja, pra misioni vëzhgues, në vjeshtën e
16 vitit 1998.

17 PË. Po.

18 PY. Dhe kjo vazhdon, vazhdoi pra edhe gjatë qëndrimit tuaj në
19 Kosovë nga fundi i tetorit deri në largimin tuaj në mars, apo
20 jo?

21 PË. Përshkrimi që është këtu?

22 PY. Po.

23 PË. Pak a shumë, po.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në këtë kohë
25 dëshirojmë ta ofrojmë këtë pjesë të shkëputur nga ky material

1 në prova materiale.

2 ZNJ. MAYER: [Përkthim] S'kemi kundërshtim.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,
4 SPOE00198 deri në 0019866, faqet 151 dhe 152 pranohen në
5 prova.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Këto faqe marrin numrin
7 P743.1.

8 Z. KEHOE: [Përkthim]

9 PY. Dhe kur kolegët tuaj po ndërvepronin me këta, keni marrë
10 raporte se UÇK-ja kishte gjithmonë mungesa në armatime, dhe se
11 kishin vështirësi në marrjen e armatimeve nga Shqipëria me
12 ecjen përpara të luftës. Kështu është?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe në, pra ju ishit në terren dhe ju dhe kolegët tuaj,
15 pra, në terren bënit takime. Këto takime ishin me komandantët
16 në nivel lokal, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. Mirë, le të lexojmë një pjesë të dëshmisë tuaj në
19 çështjen Milutinovic.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Për Gjykatën, bëhet fjalë për lëndën
21 Milutinovic IT-05-87, transkripti 755 deri 738, duam të
22 shikojmë faqen 615, rreshtat 6 dhe 16.

23 PY. Aty thuhet:

24 "Në rregull. Dhe krahas UÇK-së, a nuk kishte në fakt edhe
25 fraksione të tjera shqiptarë kosovarë serbë të cilët ushtronin

1 aktivitet në zona të ndryshme Kosovë dhe Metohi?

2 "PË. Nëse mundem, UÇK-ja nuk ishte e unifikuar në një
3 mënyrë të bashkërenduar në format qendror. Kishte komandantë
4 të ndryshëm të zonave që në përgjithësi kishin, që u dukeshin
5 ndryshe palëve të ndryshme. Unë nuk e di, domethënë, se kush
6 ishte palë e UÇK-së në një fshat të caktuar, sepse nuk dukej
7 qartë pra, kishte persona të cilët, grupime personash të cilët
8 e quanin veten dhe UÇK. Ishte e vështirë për të kuptuar."

9 Pra, në bazë të përvojës tuaj, ju keni dëshmuar që UÇK-ja
10 nuk ishte e unifikuar në nivel qendror. Është e saktë?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe ju kishit, në përgjithësi keni biseduar, pra, pak a
13 shumë me komandantët, për komandantët në dëshminë që i keni
14 dhënë ZPS-së, dhe disa komandantë zone në thelb ishin të
15 kufizuar sa i takon aspektet gjeografik.

16 PË. Po, unë kështu e kuptoj.

17 PY. Dhe, komandantët e zonave, sigurisht, ishin përgjegjës
18 dhe drejtonin gjërat në zonën e tyre, apo jo?

19 PË. Unë kështu e kuptoj, po.

20 PY. Atëherë, për të korrigjuar diçka, unë e kuptoj që ju nuk
21 jeni një person ushtarak, pra nuk jeni ushtarake, por ju i
22 keni thënë ZPS-së se UÇK-ja kishte grada. Thjesht dua të lexoj
23 nga dëshmia juaj se, kjo është vetëm një prej
24 zëvendëskomandantëve të zonave, në fakt bëhet fjalë për
25 dëshminë e z. Sadik Halitjaha dhe ai tha që:

1 "Gjatë luftës, Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk kishte
2 grada..."

3 Jeni ju në dijeni që nuk kishte grada në UÇK?

4 PË. Jo.

5 PY. Tani, struktura me të cilën kishit të bënit në UÇK nuk
6 ishte e koordinuar në nivel qendror, por nëse doje që diçka të
7 realizohej, duhet t'i drejtoheshe komandantëve të zonave, apo
8 jo?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe kjo ndryshon shumë nga struktura serbe, apo jo? Ku
11 kishte një zinxhir komande më vertikal.

12 PË. Po, mund ta shihje strukturën serbe.

13 PY. Struktura serbe ishte më vertikale ndërsa mund të thuash
14 që struktura e UÇK-së ishte horizontale, nga zona në zonë,
15 kështu mund të thuhet?

16 PË. Po.

17 PY. Mendoj se ju dëshmuat se komandantët e zonave mblidheshin
18 së bashku dhe votonin në mënyrë demokratike për kryerjen e
19 gjërave, kështu?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe personi me të cilin kishin të bënit më së shumti
22 ishte dikush i quajtur Ramush Haradinaj, apo jo?

23 PË. Po, ky ishte emri që dilte më së shumti.

24 PY. Dhe ju i keni thënë ZPS- së në diskutimet tuaja me ZPS--
25 në më datë 1 dhjetor dhe është në paragrafin 31, në shënimet

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 13

1 përgatitore të dëshmitarit se komandanti kryesor në zonën
2 operative në terren dukej se ishte Ramush Haradinaj kështu?
3 PË. Po, këto përshtypje kisha.

4 PY. Pra, kjo vlen për gjatë gjithë kohës që ju keni qenë aty,
5 pra po flas përpara evakuimit, apo jo? Pra nga tetori deri në
6 evakuimin tuaj, në 22 mars, diçka e tillë?

7 PË. Po.

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ju lutem, lexoni edhe rreshtin e
9 fundit sepse ka diçka që vjen mbas kësaj.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Po ju këtë mund ta bëni në pyetjet
11 tuja plotësuese.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

13 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ju kuptuam, i nderuar Gjykatës.

14 Z. KEHOE: [Përkthim]

15 PY. Dhe ky ishte personi me të cilin ju kishit folur shumë
16 herë, apo jo? Afërsisht, sa herë?

17 PË. Mua nuk më kujtohet të kem folur me atë personalisht. Ka
18 pasur mbledhje dhe takime ku ai ka qenë i pranishëm.

19 PY. Nuk e kisha fjalën në ish-in takime private apo jo, por në
20 takimet në të cilat ju keni qenë?

21 PË. Po, zotëri.

22 PY. Që ky ka qenë personi me të cilët flisnit njerëzit, ky
23 ishte personi i cili mund të ndalonte luftimet në terren.

24 PË. E saktë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, z.

1 Kehoe, dy gjëra. Së pari, bëni pauzë midis përgjigjeve dhe
2 pyetjeve. Dhe numri i dytë, mos -- nëse keni ndonjë koment për
3 ndonjë kundërshtim, mos flisni pa marrë leje nga Trupi
4 Gjykues.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, nuk do ta
6 përsëris.

7 PY. Ka pasur një periudhë kohe, dhe dua që të ktheheni tani
8 te diskutimi që keni bërë me ZPS-në për periudhën kohore
9 përpara bombardimeve të NATO-s.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Është deklarata e ZPS-së me numër
11 076826-076820, paragrafi 45, mund ta vendosim në ekran.

12 PY. Por dua t'ju jap një mundësi për ta lexuar, znj.
13 Mitchell, do ishte më e lehtë kështu se sa po të vazhdoja ta
14 lexoja unë.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Paragrafi 45. Faleminderit, besoj se
16 është në pjesën e poshtme të faqes.

17 PY. Ku fillon me -- pra është paragrafi 45:

18 "Brenda UÇK-së nuk kishte një shef shtabi i cili t'i
19 drejtonte gjërat në nivel qendror në periudhën përpara
20 bombardimit të NATO-s. Gjatë kësaj periudhe të gjithë
21 komandantët e zonave takoheshin me njëri-tjetrin në takimet e
22 komandantëve të zonave që zhvilloheshin në vende të ndryshme
23 për arsye sigurie për ata që ishin të pranishëm. Në vend që të
24 drejtoheshin nga lart, përmes një komande të centralizuar siç
25 ishte ushtria serbe, ajo që unë kuptoja është që këto takime

1 të komandantëve të zonës drejtoheshin më shumë në formën e një
2 sistemi demokracie me vota të barabarta për secilin komandant
3 të zonës.”

4 Kjo është e saktë, apo jo? Ky vlerësim është i saktë në
5 bazë të asaj që ju keni parë dhe përvojës tuaj apo jo?

6 PË. Po, e saktë.

7 PY. Duke pasur parasysh dallimin mes strukturës vertikale dhe
8 asaj horizontale, dua t’ju tregoj dokumentin DHT01465 deri
9 DHT01467. Është një letër e Departamentit të Shtetit të
10 Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Senatit Amerikan, Senatorit
11 McCollin [Sipas përkthimit] në vitin 1999, më 4 maj të këtij
12 viti. Mund t’i hidhni një sy të shpejtë dhe dua t’ju
13 përqendroj vëmendjen në paragrafin e tretë.

14 Thjesht në pamje të parë, e keni parë këtë dokument më
15 përpara?

16 PË. Jo, asnjëherë.

17 PY. Kjo është letër e 4 majit të vitit 1999. Këtu
18 Departamenti i Shtetit të SHBA-së thotë se:

19 “Për më tepër duke qenë se nuk ka strukturë politike në
20 Kosovë, apo komandim dhe kontroll efektiv të UÇK-së, do të
21 duheshin shumë muaj, në mos vite, për të organizuar në mënyrë
22 që të përdorin dhe të mbajnë çdo ndihmë ushtarake që do të
23 ofronin Shtetet e Bashkuara të Amerikës.”

24 Pra, kjo në -- pra, lidhur me një komandim dhe kontroll
25 vertikal efektiv, kjo nuk ekzistonte në Kosovë brenda UÇK-së

1 asokohe?

2 PË. Nuk pajtohem me këtë deklaratë që thoni ju.

3 PY. Nuk pajtoheni?

4 PË. Jo.

5 PY. Mirë, në rregull. Në këtë moment pra sa i takon zinxhirit

6 vertikal e horizontal të komandimit, ju do të pajtoheshit me

7 mua se serbët ishin vertikalë, ndërsa UÇK-ja në fakt ishte

8 horizontale?

9 PË. Nuk është kaq e thjeshtë. Kishin një Shtab të

10 Përgjithshëm, nuk e di në qoftë se kishin një gjuhë të

11 përbashkët ose jo.

12 PY. Unë vetëm po ju kujtoj atë që keni thënë në gjykimin e

13 Milutinoviçit, se nuk kishte një qendër të unifikuar të

14 koordinuar në krahasim me forcat serbe, por se ishin më shumë

15 komandantë të nivelit lokal. A është kjo e saktë?

16 PË. Po.

17 PY. Domethënë edhe koordinimi nuk ishte i nivelit horizontal?

18 PË. Po.

19 PY. Po flas përsëri për periudhën përpara evakuimit tuaj,

20 kemi strukturë të UÇK-së me komandantë zonash që ishin

21 pushteti qendror dhe njerëz që merreshin me Ramush Haradinajn,

22 gjatë kohës, pjesën më të madhe të kohës për nga organizimi.

23 PË. Në atë zonë ku ishte, ishte faktikisht një zonë ky kryhej

24 një aktivitet mjaft i madh.

25 PY. Përsëri po flasim për diçka që për nga përvoja juaj

1 kontrollohet nga komandantë zonash, domethënë për veprimtaritë
2 të tilla?

3 PË. Po.

4 PY. Diskutuat me Prokurorin, qendrën e ndalimit që ju në fakt
5 vizituat në zonën e komandant Remit, është kështu?

6 PË. Po.

7 PY. Ju thatë që mund të kishte edhe të tjera, por ju biseduat
8 vetëm për këtë, a është kështu?

9 PË. Po.

10 PY. Këto qendra ndalimi nga përvoja juaj, ishin të vendosura
11 nëpër shtëpi private, a është kështu?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe mbaheshin aty një numër i vogël njerëzish, a është
14 kështu?

15 PË. Po.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, do të mundohem të bëj një pushim
17 midis pyetjeve dhe përgjigjeve.

18 Znj. Mitchell po e bën mirë pjesën e vet, por unë jam ai
19 që nuk e respektoj këtë rregull.

20 PY. Znj. Mitchell, vizitat e këtyre vendndodhjeve nga dikush
21 që ishte i eshalonit të sipërm për sa i përket organizimit të
22 çështjeve që lidheshin me të drejtat e njeriut së bashku me
23 Susanne Ringgaard, ndihmësen tuaj, këto ishin takime të
24 rëndësishme për mendimin tuaj, a është kështu?

25 PË. Po.

1 PY. Përpara se të flisnit me këta persona të ndaluar, a
2 bëheshin përgatitje me komandantët vendorë përpara këtyre
3 takimeve?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe ju kishit rregullat dhe kushtet që duhej të
6 përmbusheshin dhe ato rregulla ju, që ju imponuan ata ju i
7 kishit refuzuar, a është kështu?

8 PË. Po.

9 PY. Po flas tani për takimin e 18 shkurtit.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Është prova P116 -- s'ka nevojë ta
11 vendosim në ekran.

12 PY. Komandanti i policisë ushtarake donte të ishte i
13 pranishëm në takime, por ju nuk deshët të ishte ai i
14 pranishëm, dhe ai nuk ishte i pranishëm, a është kështu?

15 PË. Po.

16 PY. Duke marrë parasysh rëndësinë e këtyre takimeve, ju dhe
17 znj. Ringgaard -- sigurisht kishit një farë përgjegjësie për
18 të siguruar se çdo gjë do të raportohet në mënyrë të saktë, a
19 është kështu?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe kur them që "të bëhej si duhej" dokumentimi, është
22 fjala për të raportuar ashtu siç shihen dhe vërehen gjërat, a
23 është kështu?

24 PË. Po.

25 PY. Si një vëzhgues i të drejtave të njeriut kur kërkohet

1 informacion prej dikujt mund të rrezikohen edhe jetët e
2 njerëzve, a është kështu?

3 PË. Po.

4 PY. Dikush nëse lëndohej rëndë, ju mendoj që i thatë ZPS-së
5 se e raportoni këtë dhe përpiqeshit që ai person në një farë
6 mënyre të ketë qasje në ndihmë mjekësore, a është kështu?

7 PË. Po.

8 PY. Ajo që patë, që dëgjutë gjatë atyre takimeve dhe mënyra
9 si e dokumentuat atë që patë dhe dëgjuat, ishte mjaft me
10 rëndësi për sa i përket sigurisë së atyre personave në mënyrë
11 që përfaqësuesit e Misionit Verifikues në Kosovë të mund të
12 kuponin ato që po ndodhte në terren, a është kështu?

13 PË. Po.

14 PY. Nuk dua që të përsëris atë që e keni thënë gjatë
15 përgjigjeve që i dhatë Prokurores, mirëpo mendoj që e
16 përmendët komandant Remin si komandant zone, a është kështu?

17 PË. Po.

18 PY. Ju në fakt shkruat një raport.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Për këtë ta vendosim në ekran, është
20 dokument tashmë e kemi parë, nuk është dokument i ri, numri
21 1D00007. Ose thjesht 1D7.

22 PY. Ky është raporti në lidhje me tetë persona që i patë, a
23 është kështu?

24 PË. Po.

25 PY. Dhe ju keni dokumentuar këtu hollësi, si për shembull, në

1 lidhje me nji personin e parë që ai ishte vizituar nga KNKK-
2 ja, e shikoni këtë?

3 PË. Po.

4 PY. Dhe pastaj për të dytin thoni që i është dhënë ndihmë
5 mjekësore?

6 Z. KEHOE: [Përkthim] A mund të shkojmë tek i dyti, ju
7 lutem?

8 DËSHMITARJA: [Përkthim] Po.

9 Z. KEHOE: [Përkthim]

10 PY. Dhe më andej i treti, i katërti, i pesti -- i gjashti i
11 shtati dhe i teti në lidhje me ta keni thënë që familjet e
12 tyre dinin se ku ndodheshin?

13 PË. Po.

14 PY. Shënohet këtu se disa prej tyre janë ndaluar për
15 bashkëpunim disa të tjerë për vrasje. Disa të tjerë për tentim
16 për të kryer vrasje, është numri 5 këtu. Dhe disa për vjedhje,
17 a është kjo e saktë?

18 PË. Po.

19 PY. Ju dëshmuat gjatë dëshmisë suaj këtu, se këta dëshmitarë,
20 këta të ndaluar që patë, dhe kjo është në faqen e transkriptit
21 të përkohshëm 72, të 5 dhjetorit, "ishin mjaft të tërhequr
22 ndoshta edhe të frikësuar". Ky vlerësimi juaj reflektohet në
23 këtë raport dikund?

24 PË. Jo, mendoj që jo.

25 PY. Dhe ju gjithashtu thatë se ata sikur ishin këshilluar apo

1 atyre sikur u ish thënë se si të silleshin. Kjo është në
2 rreshtin 15. A figuron kjo në raportin?

3 PË. Jo.

4 PY. Ju gjithashtu më parë i keni thënë ZPS-së dhe kjo është
5 në deklaratën e dëshmitarit që ia keni dhënë ZPS-së më datën
6 26, se ata dukeshin se ishin të shqetësuar, dhe sikur po
7 silleshin në bazë të një skripti, apo skenari. Dhe këto
8 komente nuk janë të shënuar në raportin që e keni përpiluar, a
9 kështu?

10 PË. Po, ashtu është.

11 PY. Në vlerësimin e informacionit në lidhje me këta të
12 ndaluar, kemi edhe gjëra që nuk janë të përfshira në raportin
13 që ju i keni dërguar drejtuesit të OSBE-së, a është kështu?

14 PË. Po.

15 PY. Dhe në fakt kur një dëshmitar duket se është i
16 shqetësuar, nervoz, dhe këtë një punonjës i OSBE-së e vëren
17 sigurisht që këtë do ta shënonte në raport, a është kështu?

18 PË. Ndoshta.

19 PY. Tani do t'ju tregoj një dokument tjetër.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] mban numrin U007-9607 deri në 9667
21 [Sipas përkthimit], është në faqen 9 [Sipas përkthimit]. Në
22 qoftë se e thashë numrin siç duhet. Sa më korrigjuan. Edhe një
23 herë do ta them numrin, U007-9607 deri në U007-9661, dhe kjo
24 pjesa është në faqen me numër 79658.

25 T'ia tregojmë dëshmitares faqen e parë.

1 PY. Për orientim --

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Përpara se të kalojmë tek faqja që
3 na duhet, është një raport që i shkon Andrew Cayley, besoj që
4 e ka hartuar znj. Ringgaard, është në lidhje me intervista.
5 Tani mund të shkojmë tek faqja 7968 [Sipas përkthimit]. Në
6 fund të faqes, tek shënimi NB.

7 PY. Është nga Merle Aurelie, dhe është e datës 22 apo 23
8 shkurt, po e lexoj këtë rresht. Thuhet:

9 "Viktima dukej se ishte e frikësuar gjatë intervistës dhe
10 nuk dha hollësi në lidhje me arrestimin e tij dhe çdo herë
11 theksonte se nuk ishte keqtrajtuar".

12 A pajtoheni me mu se ky është një raport shembullor?

13 PË. Po, është një raport i mirë.

14 PY. Mirëpo, asnjë nga përshkrimet që dhatë ju në lidhje me
15 vizitat që ua bëtë këtyne të ndaluarve, nuk jep përshkrime të
16 tilla, se dukeshin se ishin të frikësuar, dhe se ishin
17 instruktuar që mos të flasin dhe të jenë të tërhequr, a është
18 kjo e saktë?

19 PË. Po.

20 PY. Edhe pse në pyetjen e vet Prokurorja tha që këta njerëz
21 ishin të veshur me rroba të trasha, dhe nuk dukej se çfarë
22 kishin në trup, ju nuk patë ndonjë lëndim tek këta njerëz, a
23 është kjo e saktë?

24 PË. Po, e saktë.

25 PY. Dhe ju në qoftë se do të kishit parë ndonjë lëndim, ju

1 sigurisht që do ta kishit raportuar, do ta kishit përfshirë
2 këtë në raport?

3 PË. Po.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Nëse mund t'i kthehemi dokumentit
5 1D7.

6 PY. Për shembull të shkojmë tek individ, tek numri 2. Ky
7 individ akuzohet për -- Hetem Jashari, pra ky është një person
8 që akuzohet për bashkëpunim, a është e saktë?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe mbas asaj që i keni thënë ZPS-së kishte goxha shumë
11 njerëz që akuzoheshin për bashkëpunim, a është kjo e saktë?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe në fakt, në lidhje me zëvendësen tuaj, Susanne
14 Ringgaard Pedersen, e cila ka dëshmuar në çështjen Limaj.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Është dokumenti DHT03494 deri në
16 03540. Prapë e dhashë gabim numrin, e korrigjoj. 03540.
17 Rreshti, rreshtat 10 deri në 14 [Sipas përkthimit]. Më falni,
18 a mund të shkoni tek faqja 3156 në këtë dokument?

19 PY. Kërkoj ndjesë znj. Mitchell, po përpiqem që të jem sa më
20 i saktë.

21 Dhe pyetja që bëhet aty:

22 "Çështja e bashkëpunëtorëve doli edhe më herët gjatë
23 punës suaj në Kosovë?"

24 Përgjigjja është:

25 "Nuk doli drejtpërdrejt në punën time, mirëpo çështja e

1 bashkëpunimit ishte diçka që diskutohej në MVK për shkak se
2 ishte mjaft e pranishme në terren, dhe kishte njerëz që shpesh
3 për para bënin bashkëpunimin.”

4 Pyetja ime është për ju që, kish njerëz të tillë që për
5 para bënin bashkëpunim?

6 PË. Po.

7 PY. Mirëpo në fushën e operacioneve kishim operacione që
8 kryenin serbët dhe të cilat i atribuoheshin palës tjetër, edhe
9 armatosej popullata civile dhe ata i paguanin këta
10 bashkëpunëtorë për informacion, a është kjo e saktë?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe gjithashtu kishte dhe një situatë kur përfaqësuesit e
13 MVK-së po udhëtonin për t’u kaluar, për t’u takuar me
14 përfaqësues të UÇK-së dhe kishte një rast kur MVK-ja u ndoq
15 nga autoritetet serbe dhe u hap zjarr, a është kjo e saktë?

16 PË. Po.

17 PY. E di që ishte një situatë mjaft e rrezikshme dhe për MVK-
18 në sepse serbët, përveçse po i armatosnin civilët dhe po
19 kryenin operacione duke ia lënë fajin palës tjetër, dhe kishin
20 bashkëpunëtorë, ata gjithashtu përpigeshin që edhe të
21 ndërhyenin në raportin tuaj me UÇK-në, a është kjo e saktë?

22 PË. Po.

23 PY. Tani, nga po ky transkript, do t’ju lexoj faqen, nga
24 faqja 3536, rreshtat 19 deri në 22.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk e di nëse është faqja 3536, po,

1 e shoh.

2 PY. Rreshti 19, i bëhet pyetja znj. Ringgaard:

3 "Gjatë kohës që ishit atje, a mësuat për pretendime që
4 bënin oficerët e MUP-it se ju ofronin nxitje shqiptarëve, i
5 ofronin për të marrë informacion prej tyre në lidhje me UÇK-
6 në?"

7 E shikoni këtë?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe në lidhje me bashkëpunëtorët, ju e dinit që ata që
10 përshkruheshin si bashkëpunëtorë -- po e tërheq këtë pjesë të
11 pyetjes. Do qëndrojmë ende në deklaratën apo dëshminë e znj.
12 Ringgaard në Tribunalin e Hagës.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Është i njëjti dokument, por faqja
14 është 3532 rreshtat 18 deri 22.

15 PY. Dhe aty thuhet:

16 "Ju faleminderit që keni durim znj. Ringgaard. Ju keni
17 dëshmuar që MVK-ja mori informacion për rrëmbimin nga ana e
18 UÇK-së të, ndër të tjera, të ashtuquajturve bashkëpunëtorë. Në
19 bazë të informacionit që morët dhe që mori MVK-ja në terren, a
20 ishit në gjendje që të përcaktoni nëse këto ishin elementët e
21 këqij apo të shkëputur të UÇK-së.

22 Përgjigje:

23 "Informacioni që kishim ishte, merrej kryesisht nëpërmjet
24 oficerëve të ndërlihdjes dhe sipas atij informacioni, UÇK-ja
25 ishte në dijeni që kishte elementë të tillë të këqij që ishte

1 e vështirë të kontrolloheshin dhe se kjo bëhej për arsye të
2 hakmarrjes.”

3 Znj. Mitchell, MVK-ja e dinte që kishte individë që
4 përdornin uniformën e UÇK-së për të bërë, për hakmarrje. A
5 është kështu?

6 PË. Po.

7 PY. Në Gjykatë, domethënë Gjykata ka dëgjuar dëshmi të shumta
8 se shumë rrëmbime u bënë për arsye personale dhe për arsye të
9 hakmarrjes dhe se kjo nuk kishte të bënte fare me
10 bashkëpunëtorët. Domethënë, për të marrë hakmarrje personale
11 njerëzit e përdornin UÇK-në, emrin e UÇK-së, a është kjo e
12 saktë?

13 PË. Po.

14 PY. Kjo nuk është dëshmia juaj. Mirëpo do të lexoj një rresht
15 nga një ish-anëtar i UÇK-së. Është një transkript, nuk do ta
16 jap numrin e faqes, për të mos identifikuar personin sepse
17 kemi qenë në seancë të mbyllur.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet për hir
19 të procesverbalit, që mund të vazhdoni.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit.

21 Është transkripti T0613 [Sipas përkthimit], i datës 13
22 qershor 2023, rreshtat 21, 23.

23 PY. Një dëshmitar i ZPS-së u pyet:

24 “Meqë ishte ushtri vullnetare, në qoftë se dikush nuk e
25 mbështeste luftën, kjo nuk e bënte atë të dyshuar, a është

1 kështu?"

2 "Po."

3 A pajtoheni me këtë znj. Mitchell?

4 PË. Mendoj që nuk mund të pajtohem me këtë deklaratë të
5 përgjithshme.

6 PY. Mirëpo, kemi një individ që ka thënë se, në qoftë se ai
7 nuk e ka mbështetur luftën, ai perceptohej si bashkëpunëtor.
8 Ju kujtohet? Keni dëgjuar një gjë të tillë?

9 PË. Jo.

10 PY. Ju gjithashtu folët për LDK-në dhe ky dëshmitar i njëjtë
11 që dëshmoi me 13 qershor është në faqen 4765. Dëshmia e tij,
12 atij i u bë pyetja:

13 "Për shembull, sipas jush, bashkëpunëtorët nuk ishin
14 vetëm individë që ishin anëtarë të LDK-së?"

15 Dhe përgjigjja ishte:

16 "Jo."

17 Domethënë, thjesht që pse ju ishit një anëtar i LDK-së
18 kjo nuk ju bënte bashkëpunëtor. A është kjo e saktë?

19 PË. Është kjo pyetje për mua?

20 PY. Po, për ju është.

21 PË. Është e vështirë për mua të përgjigjem se varet se kush e
22 ka thënë. Unë kam dëgju njerëz që kanë thënë gjëra të tilla,
23 mirëpo të tjerët mund të kenë mendime të tjera.

24 PY. Po ju e pranoni se pjesa më e madhe e UÇK-së, e anëtarëve
25 të UÇK-së, ishin anëtarë të LDK-së, a është kjo e saktë?

1 PË. Jo. Unë këtë nuk e kam ditë.

2 PY. Në bazë të përvojës që kishit ju në terren, ju nuk mësuat
3 që pjesa më e madhe e ushtarëve të thjeshtë e ushtrisë në
4 përgjithësi ishin anëtarë të LDK-së? Nuk e keni mësuar këtë?

5 PË. Jo.

6 PY. Domethënë ju nuk keni kurrfarë dijenie nëse anëtarë të
7 LDK-së, ata që ishin të LDK-së, perceptoheshin si
8 kolaboracionistë?

9 PË. Në bazë të informacionit që kam marrë, përsëri po flasim
10 për periudhën para luftës apo pas luftës?

11 PY. Gjatë luftës. Dhe gjatë periudhës kur MVK-ja ishte aty
12 nga tetori deri në mars, gjatë asaj periudhe, në qoftë se për
13 shembull dikush që ka qenë anëtar i LDK-së është konsideruar
14 se ishte bashkëpunëtor ose jo. Kjo është pyetja.

15 PË. Përsëri, zotëri, unë nuk mund të pajtohem me një
16 deklaratë të tillë të përgjithshme. Ne nuk e kemi dëgjuar këtë
17 në mënyrë të përsëritur që LDK-ja apo anëtarët e LDK-së nuk
18 ishin kyçë ose ishin kyçë në UÇK dhe ofronin ose jo
19 rezistencë.

20 PY. Tani do t'ju jap një pjesë të dëshmisë që ka dhënë
21 Rustem Mustafa, komandant Remi. Dhe pyetja i bëhet kështu:

22 "PY. A arrestoheshin njerëz se ishin anëtarë të LDK-së?

23 "PË. Jo.

24 "PY. A keni ndonjë mendim apo teori në lidhje me LDK-në?

25 Duhet të thuhet se:

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 29

1 "... ishin, se ndaloheshin sepse ishin kundërshtarë
2 politikë."

3 Përgjigja e z. Remi:

4 "PË. LDK-ja -- përkundrejt çliruesve në rajonin tim."

5 Dhe më falni këtu duhet bëhet një korigjim. A ka ndonjë
6 arsye që të mohohet se në zonën e Llapit Ushtria Çlirimtare e
7 Kosovës nuk i ndalonte anëtarët e LDK-së?
8 PË. Duhet t'i kthehem dokumentit për ta parë këtë, sepse me
9 sa më kujtohet LDK-ja ishte nën presion në gjithë territorin e
10 Kosovës.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të
12 bëjmë një pushim dhjetë minutësh në këtë pikë. Nëse mund të
13 largojmë dëshmitaren nga salla.

14 Do të bëjmë pushim deri në orën 10.10.

15 --- Pauza fillon në orën 9.59

16 --- Seanca rifillon në orën 10.14

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

18 Asistente, mund të sillni dëshmitaren në sallë.

19 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
21 vazhdoni, z. Kehoe.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

23 PY. Znj. Mitchell, për të përfunduar me këtë temë. Ka shumë
24 arsye personale se pse mund të jenë arrestuar dhe të ndaluar
25 njerëzit apo jo? Dhe që nuk kishin të bënin me UÇK-në në nivel

1 personal, a është e drejtë kjo?

2 PË. Të ndaluar nga kush?

3 PY. Në qoftë se janë të ndaluar nga dikush, që mund të ketë
4 qenë për arsye personale, mund të jetë shtirur sikur është i
5 UÇK-së, ka pasur raste të tilla me shumicë, apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Sa i takon bashkëpunëtorëve, kur keni intervistuar
8 persona, ju e keni kuptuar që ata në fakt nuk ishin
9 bashkëpunëtorë. Por ju nuk keni pritur në diskutimet tuaja që
10 një bashkëpunëtor të pranonte në qoftë se ishte bashkëpunëtor
11 apo jo?

12 PË. Do ishte surprizë, çudi, po ta thoshte një gjë të tillë.

13 PY. A ka ndodhur ndonjëherë një gjë e tillë?

14 PË. Jo.

15 PY. Me sa ju kujtohet?

16 PË. Po.

17 PY. Tani le të kalojmë te një temë tjetër. Të flasim për
18 krizën e refugjatëve të cilën, për të cilën ju diskutuat edhe
19 më përpara dhe që ka të bëjë me UÇK-në dhe çfarë ka ndodhur në
20 lidhje me UÇK-në dhe nuk e kam të qartë se çfarë ka ndodhur
21 gjatë kësaj periudhe, kështu që do të doja që të ma sqaronit
22 pak.

23 Po flasim këtu për periudhën e kohës përpara konferencës
24 së Rambujesë në shkurt. Megjithatë, në janar dhe në shkurt
25 armata jugosllave dhe MUP-i ishin të përfshirë në stërvitjen e

1 dimrit dhe, sipas analizës tuaj, ata po bëheshin gati për
2 aktivitete ushtarake apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Dhe një pjesë të madhe të shkurtit e kanë bërë stërvitjen
5 në disa vende të ndryshme përveç Mitrovicës, por janë
6 stërvitur edhe në vende të tjera të shumta në Kosovë, duke ju
7 dhënë të gjithëve përshtypjen që ato po bëheshin gati për të
8 sulmuar, a është e vërtetë kjo?

9 PË. Po.

10 PY. Më kujtohet në veçanti nga jugu që të ketë ndodhur një
11 gjë e tillë.

12 PË. Gjatë kësaj periudhe, domethënë gjatë kësaj stërvitjeve,
13 gjatë këtyre stërvitjeve gjatë dimrit, dhe lidhur me këtë dua
14 që t'ju lexoj diçka në mënyrë të tillë që t'ju orientoj pak. E
15 di që kjo çështje është trajtuar edhe në librin "Siç është
16 parë, ashtu është treguar", por dua që t'ju kujtoj lidhur me
17 këto zhvillime.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Për procesverbal, është dokumenti
19 SPOE00198098 deri në 00198366, dua që të paraqitet në ekran
20 faqja 198106.

21 PY. Ndërkohë që Sekretarja paraqet këtë faqe, këto veprimtari
22 ushtarake që janë planifikuar në janar, kanë zgjatur në janar,
23 në shkurt, dhe kanë vazhduar deri në mars apo jo, përpara se
24 ju të largoheshit nga Kosova, e vërtetë kjo?

25 PË. Po.

1 PY. Nëse do të shohim në ekran komentin në paragrafin që
2 fillon "Ngjarjet e tjera që kanë të bëjnë me këtë aspekt..."
3 "... në periudhën përpara 20 marsit ishin vrasjet e
4 shqiptarëve të Kosovës nga policia në Rugovë në Rakovinë më
5 vonë në janar, dhe nisja e stërvitjes së dimrit të ushtrisë
6 jugosllave që përfshinte granatimin e fshatrave dhe dëbimin me
7 forcë të fshatarëve në Vushtri, në shkurt dhe në mars. Një
8 ofensivë ushtarake dhe policore në Kaçanik në shkurt ku
9 përdorej si taktikë shkatërrimi dhe djegia e shtëpive të
10 civilëve për të pastruar zonën e UÇK-së. Gjithashtu, kanë
11 ndodhur dhe sulme të dhunshme të policisë në një lagje
12 shqiptare në Prishtinë në fillim të marsit dhe vrasja e dy
13 oficerëve të policisë. Përveç vrasjeve në Reçak këto ngjarje
14 tregojnë për një praktikë të abuzimeve të rënda nga forcat
15 jugosllave dhe serbe kundër popullsisë civile. Kjo praktikë e
16 abuzimit ka ndodhur apo shfaqur pas 20 marsit nga përshtimet
17 e dhëna nga refugjatët."

18 Pra, duke parë këtë pjesë, i takon që taktika e
19 autoriteteve serbe ose nga MUP-i ose nga armata jugosllave
20 ishin një përpjekje që të pastronin ose të spastronin zonat e
21 UÇK-së, a është e vërtetë kjo dëshmitare?

22 PË. Po.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që ky
24 dokument të pranohet në provë materiale.

25 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kam kundërshtim.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 33

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, Gjykatës.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti

3 SPOE00198098 deri në 00198366 në faqen -- vetëm një faqe doni,
4 z. Kehoe?

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, vetëm faqen që pamë në ekran.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
7 faqja 198106 do të pranohet si provë materiale.

8 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
9 të marrë numrin e provës materiale P743.1.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] A mund të vazhdoj, i nderuar
11 Gjykatës?

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Në rregull, dua që të shikojmë
14 dokumentin SPOE00198367 deri në 198834, faqen 198780, më
15 konkretisht. Mendoj që po shikojmë tek faqja 198780. Të shohim
16 pjesën e parë, paragrafin e parë të kësaj faqeje. Znj.
17 Mitchell, ju lutem hidhini një sy paragrafit të parë.
18 PY. Në fakt fillon në fjalinë e parë pas pikës.

19 "Ndërkohë që angazhimet e armatosura ndërmjet forcave
20 jugosllave serbe dhe të UÇK-së vazhduan në këto zona, të
21 'stërvitjeve' u bë e qartë që këto 'stërvitje' kishin një
22 synim strategjik që armata jugosllave të siguronte rrugën
23 kryesore dhe rrugën hekurudhore ndërmjet Mitrovicës dhe
24 Prishtinës duke i shtyrë UÇK-në në malet e Çiçavicës. Këto
25 stërvitje kishin ndikim mbi fshatrat afërsisht 15 kilometra

1 shtrirje rrugore dhe hekurudhore në pjesën veriore dhe
2 perëndimore dhe jug, në jug të Vushtrrisë; dhe në fund të
3 rrugës në Novolan dhe Bukosh, thuajse në qendër të kësaj
4 shtrirjeje. Armata jugosllave i ka shtrirë më tepër
5 veprimtaritë e saj në këto zona. Në jug të Vushtrrisë,
6 afërsisht më datën 10 mars, drejt Mihaliqit dhe Dervarës,
7 përgjatë rrugës kryesore, dhe maleve të Strofçit.”

8 Pra, në qoftë se do të marrim parasysh këtë paragraf, del
9 që MUP-i dhe armata jugosllave po mundohen që të konsolidojnë
10 kontrollin në rrugën kryesore të transportit midis Mitrovicës
11 dhe Prishtinës, a është kështu?

12 PË. Po, e saktë.

13 PY. Kjo ishte jetike, shumë e rëndësishme për shqetësimet ose
14 për arsyet e tyre ushtarake sepse Mitrovica është një qytet i
15 madh përpara se ti të kalosh në Kosovë, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. Sulmi i tyre ishte, përveç heqjes së civilëve nga kjo
18 rrugë dhe nga fshatrat përreth dhe, në pajtim me atë çfarë ju
19 shkruani, qëllimi kryesor i tyre ishte që UÇK-në ta shtynin
20 dhe ta bënë që të shkonin në malet e Çiçavicës në mënyrë të
21 tillë që UÇK-ja të mos ishte kërcënim për armatën jugosllave
22 apo për MUP-in, ndërkohë që ato vazhdonin me këtë lloj
23 aktiviteti, a është e vërtetë kjo?

24 PË. Po.

25 PY. Pra, kemi të bëjmë me një operacion strategjik për arsye

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 35

1 taktike, për këtë stërvitje të dimrit si pjesë e planit të
2 përgjithshëm serb për të mundur UÇK-në, e vërtetë kjo?
3 PË. Po.

4 PY. Ndërsa kjo ndodhte --

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe për këtë arsye dua që të
6 shikojmë volumin 2 të raportit "Siç është parë, ashtu është
7 treguar" -- jo, volumi 1 në fakt, kërkoj që të paraqitet
8 dokumenti SPOE198792.

9 Ju kërkoj ndjesë që jam shpejt.

10 Ndërkohë që po presim që të paraqitet dokumenti, do
11 kërkoj që të paraqitet, të pranohet si provë materiale pjesa e
12 dytë, nuk mendoj që i kam përmendur këto dokumente më përpara.
13 Bëhet fjalë për faqen 198106, dhe 198780.

14 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mendoj që
15 dokumenti që përfundon me 106 është pranuar si provë
16 materiale, sa i takon dokumentit që përfundon me 780 nuk kemi
17 kundërshtim. Vetëm dua të theksoj që, edhe një herë siç dje,
18 kërkoj që poshtëshënimet të përfshihen në prova materiale
19 gjithashtu.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Sa për procesverbal, i nderuar
21 Gjykatës, dua të them që pajtohem me kërkesën e Prokurorisë që
22 edhe poshtëshënimet të jenë të pjesë e dokumenteve të pranuar
23 si prova materiale.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
25 SPOE00198367 deri në 0019834, në faqen 198780, plus

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 36

1 poshtëshënimet, pranohen si prova materiale.

2 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
3 të pranohen dhe marrin provën, numrin e provës materiale
4 P743.3. Dhe nuk e di në qoftë se mund të më jepni numrin ERN
5 për shënimet në fund të faqes.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] A mund të vazhdoj, i nderuar
7 Gjykatës?

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, edhe
9 dokumenti tjetër pranohet.

10 Z. KEHOE: [Përkthim]
11 PY. Në rregull, vazhdojmë më tej me pyetjet që kanë të bëjnë
12 me stërvitjet e dimrit. Pra, këtu thua që "shumë persona janë
13 prekur, janë prekur nga stërvitjet e dimrit". Dhe më tej
14 thuhet që "zona në lindje të lumit u mbush plot me persona të
15 zhvendosur".

16 Pra, sa i takon këtij shkurtimi ose akronimi që keni
17 përdorur në raportin tuaj, "IDP", për këtë e keni fjalën, për
18 njerëzit e zhvendosur brendapërbrenda apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. "Megjithatë, afërsisht nga marsi kjo zonë u granatua po
21 ashtu." Po ashtu vijohet më tej që, "u bënë dëbime nga
22 fshatrat në zonë në periudhën nga mesi i prillit, 15 prilli,
23 më 15 prill shqiptarët e Kosovës të Prilluzhës dhe të
24 fshatrave përreth u urdhëruan që të largoheshin."

25 Nuk është e thënë që të lexojmë të gjithë paragrafin,

1 megjithatë mund të vazhdoni dhe me pjesën tjetër që thuhet që,
2 popullsia shqiptare u detyrua që të largohet nga fshatrat, u
3 vranë shumë civilë dhe u detyruan që të largoheshin prej aty,
4 apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Pra, mund të kuptohet nga motivimi se motivimi ka qenë
7 konferenca e Rambujesë, apo jo? Dhe ana tjetër, MVK-ja duhej
8 që të largohej si rezultat i zhvillimeve të konferencës së
9 Rambujesë?

10 PË. Po.

11 PY. Po gjatë kësaj periudhe, armata jugosllave shënjestronte
12 individët me lidhje me UÇK-në apo jo?

13 PË. Po.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Në rregull, kalojmë te volumi 1,
15 SPOE00198172. Nga mesi i paragrafit, që "Kishte një
16 praktikë..."

17 PY. Për shembull, thuhet që, tek pjesa e dytë që thua që:

18 "Kishte një praktikë të shënjestrimit të njerëzve që
19 kishin lidhje me UÇK-në ose që të kishin lidhje me UÇK-në,
20 ndërkohë që përpara 20 marsit diçka e tillë mund të kishte
21 çuar në arrestim, (shikoni kreun 9, arrestimi arbitrar dhe
22 ndalimi)..."

23 "Pas kësaj date synimet e forcave jugosllave dhe serbe
24 kishin të ngjarë që të ishin më shumë vrastare."

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Në qoftë se do të kalojmë më pas,

1 tek një faqe tjetër është dokumenti SPOE001988272 [Sipas
2 përkthimit].

3 PY. Znj. Mitchell, do kaloj disa pjesë, do mundohem t'i kaloj
4 shpejt në interes të kohës, megjithatë, në qoftë se keni
5 ndonjë gjë të paqartë më bëni pyetje.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Në fund të kësaj faqe, tek titulli
7 "Vrasjet".

8 PY. "Shumë deklarata flasin për ekzekutimin e të rinjve,
9 shpeshherë për shkak të faktit që ata vinin nga vende të cilat
10 njiheshin si pika të forta të UÇK-së, dhe herë të tjera për
11 shkak të faktit që ata kishin mbiemrat me luftëtarët e njohur
12 të UÇK-së. Megjithatë, në rastet më të mëdhaja, ata dukej se
13 ishin vrarë për shkak të faktit që ishin meshkuj dhe ishin të
14 rinj dhe kishin mundësi që të kyçeshin në UÇK.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Do kalojmë në një tjetër paragraf,
16 për procesverbal është dokumenti në faqen, është një paragraf
17 në faqen 198167.

18 PY. Paragrafi i mesit ku fillon me "Përshkallëzimi i
19 mëtejshëm...". Këtu thuhet "Përshkallëzimi i mëtejshëm pas 24
20 marsit 1999.

21 Kjo është data kur ka filluar bombardimi i NATO-s, 24
22 marsi, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. "Vrasja masive, të përbashkëta dhe arbitrare u bënë një
25 fenomen i përgjithshëm në gjithë Kosovën me fillimin e

1 bombardimeve të NATO-s kundër ish-Jugosllavisë në natën e 24-
2 25 marsit.”

3 Znj. Mitchell, ajo që kemi këtu, dhe çfarë është
4 dokumentuar nga MVK-ja është që armata jugosllave ose MUP-i ka
5 vazhduar që të shënjestrojë persona të cilët lidheshin ose
6 kishin, perceptoheshin që kishin një lidhje me UÇK-në apo
7 pikat e forta, ato vendet që ishin në kontrollin e UÇK-së. Dhe
8 në vend që t’i ndalonin, t’i arrestonin persona të tillë, i
9 vrisnin perona të tillë që i konsideronin me lidhje me UÇK-në,
10 apo jo, dëshmitare?

11 PË. Po.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që këto
13 tri paragrafë të pranohen si prova materiale. Mbase ishin më
14 shumë sesa tre, nuk e di.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Njëri
16 dokument ishte 198792, tjetri 198172, dhe i treti është
17 198272, dhe i katërti 198167.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Do kërkoja që të gjitha të pranohen
19 si prova materiale.

20 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim, por siç e
21 thashë disa herë, kërkojmë që të pranohen dhe poshtëshënimet
22 si prova materiale.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për secilin
24 prej këtyre dokumenteve që u përmendën nga Avokati, do
25 pranohen si prova materiale së bashku me shënimet përkatëse.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 40

1 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
2 faqja SPOE00198792 do të shtohet tek prova materiale P743.3.

3 Ndërkohë që nga dokumenti SPOE00198098 deri në 00198366,
4 faqja SPOE198172, 198272 dhe 198167, do të shtohen në provën
5 materiale P743.1.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Të vazhdojmë më tej.

8 PY. Gjatë kësaj periudhe, përveç vrasjeve kishte dhe
9 shkatërrime të ndërtesave të komunave nga serbët, kishte
10 përdhunime nga serbët, kishte shkatërrime të fshatrave nga
11 serbët. Gjatë gjithë kësaj periudhe kohore, apo jo dëshmitare?
12 PË. Po.

13 PY. Ajo çfarë keni vëzhguar, çfarë keni parë, jo vetëm kur u
14 larguat nga Kosova, por edhe kur ishit në kampet e refugjatëve
15 ishte fakti që kishte qindra mijëra shqiptarë të Kosovës që
16 ose u detyruan që të largoheshin ose u larguan vetë si
17 rezultat i kësaj pune shkatërruese nga armata jugosllave, nga
18 MUP-i dhe nga paramilitarët serbë, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Sa i takon refugjatëve dhe personave që u larguan këtu
21 përfshiheshin edhe ushtarë që kishin qenë të kyçur me UÇK-në,
22 apo jo? Ata ishin larguar së bashku me familjarë të tyre,
23 kështu?

24 PË. Po.

25 PY. Ajo çfarë ka ndodhur gjatë kësaj periudhe kohe -- dua të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 41

1 gjej pjesën që kjo reflektohet në raportin tuaj.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Për procesverbal, është volumi 1,
3 dokumenti SPOE198243. Atëherë, ju lutem shfaqeni këtë faqen
4 tek volumi 1 i raportit. Në fillim të faqes.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe,
6 duhet të shpjegoni se çfarë rëndësie ka ky material që po i
7 prezantoni dëshmitares, sepse nuk ka lidhje fare as me akuzat
8 as me të akuzuarit në këtë çështje gjyqësore.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se duhet të jap
10 shpjegime në prani të dëshmitares, apo mund t'jua jap pa atë
11 në sallë.

12 Ajo çfarë po ndodh, të nderuar Gjykatës, është se si
13 rezultat i këtyre sulmeve, dhe faktit që kishte sulme nga
14 Serbia në zonat e UÇK-së, ku UÇK-ja u ul shumë në numra. Dhe
15 të gjithë këta njerëz, pjesa dërrmuese e njerëzve, u larguan.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe çfarë
17 lidhje ka kjo?

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Ka ndikim mbi numrat shumë të ulur
19 të UÇK-së, domethënë, nga fakti që njerëzit ikën, numrat e
20 ushtarëve të UÇK-së u ulën në mënyrë të konsiderueshme.

21 Dhe rëndësia është që ushtarët e UÇK-së u larguan dhe
22 pastaj u është dashur që të ktheheshin në qershor.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kemi
24 dëgjuar këtë retorikë disa herë. Ne nuk po argumentojmë në
25 qoftë se ishin të paktë në numër apo jo, ose në qoftë se janë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 42

1 kthyer këta ushtarë mbrapsht apo jo. Pra, ndoshta janë kthyer
2 jo për shkak të mizorive të ndodhura, por ndoshta janë kthyer
3 vetëm thjesht nga fakti që kishte ardhur momenti për t'u
4 kthyer dhe thjesht dëshironin që të ktheheshin.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Do të vazhdojmë më tej. Do të doja
6 që thjesht ta cek këtë si temë dhe pastaj të vazhdoj më tej,
7 nëse më lejoni.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
9 pyetjet bëjini për material që është relevant për këtë
10 dëshmitare.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] E kuptoj.

12 PY. Duke marrë parasysh udhëzimet e Gjykatësit, mbi 18.000
13 [Sipas përkthimit] refugjatë u larguan dhe kishte, numri
14 dërrmues i popullsisë shqiptare u zhvendos apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. Kur përfunduan bombardimet e NATO-s atëherë ju filloni --
17 ja ta formuloj ndryshe. Kur përfundoi, përfunduan bombardimet
18 dhe kur u arrit marrëveshja e paqes, kishte shumë serbë që u
19 larguan me ushtrinë dhe me MUP-in, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe afërsisht nga këto, këta persona, pra nga këta 80 000
22 [Sipas përkthimit] vetë që u larguan, ata filluan që të
23 ktheheshin vetë, në mënyrë spontane, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Po, spontane. Dhe ju këtu keni përfshirë edhe ushtarët e

1 UÇK-së me të cilët keni folur në kampet e refugjatëve, apo jo?

2 PË. Nuk më kujtohet që të kem folur me ushtarë të UÇK-së në
3 kampet e refugjatëve.

4 PY. Por ju keni thënë që ka pasur ushtarë të UÇK-së në kampet
5 e refugjatëve?

6 PË. Po.

7 PY. Por kur ata u kthyen, ju gjithashtu folët më herët që
8 panë që shtëpitë e tyre ishin djegur, që posedimet e tyre që
9 gjërat e tyre, pronat e tyre, ishin vjedhur, dhe që anëtarët e
10 familjes ishin vrarë, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Sa i takon mënyrës se si e morën vesh ata se çfarë kishte
13 ndodhur, sigurisht mendoj që për shkak të asaj çfarë kishte
14 ndodhur, atyre iu rrit inati ndaj këtyre personave që ishin
15 kthyer, në mënyrë të kuptimshme, apo jo?

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtoj.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Atëherë, më lejoni ta them ndryshe,
18 znj. Mitchell. Ju u kthyet në qershor dhe, mbështetur në
19 hetimet e MVK-së, ju mësuat që njerëzit ndërkohë që mësuat se
20 çfarë kishte ndodhur me shtëpitë e tyre, me njerëzit e tyre të
21 dashur, me fshatrat e tyre, ata u inatosën shumë dhe ishin
22 shumë të mllefosur si rezultat i asaj që kishte ndodhur, apo
23 jo?

24 PË. Po.

25 PY. Dhe, në fakt, juve volumin e dytë të raportit tuaj e keni

1 quajtur hakmarrje dhe shpagim, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Domethënë, pak a shumë terminologjia e përgjithshme ka
4 qenë kjo, apo jo dëshmitare?

5 Njerëzit po ktheheshin, dhe bënë larje hesapesh, ju keni
6 folur edhe për larjen e hesapeve, apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. Mund ta kalojmë këtë pjesë relativisht shpejt. Në
9 përmbledhjen ekzekutive të volumit 2 të raportit.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe volumi 2 është dokumenti
11 SITF00001529-00001871, dua që të paraqitet në ekran dokumenti
12 që përfundon me 1539. Është përmbledhja ekzekutive e këtij
13 dokumenti.

14 Paragrafi i dytë, tek konstatimet, gjetjet. Le të
15 vazhdojmë me paragrafin e dytë.

16 PY. "Lajtmotivi i dallueshëm, i qartë që del nga ky raport".

17 Është Volumi 2, znj. Mitchell. Është:

18 "Hakmarrja. Në të gjithë rajonin, në të gjithat zonat
19 dëshira për hakmarrje ka krijuar një klimë ku janë kryer shumë
20 shkelje të të drejtave të njeriut. Në sytë e sulmuesve,
21 viktimat ose kishin marrë pjesë ose besoheshin që të kishin
22 marrë pjesë në shumë abuzime të të drejtave të njeriut që
23 përshkruhen në raportin "Siç është parë, ashtu dhe është
24 treguar", ose besohet që të kenë bashkëpunuar me forcat e
25 sigurimit serb ose me forcat jugosllave. Në këtë klimë

1 hakmarrjeje, një kategori e tretë e viktimave dolën në pah.
2 Këto ishin individë ose grupe që ishin persekutuar thjesht për
3 faktin që nuk kishin vuajtur më përpara.

4 "Ndërkohë që dëshira për hakmarrje është vetëm se
5 njerëzore, akti i hakmarrjes në vetvete nuk është i pranueshëm
6 dhe nuk duhet që të trajtohet pa, duhet të trajtohet si
7 ç'duhet. Efektet e popullsisë shqiptare të Kosovës për sa i
8 takon diskriminimit të akumuluar dhe nënshtrimit gjatë
9 dekadave të fundit dokumentohet dhe nuk mund të ketë
10 absolutisht asnjë dyshim lidhur me këtë. Të gjitha familjet
11 janë të prekura dhe kjo duke marrë parasysh situatën pas
12 luftës, vetëm një sistem i fortë i zbatimit të ligjit mund të
13 parandalojë klimën e hakmarrjes që ka çuar në dhunë të
14 vazhdueshme. Mungesa e një përgjigje të konsoliduar ka
15 kontribuar për mungesën e ligjit që është një situatë dhe një
16 faktor vendimtar dhe që është goxha i përhapur në Kosovë, duke
17 e lënë të pakontrolluar një dhunë të tillë."

18 A pajtoheni me këtë përshkrim, Dëshmitare?

19 PË. Po, pajtohem.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj që ky dokument, kjo pjesë e
21 kësaj faqe të pranohet si provë materiale.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
23 SITF000015 [Sipas përkthimit] në faqen 1539 pranohet si provë
24 materiale.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Me gjithë respektin, Prokurore, nuk

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 46

1 duket sikur kjo pjesë nuk ka poshtëshënim [Sipas përkthimit].

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk duket
3 sikur ka poshtëshënim.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Po pati, do ta pranojmë dhe
5 poshtëshënimin si provë materiale.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të nderuar
7 Gjykatës, kjo faqe do të shtohet në provën materiale P743.2.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund të
9 vazhdoni.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Ndjesë, kërkoj mund të kalojmë të
11 njëjtin vëllim. 1529, pra 1529 deri 1827, faqe 1621 [Sipas
12 përkthimit]. I treti nga sipër. Në rregull. Në fakt është pika
13 e dytë që duket aty:

14 PY. "Në Zhegër, të komunës së Gjilanit, udhëheqësi i LDK-së
15 pranoi se paligjshmëria e tanishme motivohej nga hakmarrja. Ai
16 tha se popullata shqiptare kishte filluar që të digjte dhe
17 plaçkiste shtëpitë e serbëve, kur ktheheshin në shtëpi dhe kur
18 panë se në ç'gjendje ishin katandisur shtëpitë e tyre."

19 Pra ju mund të konfirmoni pra që kjo ishte bërë për
20 qëllime hakmarrjeje, kështu?

21 PË. Po.

22 PY. Sa u takon të gjithë kësaj shtate, znj. Mitchell, do të
23 flas tani për kthimin e refugjatëve dhe dhunës pas lufte, për
24 të cilën keni folur në vëllimin 2. Dëshiroj tani t'ju tregoj
25 një video.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Që ka numër DHT01468 deri në 468.

2 Është Ken Bacon, zëdhënësi i Departamentit -- të
3 Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Data është 5
4 qershor 1999.

5 [Luhet videoincizimi]

6 "Fakti është që nuk mendoj se serbët do të duan që të
7 qëndrojnë këtu, do të duan të kthehen në Serbi dhe nuk e dimë
8 se sa i madh është minoriteti serb. Aty mund të jetë 100 000,
9 mund të jetë dhe diçka më shumë se aq, por me kthimin të
10 shqiptarëve të Kosovës ne supozojmë që shumë serbë me shumë
11 gjasë do të kthehen në Serbi.

12 "Duket sikur ju po nxisni që serbët e Kosovës të
13 largohen.

14 "Unë nuk po i nxis fare. Thjesht po citoj këtu faktet."

15 Z. KEHOE: [Përkthim]

16 PY. Nëse më lejon, duke pasur parasysh këtë fluks të
17 refugjatëve që po ktheheshin, ishte e parashikueshme për ju si
18 profesioniste se kjo lloj dhune do të ndodhte, apo jo?

19 PË. Jo.

20 PY. Në fakt ky është një, ishte, e kam fjalën që për serbët
21 kjo do të ishte një vend i vështirë për të qenë, apo jo?

22 PË. Po.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Në këtë moment e ofrojmë këtë në
24 prova.

25 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk e di se si lidhet, me lëndën,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 48

1 por s'kam kundërshtim. Thjesht dëshmitarja duket se nuk
2 pajtohet.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Duket se është autentifikim,
4 verifikim.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT01468 deri
6 në DHT01469 [Sipas përkthimit] pranohet.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo
8 do të marrë numrin e provës materiale 1D76.

9 Z. KEHOE: [Përkthim]

10 PY. Pa hyrë në hollësi, znj. Mitchell, ju e kuptuat se do të
11 ishte një kohë e vështirë për pakicat serbe të cilat do të
12 qëndronin në Kosovë, kështu?

13 PË. Po.

14 PY. Pra, kishit këta refugjatë që po ktheheshin, dhe po
15 kështu kishte edhe njerëz të cilët po ktheheshin që ishin dhe
16 kriminelë, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. Dua tani të kaloj në vëllimin 2, në faqen SITF1581. 1581,
19 vëllimin 2. Jo, më falni, 1581.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Në vëllimin 2. Në pjesën e sipërme
21 të faqes.

22 PY. Në zonën e Gjilanit ku MVK-ja kishte zyrë.

23 "Elementet e organizuara kriminale mbase janë të
24 përfshira në këto zhdukje, ... megjithëse në një rast u bë dhe
25 kërkesë për gjobë, për kthimin e pengut. Ky shembull më

1 sugjeroi që krimineli që përfitoi nga rastet kur marrin vesh
2 që zhduken njerëzit, vendosin që të kërkojnë me sukses marrjen
3 e një shume parash për kthimin e pengut, ose se këta kryes të
4 krimit vendosin që të përfitojnë më shumë para.”

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju lutem, tashti të kalojmë edhe në
6 faqen 1588. Në fund të kësaj faqeje, ju lutem. “Krimi i
7 organizuar”.

8 PY. Përsëri në zonën e Gjilanit, pra:

9 “Krimi i organizuar historikisht ka qenë i fortë në zonën
10 e Gjilanit. Besohet se në mungesë të një sistemi policor apo
11 gjyqësor dhe prania e organizatave ndërkombëtare ka
12 kontribuar në një mjedis i cili ka çuar në rritje të
13 veprimtarisë së krimit të organizuar.”

14 Pra, krahas rikthimit të refugjatëve, që kanë parë dhe
15 këto shkatërrimet e pronave të tyre, ju dokumentoni në
16 vëllimin 2, se kishte edhe elementë të krimit të organizuar që
17 shkaktonin probleme të konsiderueshme në këto zona, apo jo?
18 PË. Po.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, propozojmë që
20 t’i fusim në prova këto dy citime.

21 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Më duket se pjesa e parë e
22 shkëputur është tashmë në prova, është me numrin 743.2. Nuk
23 kemi kundërshtim për faqen e dytë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SITF1588 do
25 të pranohet në provat.

1 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, merr
2 -- pra i shtohet provës materiale P743.2.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Tani të kalojmë në një pjesë të
4 fundit të shkëputur në vëllimin 2, me numër faqe SITF15898.
5 Dhe këtu flitet për zonën e Gjakovës.

6 PY. E kam fjalën për në, është në faqen mu përpara pikës që
7 thotë "E drejta për jetën...":

8 "Kriminaliteti ordiner dhe krimi i organizuar janë po
9 kështu të përhapura në këtë komunë. Në fund të shtatorit, për
10 shembull, filloi që të qarkullojnë kartëmonedha, paraja falso,
11 e falsifikuar, dinarë, dhe u rrit numri i vjedhjeve të
12 autoveturave. Faktorë të komplikuar në luftën kundër krimit
13 janë edhe bandat e ndryshme kriminale të cilat KFOR-i dhe
14 policia e UNMIK-ut besojnë se janë aktive në këtë komunë, pra.
15 Edhe kufiri i gjatë ndërkombëtar me Shqipërinë e bën lëvizjen
16 e lehtë dhe zbulimin e vështirë."

17 Pra, këto faktorë komplikues e bënin të vështirë luftën
18 kundër këtij aktiviteti kriminal?

19 PË. Po.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Është koha për ta ofruar këtë në
21 prova materiale.

22 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe për aq sa janë dhe
24 poshtëshënimet.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prova me

1 SITF198589 pranohet në prova gjyqësore.

2 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Kjo merr, kjo i shtohet
3 provës me numër P732.2.

4 Z. KEHOE: [Përkthim]

5 PY. Siç e vutë re, znj. Mitchell, në analet e OSBE-së dhe e
6 kam fjalën për dokumentin me numër DHT02840 deri në 02856,
7 faqja që më intereson është me numër DHT02852.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Po përpiqem që të gjej pjesën
9 përkatëse të faqes në mënyrë që ta lexojmë shpejt. Është në
10 fund të faqes, thjesht aty ku fillon --

11 PY. Është në katër rreshta, në rreshtin e katërt nga fundi,
12 më falni, në mes të fjalisë. Pra duke pasur parasysh këtë që:

13 "Vetëm një forcë ligjore e fortë dhe një sistem gjyqësor
14 mund ta kufizonte, pra, këtë hakmarrje dhe shpagim.

15 Duke pasur parasysh sfondin në të cilin funksionon vetëm
16 një sistem i fortë, vetëm një sistem i fortë policor dhe
17 gjyqësor mund të kufizonte klimën e shpagimit që çonte në
18 dhunë.

19 Pra, në fakt ju e keni shkruar këtë në vjetarin e vitit
20 2000 të OSBE-së, kështu?

21 PË. Duhet ta pranoj që s'më kujtohet që ta kem shkruar unë
22 këtë në vjetar, por gjithsesi do të pajtohesha me këtë
23 deklaratë.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Do të doja që ta përfshinim këtë
25 gjithsesi duke qenë se është shkruar në vjetar. Është thjesht

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 52

1 në artikull që e keni shkruar ju. Pra duam që të ofrohet në
2 provat, të pranohet në prova gjyqësore.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT02 [Sipas
4 përkthimit] dhe deri 02856, specifikisht në faqen përkatëse,
5 pranohet.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Pra kam parasysht dhe orën.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
8 do bëjmë pushimin.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Kjo merr numrin e provës
10 1D77.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Ju lutem, shoqërojeni dëshmitaren të dalë nga salla.

13 Tani do të bëjmë pushimin prej gjysmë ore, dëshmitare.

14 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

15 Z. KEHOE: [Përkthim] [Përkthim] Nëse mund të përmend
16 diçka, e di që mund të më korrigjojnë të tjerët nëse e kam
17 gabim.

18 Po duket se Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së,
19 me numër 1244 nuk është futur ende në provat gjyqësore. Bëra
20 një kërkim, unë kur po flisja para Trupit Gjyqësor javën që
21 shkoi kujtoja se ishte, por nuk është në provat gjyqësore.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse mund të
23 dalë dikush të na paraqesë dokumentin do ta sqarojmë këtë më
24 mbrapa.

25 Bëjmë këtu ndërprerjen e seancës deri në orën 11.30.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 53

1 --- Pauza fillon në orën 11.01

2 --- Seanca rifillon në orën 11.30

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni ju
4 lutem.

5 Znj. Asistente e sallës mund të fusni dëshmitarin.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Në mundet, një dokument -- një
7 çështje tjetër. Sa i takon provës së fundit me numër 1D77 kam
8 një sugjerim nga znj. Mayer që ta vendos këtë në kontekst duke
9 shtuar faqen e parë për të parë se ky është vjetari i OSBE-së,
10 mbase, sepse mundet që njerëzit mund të mos ta kuptojnë që
11 është ky dokument.

12 Nëse mundet mund ta shtojmë këtë sipas sugjerimit të znj.
13 Mayer?

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta
15 shtojmë, në rregull, shumë mirë. Do të shtohet dhe do t'i
16 japim një numër.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
18 DHT me numër përkatës që faqja e parë së bashku me DHT02852 do
19 të jetë Prova 1D77.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
21 Ju lutem Asistentes së Sallës, shoqëroni dëshmitarin të hyjë
22 në sallë.

23 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
25 Dëshmitare, do të vazhdojmë me pyetjet që do t'i bëjë z.

1 Kehoe.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit.

3 PY. Shpresoj që të keni pirë ndonjë kafe a diçka, znj.

4 Mitchell. Por ne po flisnim para pushimit me faktin që

5 nevojitej zbatimi i fortë i ligjit dhe një sistem gjyqësor,

6 sepse nuk kishte ligje, s'kishte gjykata as polici as

7 struktura juridiksionale as shoqëri civile. Dhe për të futur

8 dhe Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244. Më

9 besoni që nuk --

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Kjo është me numër 6811.

11 PY. Por nuk do ta kalojmë të gjithën.

12 Znj. Mitchell e di se ju keni dijeni për Rezolutën e

13 Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244. Por e thënë më thjesht,

14 kjo të gjithë autoritetin juridik në Kosovë ia jepte OKB-së,

15 apo jo?

16 PË. Po.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ofrojmë për të

18 futur në provat materiale Rezolutën e Këshillit të Sigurimit

19 të OKB-së 1244.

20 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rezoluta e

22 Këshillit të Sigurimit 1244 pranohet.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do

24 t'i caktohet numri i Provës 1D78 dhe vërej se është e

25 klasifikuar si konfidenciale në *Legal Workflow*.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 55

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Kjo nuk ka pse të jetë
2 konfidenciale.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është
4 publike.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk e di kush e ka bërë, juve apo
6 dikush tjetër. Nuk e dimë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dikush.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Tani duam që t'i kthehemi
9 Rregullores së UNMIK-ut të 1991 [Sipas përkthimit] që është në
10 numrin 26028 deri në 26030. Na intereson rubrika 1.1.

11 PY. Në këtë pikën 1.1 mund ta lexojmë që:

12 "I gjithë autoriteti legjislativ dhe ekzekutiv sa i takon
13 Kosovës, përfshirë dhe administrimin e gjyqësorit i ngarkohet
14 UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi i Posaçëm i Sekretarit
15 të Përgjithshëm".

16 Znj. Mitchell, pra, ky është fakt. Edhe këtu bëhet qartë
17 se sa i takon administrimit të të gjithë kompetencave
18 legjislative dhe ekzekutive i ngarkohet Përfaqësuesit të
19 Posaçëm.

20 PË. Po.

21 PY. Ofroj që të futet në provat gjyqësore.

22 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 026068 deri
24 026030. Në pikën 1.1 pranohet.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 56

1 kjo i caktohet numri 1D79. Shënoj që edhe kjo është e
2 klasifikuar si konfidenciale.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Kjo është publike. Nuk mendoj se ka
4 nevojë për këtë lloj klasifikimi.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
6 kundërshtim për ta riklasifikuar këtë si publike?

7 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
9 riklasifikohet si publik.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Nëse mundet do të donim që të
11 pranohej i gjithë dokument. Jo vetëm ai që sapo lexuam.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
13 çaktivizuar]

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Nëse mundet Gjykatës ta vendosim të
15 gjithë dokumentin në prova materiale. Pra, nga 026028 deri në
16 026030.

17 ZNJ. MAYER: [Përkthim] S'kemi kundërshtim për të gjithë
18 dokumentin.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, në
20 rregull. Heqim seksionin 1.1 dhe do të pranohet në prova
21 gjyqësore i gjithë dokumenti.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. Mund të vazhdoj?

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mundet.

24 Z. KEHOE: [Përkthim]

25 PY. Ky Përfaqësues i Posaçëm ishte Sergio de Mello, apo jo?

1 PË. Po.

2 PY. Tani t'i kalojmë të tregojmë dokumentin.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Me -- 002635 [Sipas përkthimit] deri
4 në 00265443. Më interesojnë faqet nga 265440 deri në 41. Nëse
5 mund t'i tregojmë. Znj. Mitchell faqja e parë, përpara se të
6 kalojmë tek faqja në fjalë shikojmë faqen e parë ju lutem.

7 PY. Dua që t'ju orientoj se çfarë është ky dokument. Nëse nuk
8 ju kam orientuar më thoni. Është takim i task-forcës për
9 Kosovën i 19 qershorit 1999.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Kalojmë tani në 4041 SITF002644041
11 [Sipas përkthimit]. Është numri 4, më poshtë ju lutem. Kjo
12 është 440. Mund të kaloni më poshtë edhe më shumë, ja ku
13 është, në fund. Po, duke filluar nga pika 3.

14 PY. Janë shënime nga një takim:

15 "Në orën 12:10 bëra takim me z. Strohmeyer...".

16 E njihni z. Strohmeyer?

17 PË. Po.

18 PY. "...sa i takon Gjykatës Themelore të Prishtinës, pra,
19 Gjykatës së Rrethit të Prishtinës dhe për hartim të një
20 propozimi për një kushtetutë. Ia dhashë, ia dorëzova projekt-
21 propozimin Komisionit të Venecias me shënimet e mia.

22 Ai dorëzoi dhe një deklaratë publike nga Përfaqësuesi i
23 Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm z. Sergio Vieira de Mello
24 në të cilën thuhet ndër të tjera në përputhje me Rezolutën e
25 Këshillit të Sigurimit unë do të kryej funksionin e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 58

1 ekzekutivit të qeverisë gjatë periudhës tranzicionale derisa
2 të krijohen autoritetet e reja legjitime të cilat mund të
3 kalohen këto funksione. Me këtë cilësi, unë duke filluar nga
4 dita e ardhshme do të filloj me emërimin e administratorëve të
5 përkohshëm ndërkombëtarë. Të fillojmë me dislokimin e forcës
6 policore ndërkombëtare civile dhe të marrim hapat e nevojshme
7 për rivendosjen e një sistemi gjyqësor shumetnik dhe
8 demokratik në Kosovë”.

9 Pra, sa i takon deklaratës së ambasadorit De Mello, ky
10 ishte synimi i UNMIK-ut dhe i forcave të OKB-së kur hynë
11 brenda, apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Por kjo nuk ndodhi shumë shpejt, apo jo?

14 PË. Jo, nuk ndodhi shumë shpejt.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] E ofrojmë këtë dokument, vetëm këtë
16 pjesë të dokumentit për në provat gjyqësore.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm këto dy
18 faqe?

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Këto dy faqe dhe faqen e parë për të
20 kuptuar se nga vjen ky dokument.

21 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 0026435
23 [Sipas përkthimit] deri në 00265443 në faqe 265440 dhe 265441
24 plus faqen e parë pranohen.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

1 këto faqe marrim numrin e Provës Materiale 1D80, por edhe këto
2 janë të klasifikuara si konfidenciale.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo nuk ka nevojë të jenë
4 konfidenciale.

5 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Unë e kam pyetur, unë do t'i
6 kërkoj Gjykatës për gjithçka që është në dokumentin e ZPS-së.
7 Kjo ka numër ERN-je. Dokumenti që ne kemi -- ofruar kemi bërë
8 një kontroll për të parë nëse ka apo jo kufizime sipas
9 rregullës R107. Kështu që ju lutem të bëjmë dhe një kontroll
10 për të verifikuar që janë në përputhje me çdo kushtëzim që
11 mund të jetë vendosur kur të kemi marrë këto dokumente. E
12 marrë me mend nga numri i Provës Elektronike, por duhet që të
13 verifikojmë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
15 mund të -- ju lutem kujdesuni që të bëni verifikimet dhe të
16 thoni.

17 Z. KEHOE: [Përkthim]
18 PY. Znj. Mitchell, e gjithë administrata civile dhe forca
19 policore mori një periudhë të konsiderueshme kohore që të
20 ngrihej e të hynte në veprim, apo jo?
21 PË. Po.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Po të shikojmë provën 1D36 është
23 dokument nga vëllimi 2, por është në provat materiale -- është
24 në provat - më falni - gjyqësore.

25 PY. Jam i sigurt që e njihni. Megjithatë do t'jua tregoj.

1 Është një dokument në vëllimin tuaj që tregon rritjen e
2 forcave policore, është i saktë?

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju lutem nëse mund ta shohim edhe më
4 poshtë faqes.

5 DËSHMITARJA: [Përkthim] Po.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Mund ta shfaqim si një faqe. Po, në
7 rregull.

8 PY. Pra, ky është një pamje e saktë e forcave policore në si
9 në 30 tetor të vitit '99, në rregull?

10 PË. Po.

11 PY. Dhe po të shohim, pra, muajt qershor, korrik edhe gusht
12 nuk kishte fare polici të dislokuar nga UNMIK-u, kështu?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe për aq sa bëheshin arrestime këto bëheshin nga KFOR-
15 it, kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe aftësia për të arrestuar për të ndaluar, në fakt,
18 këtë gjë ata kanë refuzuar që ta bëjnë.

19 PË. Po. Ishin shumë rezistues ndaj kësaj ideje.

20 PY. Dhe si rezultat i këtij refuzimi për ta bërë këtë nuk
21 kishte thujse aspak forca ligjzbatuese, pra, zbatim të ligjit
22 në terren për shkak se të KFOR-it, përpara policisë së UNMIK-
23 ut nuk angazhohej në zbatimin e me forcë të ligjit, kështu?

24 PË. Po.

25 PY. Dhe madje edhe kur u vendos policia në shtator ishin një

1 forcë për nga numri mjaft e vogël, a është kështu?

2 PË. Po.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Tani të shikojmë një dokument tjetër
4 të SITF-së me numër 00172879 deri 00172884. Më duhet faqja
5 172882. Është një memorandum i UNMIK-ut i datës 16 shtator. Në
6 qoftë se Prokurorja ka ndonjë shqetësim sa i përket
7 materialeve të rregullës 70 atëherë mund të ta ketë parasysh
8 këtë se është dokument i SITF-së. Është siç thashë memorandum
9 i UNMIK-ut. Na duhet faqja SITF172882.

10 PY. Nuk e di në qoftë se është e lexueshme për ju kjo pjesë
11 në krye të faqes znj. Mitchell?

12 PË. Po, mundem ta lexoj.

13 PY. Është nga data 16 shtator 1999:

14 "Numri i policisë civile të UNMIK-ut është 800 [Sipas
15 përkthimit] që do të thotë një polic për 9 990 qytetarë. Sipas
16 raportit të nevojshëm në bazë të vendeve evropiane duhet të
17 jenë, për shembull, një polic për 400-700 civilë. Policia e
18 UNMIK-ut u përball me vështirësi të shumta në përpjekjet për
19 të mundësuar ushtrimin e duhur të kompetencave policore në
20 Kosovë".

21 Dhe kështu ishte edhe në shtator. Nuk kishte një forcë
22 policore efektive që do t'i përngjante një force policore të
23 një vendi civil, a është kështu?

24 PË. Po.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] E paraqes këtë dokument për pranim

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 62

1 si provë në varësi të kundërshtimeve, në qoftë se ka, të
2 Prokurores.

3 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime për pranimin e
4 dokumentit dhe nuk ka kundërshtim për riklasifikimin e këtij
5 dokumenti si publik.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
7 dokumenti riklasifikohet si publik dhe dokumenti SITF00172879
8 - 00172884 do të pranohet.

9 Doni të pranohet vetëm një faqe apo i gjithë dokumenti?

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Vetëm një faqe.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë faqja
12 172882 pranohet si provë materiale.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Ndoshta mirë është edhe në këtë rast
14 të shtojmë faqen e parë dhe ballinën në mënyrë që ta keni më
15 qartë kur t'i rishikoni këto dokumente më pas.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti me numër
18 00172879 do të merr numrin e Provës 1D81 dhe do të jetë
19 publik.

20 Z. KEHOE: [Përkthim]

21 PY. Në komentet që keni bërë në bisedën me ZPS-në, në
22 paragrafin 61 thoni:

23 "...mungesa e procesit gjyqësor shkaktoi që KFOR-i të mos
24 bënte arrestime që duhej t'i bënte".

25 A është kjo e saktë?

1 PË. Po.

2 PY. Përveç problemit të mungesës së policisë ju gjithashtu
3 morët raporte që kishte dhe mungesë të gjykatësve që të merrem
4 me shqyrtimin e çështjeve gjyqësore, a është kështu?

5 PË. Po.

6 PY. Tani do t'ju tregoj një raport të Mitrovicës për
7 periudhën 28, 29 qershor.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Dokumenti ka numrin SITF00385179
9 deri në 5180. Më intereson faqja 38510. Të shkojmë te faqja e
10 parë në mënyrë që dëshmitarja të ketë njëfarë ideje se për
11 çfarë po flasim.

12 PY. Domethënë është dokument që vjen nga Mitrovica për
13 periudhën qershor. Ndërkohë dua t'ju pyes këtë, Mitrovica
14 mbulohet nga KFOR-i francez, a është kjo e saktë?

15 PË. Po.

16 PY. Është pika e dytë. Nga kreu i faqes:

17 "KFOR-i i Francës e mbrojtën veten duke thënë që nuk kanë
18 gjykatës dhe avokatë në brigadën e tyre. Në këtë mënyrë KFOR-i
19 në Mitrovicë nuk mund të arrestojë kriminelë, elemente
20 kriminale dhe provokues dhe ky problem nuk është diskutuar dhe
21 nuk është zgjidhur edhe mbas aq përgatitjeve që nga
22 Rambujeja".

23 Domethënë ishte shumë e qartë për ju në MVK se nuk kishte
24 njëfarë plani paraprak në lidhje me këtë aspekt, a është kjo e
25 saktë?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 64

1 PË. Mendoj që kjo është e saktë.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] E paraqes këtë dokument për pranim
3 si provë bashkë me faqen e parë. Është dokument prej dy
4 faqesh. Kërkoj ndjesë, jo, një faqe.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mua më është
6 paraqitur vetëm një faqe në listën që kam. Por gjithsesi ky
7 dokument bashkë me ballinën pranohen si prova materiale.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumentit do t'i jepet
9 numri i provës 1D82 dhe duhet që sqarohet klasifikimi.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
11 nuk ka kundërshtim nga Prokurorja klasifikimit do të
12 ndryshohet dhe dokumenti do të klasifikohet si publik.

13 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kam kundërshtim.

14 Z. KEHOE: [Përkthim]

15 PY. Erdhi një moment kur u bënë përpjekje që të ngrihen edhe
16 forcat policore të Kosovës, a është kjo e vërtetë?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe ju e dini që Presidenti Thaçi kishte rol instrumental
19 në lehtësimin e krijimit të këtij shërbimi policor të Kosovës,
20 a është kështu?

21 PË. Po.

22 PY. Për shkak të vonesave në krijimin e administrimit,
23 administratës së mirëfilltë ju do të pajtoheni me mua se
24 ekzistonte një administratë civile e formës bazë në atë kohë,
25 a është kjo e saktë?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe shërbimet e personelit që UNMIK-u i ofronte ishin
3 faktikisht jofunksionale?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe për sa i përket zbatimit të ligjit kishte një çështje
6 lidhje me atë se çfarë ligji duhet të zbatohet, a është kjo e
7 saktë?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe pastaj u bë një propozim që të përdreshin ligjet e
10 regjimit të Millosheviqit, a është kjo e saktë?

11 PË. Mendoj që kishte disa kushte në lidhje me këtë propozim,
12 por po.

13 PY. Dhe fakti që do të përdorej ligji i Millosheviqit apo
14 legjislacioni i Millosheviqit bashkë me ato kushte gjykatësit
15 refuzonin që ta zbatonin atë ligj, sepse ishte i
16 Millosheviqit, a është kështu?

17 PË. Po.

18 PY. Domethënë, realiteti është ky, nuk kishte polici; KFOR-i
19 nuk pranonte të bënte arrestime; nuk kishte gjykatës, sepse
20 gjykatësit po jepnin dorëheqje apo thjesht refuzonin të
21 përdornin atë që perceptohej se ishte legjislacion i
22 Millosheviqit. Dhe kjo po ndodhte gjatë gjithë kohës në atë
23 kohë, a është kjo e saktë?

24 PË. Po. Edhe pse do të kisha thënë se -- me disa përjashtime
25 kishte raste kur KFOR-i bënte disa arrestime. Mirëpo, këto

1 ishin raste të pakta.

2 PY. Nuk dua të përsëritëm por shumë gjykatës u përballën me
3 detyrimin për të -- zbatu atë që ishte legjislacioni i
4 Millosheviqit dhe ata që refuzonin ta bënin zbatimin e atij
5 ligji jepnin dorëheqje, a është kjo e saktë?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe, për shembull, sa i takon Mitrovicës kishit serbë që
8 ishin arrestuar që ishin në grevë urie, sepse nuk e dinin se
9 çfarë ligji do të zbatohet; ligji i ri apo ligji i
10 Millosheviqit, a ju kujtohet kjo?

11 PË. Po, më kujtohet.

12 PY. Tani do të kaloj në diçka tjetër për të mbuluar sa më
13 shumë tema. Dua të përqendrohem te klienti im dhe ndoshta do
14 të kaloj nga një temë në tjetrën, kështu që ju kërkoj ndjesë
15 dhe durim.

16 Në bisedat që i keni pas me ZPS-së ju keni thënë që të
17 gjitha takimet që keni pas me Presidentin Thaçi kanë ndodhur
18 pas rikthimit të OSBE-së në Kosovë në qershor të '99-s, a
19 është kjo e saktë?

20 PË. Besoj që po.

21 PY. Domethënë nuk keni patur takime me z. Thaçi ose bashkë me
22 z. Walker para rikthimit tuaj në Kosovë në qershor të '99-s?

23 PË. Ndoshta ka pasur një takim.

24 PY. Ku ka qenë ky takim?

25 PË. Mendoj që ka qenë diku jashtë. Mirëpo, nuk jam e sigurt,

- 1 t'ju them singerisht. Mirëpo, më kujtohet që u diskutua
2 tërheqja, ishte e vetmja gjë që u diskutua gjatë atij takimi.
3 PY. Unë po ju them që Ambasadori Walker ka thënë që nuk është
4 mbajt një takim i tillë. E pranoni këtë sugjerim?
5 PË. Po, edhe pse unë e kam të mjegullt.
6 PY. Ju e njihni gjithashtu Mike Filipoviçin [Sipas
7 përkthimit] apo jo?
8 PË. Po.
9 PY. Dhe -- tani në lidhje me Z. Thaçi dhe rolin e tij në UÇK.
10 Ju nuk e keni dit se çfarë ka qenë roli i tij në UÇK përpara
11 Rambujesë, a është kjo e saktë?
12 PË. Po.
13 PY. Në takime që keni pas me Presidentin Thaçi, mendoj që
14 keni thënë dhe tani po flas për periudhën pas qershor '99 kur
15 jeni kthi në Kosovë. Ju në takimet që keni qenë me z. Thaçi
16 keni marrë pjesë bashkë me njerëz të tjerë me Ambasadorin
17 Everts, me z. O'Neill dhe me njerëz të tjerë, a është kjo e
18 saktë?
19 PË. Po.
20 PY. Dhe i keni thënë ZPS-së në deklaratën që i keni dhënë në
21 faqen 11 se Thaçi nuk dukej që nuk ishte ndonjë kontroll
22 operativ -- në UÇK. A është kjo e saktë?
23 PË. A mund edhe një herë të ma jepni periudhën kohore?
24 PË. Me të drejtë e kërkoni, sepse ju në deklaratë thoni se
25 gjatë kësaj kohe deri në Rambuje dukej se Thaçi nuk kishte

1 ndonjë kontroll operativ.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni që
3 po ju ndërpres. Mendoj që ka një gabim në transkript. Rreshti
4 11 tek vula kohore 67:7 thuhet "Qershor 1991" dhe jo 1999.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju faleminderit, Gjykatës, për
6 korrigjimin. Është në rreshtin 11?

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo. Në
8 rreshtin 12.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. Në qoftë se kam thënë
10 '91 atëherë është gabimi im. E kam pas fjalën për '99.

11 PY. Dëshmitare, ju përmendët disa bisedime me z. Thaçi në
12 lidhje me Reçakun, a ju kujtohet kjo?

13 PË. Po.

14 PY. Unë do t'ju them se Mike Phillips ashtu edhe Ambasadori
15 Walker kanë deklaruar që nuk ka pas diskutime me Thaçin në
16 lidhje me Reçakun. A do ta kishit pranuar këtë sugjerim?

17 PË. Do ta kisha pranuar sepse edhe mua nuk më shërben aq shumë
18 kujtesa.

19 PY. A e dinit ju që në atë kohë të ngjarjeve të Reçakut z.
20 Thaçi ishte jashtë vendit?

21 PË. Jo, nuk e di.

22 PY. Në qoftë se ju tregoj një vizë që tregon se ai në atë
23 kohë ishte në Slloveni, ju nuk do ta kishit vënë në dyshim
24 këtë fakt, apo jo?

25 PË. Jo, nuk do ta kisha vënë në dyshim.

1 PËRKTHYESI: Më falni - përkthyesit kërkojnë që të bëhet
2 njëfarë pauze midis pyetjeve dhe përgjigjeve.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Unë marr fajin për këtë.

4 PY. Nuk është faji juaj znj. Mitchell. Unë jam ai që e thyej
5 këtë rregull.

6 Domethënë, ju keni thënë në dëshmitë tuaja të mëparshme
7 se keni pas takime me komandantët e zonave kur mbledheshin
8 komandantët e zonave ata diskutonin problemet në mënyrë
9 demokratike dhe i bënë zgjedhjet në mënyrë demokratike, a
10 është kjo e saktë?

11 PË. Kështu e kam kuptuar unë.

12 PY. Dhe sipas jush Hashim Thaçi nuk ka marrë pjesë në ato
13 takime të komandantëve të zonave, apo jo?

14 PË. Jo.

15 PY. Dhe tani të përqendrohemi si vijon: A e dini se nga mesi
16 i nëntorit '98 dhe deri në mars të '99-s z. Thaçi madje as nuk
17 ishte në Kosovë. A e dini këtë?

18 PË. Kjo nuk më kujtohet, ndoshta, po.

19 PY. Ndoshta që nuk ishte aty?

20 PË. Që nuk ishte aty, sepse unë i kam ndjek lëvizjet e kujt do
21 qoftë --

22 PY. Faleminderit znj. Mitchell. Dhe në lidhje me Rambujenë,
23 para kësaj. Personi me të cilin ju bënit diskutimet para
24 Rambujesë ishte Adem Demaçi, a është kështu?

25 PË. Po.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 70

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe tani do të shkojmë te shënimi
2 përgatitor. Për dëshmitarin është paragrafi 38.

3 PY. Ku thuhet:

4 "Para kësaj duket se z. Adem Demaçi ishte zëdhënësi i
5 UÇK-së dhe duket se diplomatët shkonin për takime tek ai".

6 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtoj sepse është
7 shtrembërim i përmbajtjes. Avokati u ndal në mes të asaj
8 fjalie dhe vazhdoi me një fjali tjetër.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm një
10 moment ju lutem. Kundërshtimi rrëzohet. Mund ta jepni
11 përgjigjen Dëshmitare.

12 Z. KEHOE: [Përkthim]

13 PY. Kemi një situatë kur gjatë kësaj periudhe ju kishit
14 përshtypjen se Adem Demaçi ishte zëdhënësi --

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni
16 Avokat, por dëshmitarja nuk u përgjigj në pyetjen që ia bëtë.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Më duket se u përgjigj, por prapë do
18 t'ia përsëris pyetjen.

19 PY. Domethënë, ju thoni:

20 "Përpara kësaj dukej se diplomatët shkonin për ta takuar
21 Adem Demaçin i cili ishte zëdhënës i UÇK-së...".

22 A e keni thënë këtë?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe ndërkombëtarët shkonin për të folur me Demaçin dhe
25 ndërkohë në të njëjtën kohë personi që ju mendonit se i

1 koordinonte aktivitetet ushtarake në terren ishte z.

2 Haradinaj, a është kjo e saktë?

3 PË. Unë nuk e di në qoftë se ai e ka koordinuar gjithë

4 aktivitetin luftarak në terren, por ishte personi kujt i

5 drejtohet MVK-ja.

6 PY. Mendoj ju që thatë që ai ishte personi me të cilin MVK-ja

7 takohej për të kërkuar ndërprerjen e zjarrit, a është kjo e

8 saktë?

9 PË. Po.

10 PY. Në qoftë se nuk e dini mund të ma thoni që në fillim që

11 të vazhdoj me diçka tjetër në interes të kohës. Pyetje ime

12 është kjo: Siç shkojmë përpara tani deri në Rambuje, a e dini

13 se marrëveshja e Rambujesë fillimisht, domethënë, z. Thaçi

14 duhet të shkonte të merrte lejen e gjithë komandantëve të

15 zonës në mënyrë që të mund të nënshkruante marrëveshjen e

16 Rambujesë, a e keni dit këtë?

17 PË. Jo.

18 PY. A e dini që në kohën e Rambujesë komandanti i

19 përgjithshëm i UÇK-së u hoq nga kjo detyrë, nga ky post nga

20 komandantët e zonës, a e dini për këtë dhe kjo bëhet fjalë për

21 shkurtin '99?

22 PË. Jo, nuk e di.

23 PY. Do të qëndrojmë te Rambujeja. Ju a e dini që kur po

24 organizoheshin bisedimet në Rambuje kishte disa propozime nga

25 ndërkombëtarët që të kishte përfaqësues të qeverisë anash në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 72

1 mënyrë që të hynin në Kosovë dhe që të fillonin me krijimin e
2 strukturave menjëherë dhe funksionimin e tyre?

3 PË. Kjo nuk më kujtohet. Në qoftë se është e përfshirë në
4 marrëveshje atëherë unë nuk e vë në dyshim këtë që po thoni.

5 PY. Jo, kjo është një marrëveshje për ndarjen e pushtetit.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe mendoj që është në dokumentin
7 1D69.

8 PY. Është marrëveshja e 23 shkurtit 1999 në Rambuje.

9 "Delegacioni i Kosovës në Konferencën e Rambujesë, pas
10 konsultimeve me grupet politike dhe ushtarake: Ushtria
11 Çlirimtare e Kosovës, Lidhje Demokratike e Kosovës, dy
12 anëtarët e pavarur dhe Lëvizja Demokratike e Bashkuar më 23
13 shkurt 1999 vendosi:

14 Që të formohet qeveria e përkohshme e Kosovës...

15 Qeveria do qeverisë deri në zgjedhjet e para të lira në
16 Kosovë.

17 Mandati i qeverisë me marrëveshje u caktua një
18 përfaqësues i UÇK-së.

19 Tri grupimet politike do të kenë përfaqësinë e barabartë
20 në qeveri, duke i shtuar këtij numri edhe mandatin si dhe
21 anëtarë të tjerë të mundshëm të pavarur".

22 Jeni e vetëdijshme, Dëshmitare, se kjo marrëveshje hyri
23 në fuqi edhe para krijimit apo hyrjes në fuqi të marrëveshjes
24 për qeveri të përkohshme?

25 PË. E di që ka pas një marrëveshje për një qeveri të

1 përkohshme. Mirëpo, t'ju them të drejtën nuk jam marrë me këtë
2 në hollësi.

3 PY. Mirëpo tani për këtë periudhë nuk ka pas kurrfarë
4 diskutimi për UNMIK-un a KFOR-in apo për ndonjë strukturë
5 tjetër. Pra, në këtë moment kohor, a është kjo e saktë?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe këtë e nënshkruan edhe z. Rugova dhe kur lufta
8 përfundoi mbas 10 qershorit ose disa ditë më pas. Mendoj që ju
9 thatë 12 apo 13 qershori u kthyer në Kosovë. Grupe të ndryshme
10 ndërkombëtare filluan që të bashkëpunonin dhe punojnë bashkë
11 dhe e njëjta gjë ndodhi edhe me strukturat politike në Kosovë,
12 në vende të ndryshme.

13 PË. Po, në vende të ndryshme.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Të shikojmë dokumentin SITF000159-
15 0189 [Sipas përkthimit] deri në faqen 1592. Prapë e kam dhënë
16 gabimisht numrin se është hera e parë, sa më tërthorë
17 vëmendjen. Është numri SITF00001529 deri në 00001871 dhe më
18 duhet faqja 1597. Le të kalojmë në fund të kësaj faqe.

19 PY. Znj. Mitchell është volumi i dytë i raportit "Siç është
20 parë, është treguar". Besoj që e njihni këtë raport, apo jo.
21 Kalojmë, lexojmë fundin e faqes. Thuhet, Gjakova, pra, nën
22 pikën Gjakova:

23 "Asnjë lloj administrate tjetër ishte më e zhvilluar,
24 sesa Gjakova. Administrata e krijuar më datë 16 qershor dhe më
25 20 qershor dhe administrata e krijuar vetë ishte funksionale

1 në bashkëpunim me Partinë Kombëtare Demokratike Shqiptare dhe
2 me dy anëtarë të LDK-së”.

3 Pra, kjo thuhet. Pra, thuhet në raportin tuaj që
4 ekzistonte një frymë bashkëpunimi në atë kohë midis Partisë
5 Demokratike dhe LDK-së në Kosovë në atë kohë, apo JO.

6 PË. Po.

7 PY. Pra, dukej sikur të paktën këto dy parti bashkëpunonin me
8 njëra tjetrën apo jo?

9 PË. Po.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të
11 pranohet si provë materiale ky fragment i raportit.

12 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Besoj se është i pranuar më herët
13 si provë dhe ka numrin e Provës Materiale P743.2.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit. Faleminderit për
15 korrigjimin. Nuk jam i sigurt se çfarë materiali është pranuar
16 deri tani dhe çfarë jo. Kështu që ju falënderoj edhe një herë
17 tjetër.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
19 vazhdoni.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Le të vazhdojmë më tej me dokumentin
21 SITF152981 [Sipas përkthimit] deri në faqen 1646. Pra, dua që
22 të paraqitet faqja 1646 e këtij dokumenti.

23 Të kalojmë te paragrafi i dytë. Do i kërkoja Sekretares
24 ta ngrejë pak faqen në ekran. Është një pjesë që ka edhe
25 poshtëshënime. Poshtëshënimet jepen në fund fare të faqes.

1 PY. Në çdo rast, thuhet që:

2 "Në komunat jugore janë përfshirë gjithashtu edhe
3 përbërja e LDK-së. Për shembull, në Skënderaj".

4 Besoj se edhe në këtë rast sipas raportit tuaj kemi parti
5 të ndryshme politike që bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe me
6 UÇK-në. Domethënë, UÇK-ja bashkëpunon me parti politike dhe i
7 përshin ato në qeveri. A është e vërtetë kjo?

8 PË. Po.

9 PY. Do kërkoj të pranohet si provë materiale kjo pjesë e
10 raportit.

11 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kundërshtojmë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
13 SITF1529871 në faqen 1646 pranohet së bashku me
14 poshtëshënimet.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
16 marrë numrin e Provës Materiale P473.2 [Sipas përkthimit].

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Të paraqitet në ekran dokumenti DHT
18 - ju kërkoj ndjesë - 1264 deri në DHT0128. Është një raport i
19 Grupit Ndërkombëtar të Krizës.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj
21 ndjesë. Po thoni që është dokumenti DHT1264?

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Është DHT01264. Në faqen 11 të
23 dokumentit që kemi përpara.

24 PY. Ky nuk është raporti juaj, Dëshmitare, znj. Mitchell. Por
25 është një raport i Grupit Ndërkombëtar të Krizave, i njohur

1 ndryshe si ICG. Do shohim pak më poshtë në këtë raport.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe kërkoj që të paraqitet faqja 11.

3 Të shkojmë më poshtë në faqe. Pra, nga fundi.

4 PY. Deri në masën që ka pasur disa mosmarrëveshje unë
5 parashtroj, znj. Mitchell që personat e LDK-së vazhdonin që të
6 punonin së bashku. Për shembull shikoni në Gjilan që kishte
7 forca politike të unifikuara në komunë. Pra, po ashtu thuhet
8 që njerëz nga spektri politik më i zgjeruar ftohen që të
9 marrin pjesë në qeverisjen lokale. Për pasojë edhe pse LDK-ja
10 nuk e njeh legjitimitetin e komunave shumë njerëz ende
11 dëshmojnë që kanë lidhje me LDK-në, sepse shërben në
12 administrata.

13 Pra, a ka qenë kjo situata në kuptimin persona që kishin
14 lidhje me LDK-në, pavarësisht lidhjes me LDK-në punonin me
15 administratat, a ju kujtohet një gjë e tillë, Dëshmitare?

16 PË. Po. Po lexoja mënyrën e formulimit në raport.

17 PY. Po, patjetër.

18 PË. Po.

19 PY. Le të flasim pak për Mitrovicën.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj që të paraqitet në ekran
21 dokumenti SITF00385175. Dua të shohim konkretisht faqen 177.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund të na thoni edhe
23 një herë numrin e dokumentit?

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Është SITF00385178 [Sipas
25 përkthimit] por dua që të paraqisni faqen 177 [Sipas

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 77

1 përkthimit]. Është paragrafi i parë, diku nga mesi i faqes,
2 pas këtyre dy pikave të theksuara.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal është
4 Prova Materiale 1D35.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Është 1D35?

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Në rregull atëherë. Le ta lexojmë
8 këtë.

9 PY. Në këtë paragraf thuhet:

10 "LDK-ja ka thënë që respekton dhe bashkëpunon me
11 administratorin civil të përkohshëm të caktuar në Mitrovicë që
12 është caktuar nga UÇK-ja. Ai konsiderohet si personi i duhur
13 për punën, për këtë punë. Ka rezerva sa i takon vetëshpalljes
14 së qeverisë së përkohshme "nga Shqipëria". LDK-ja po merr
15 pjesë në nivel rajonal në takime me UÇK-në dhe LBD-në për të
16 diskutuar dhe për të planifikuar, për të bërë plane për
17 Mitrovicën".

18 Do ishte e drejtë që të thuhet që në këtë zonë në
19 Mitrovicë në këtë kohë kemi LDK-në, Partinë Demokratike dhe
20 UÇK-në që bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, a është e drejtë të
21 thuhet kjo gjë?

22 PË. Po, gjatë kësaj periudhe, po.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Le të kalojmë te dokumenti
24 SITF001529 deri në 1871. Kërkoj të paraqitet faqja 1571.

25 PY. Znj. Mitchell, dua të përqendroheni tek fundi i faqes,

1 administrata civile. Këtu flitet për udhëzimet që jepen nga
2 partia LBD që është në pjesën e Gjilanit. Në Gjilan ku ju keni
3 pasur një zyrë. Dhe ju thoni, për shembull, që:

4 "Administrata civile të bëra vetë janë krijuar në Gjilan
5 në Novo Berde, në Viti, në Kamenicë".

6 Ju thoni që administratat civile, pra, janë krijuar në
7 Gjilan, Novo Berde, Viti dhe Kamenicë. Shpresoj që ta kam
8 shqiptuar siç duhet.

9 Pra, është e vërtetë apo jo që kemi këtë parti politike
10 që ka përcaktuar udhëzimet ose ka krijuar një lloj
11 udhërrëfyesi për krijimin e administratës në këtë zonë, apo
12 jo?

13 PË. Po.

14 PY. Në rregull. Do shikojmë një tjetër dokument.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] I pari është dokumenti
16 SITF000115288-1871. Kërkoj të paraqitet faqja 1571 në ekran.
17 Në fillim të faqes ju lutem. Paragrafi i dytë i plotë, "Në
18 fund të tetorit raportohet që Kombet Bashkuara ishin pranë
19 miratimit të një administrate të vetëkrijuar në Gjilan. Më
20 poshtë thuhet që ka marrëveshje të arritur sa i takon dy
21 serbëve të Kosovës që duhet të ekzistojnë sa i takon
22 administratës".

23 Domethënë kemi një situatë të tillë që kemi UÇK-në që
24 punon me LDK-në por kemi edhe një situatë tjetër ku partia --
25 domethënë kemi bashkëpunim edhe të serbëve për krijimin e

1 administratës në vendet të tjera, kështu, apo jo?

2 PË. Mendoj që kemi dy pjesë të pyetjes suaj. E treta,
3 marrëveshja ka sjellë, domethënë, edhe përfshirjen e serbëve.
4 Pra, me përfshirjen e Kombeve të Bashkuara ka ndodhur një gjë
5 e tillë.

6 PY. Pra, këto janë zgjedhje të cilat janë bërë si rezultat i
7 marrëveshjes, apo jo?

8 PË. Po.

9 PY. Pra, pavarësisht se cila ka qenë marrëveshja i takon që
10 LDK-ja, UÇK-ja kanë rënë dakord që të ketë edhe dy serbë në
11 qeverisja, apo jo?

12 PË. Po.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe në fund le të diskutojmë për
14 dokumentin SITF00265435 dhe kërkoj që të paraqitet në ekran
15 për momentin dokumenti 265436. Ky është raporti i datës 19
16 qershor. Zmadhojeni pak këtë faqe ju lutem.

17 PY. Struktura e qeverisjes vendore dhe flet këtu për
18 Prishtinën.

19 "Duket sikur ka një Këshill Ekzekutiv të Përkohshëm që
20 është e njëjta strukturë qeveritare që ka ekzistuar në Kosovës
21 përpara konfliktit. Ky Këshill Ekzekutiv i Përkohshëm përbëhet
22 nga serbë, shqiptarë, turq dhe romë dhe drejtohet nga Zoran
23 Andjelkovic. Detyra e këshillit është që të rregullojë dhe që
24 të sigurojë administratë publike në sektorë të ndryshëm të
25 Kosovës derisa të caktohet Autoriteti i Përkohshëm nga Kombet

1 e Bashkuara".

2 Pra, sikurse mund të lexohet duket sikur që në fillim
3 fare ka pas një përpjekje të përbashkët nga palët të ndryshme
4 në Kosovë që palët të mund të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.
5 Të paktën kështu duket në kuadrin e Këshillit Ekzekutiv të
6 Përkohshëm.

7 PË. Jo të gjithë, por personat e përfshirë këtu po.

8 PY. Kur flasim për Këshillin Ekzekutiv të Përkohshëm, kur
9 flasim për serbët, për shqiptarët, për turqit, për romët një
10 ndër individët që ka mbështetur që grupet të ndryshme të
11 diskutojnë me njëri-tjetrin në mënyrë që të gjejnë rrugën se
12 si të vijohet më tej, njëri prej këtyre personave ka qenë
13 Hashim Thaçi, apo jo?

14 PË. Nuk e di, nuk mund të them.

15 PY. Me aq sa dini ju personalisht, domethënë, kur grupet e
16 ndryshme mundoheshin që të silleshin bashkë edhe të
17 bashkëpunonin me njëri-tjetrin, besoj që e keni të qartë që ka
18 qenë z. Thaçi ai që ka ndihmuar në këtë drejtim, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Pra, kemi z. Thaçi i cili punon me të tjerët në mënyrë që
21 të përpiqet që të krijojë qeverinë. Ndërkohë, në tetor, nëntor
22 ju keni diskutuar me z. Thaçi dhe z. Çeku për volumin e dytë
23 të raportit tuaj, apo jo?

24 PË. Nuk më kujtohet data ekzakte, por e di që jam takuar.

25 PY. Por juve po bëheshit gati që ta nxirrnit publikisht këtë

1 raport, apo jo? Dhe në qoftë se, për shembull, e keni nxjerrë
2 raportin e dhjetorit takon që pak përpara dhjetorit i keni
3 takuar ata, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. A keni shkuar, për shembull, që të takoheshit gjithashtu
6 dhe me persona të tjerë si Presidentin Rugova, Kryeministrin
7 Bujar Bukoshin apo elementë të tjerë për të bërë me dije
8 konstatimet e raportit tuaj?

9 PË. Unë vetë, jo, por të tjerët kanë pasur përgjegjësit të
10 ngjashme dhe ata mbase janë takuar.

11 PY. Kush tjetër është informuar?

12 PË. Kishim zyrën e këshillit ekzekutiv dhe ata kishin pikat e
13 veta për të diskutuar me sa më kujtohet. Ata kryesisht
14 merreshin me partitë politike dhe nëse s'gabohem edhe ndonjë
15 person në departamentin e demokratizimit.

16 PY. Jashtë strukturës së Kombeve të Bashkuara ose jashtë asaj
17 çfarë mund të quhet si strukturë ndërkombëtare, kush tjetër
18 nga grupi i shqiptarëve të Kosovës është informuar me
19 konstatimet apo gjetjet e raportit tuaj, nëse mund të na
20 thoni?

21 PË. Nuk e di, nuk më kujtohet.

22 PY. Mjafton të thuhet në këtë pikë që sipas Rezolutës 1244 as
23 Qeveria e Përkohshme e Kosovës dhe as Hashim Thaçi nuk kanë
24 pas autoritet ligjor për të hetuar për këto krime, apo jo?

25 PË. Po, kështu është.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 82

1 PY. A jeni në dijeni të faktit që ka pasur përpjekje për të
2 hetuar këto çështje, këto tema, a ju është thënë ndonjë gjë
3 nga Kombet e Bashkuara lidhur me këtë gjë në atë kohë?

4 PË. Jo.

5 PY. Në rregull, atëherë le të shohim një dokument.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Dokumenti mban numrin e
7 identifikimit SITF00241872 [Sipas përkthimit].

8 PY. Znj. Mitchell, është një dokument i OSBE-së sikurse mund
9 ta shikoni. Është një dokument që mban datën 05 korrik 1999.
10 Është një vendim për sa i takon krijimit të komisionit për
11 hetimin e krimeve të luftës dhe personave të zhdukur. E
12 shikoni?

13 PË. Po.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju lutemi uleni më poshtë
15 dokumentin, Sekretare.

16 DËSHMITARJA: [Përkthim] Faleminderit.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Mund të vazhdojmë të lexojmë një
18 tjetër pjesë të dokumentit. Uleni dhe më poshtë faqen. Mund të
19 kalojmë edhe te faqja tjetër.

20 DËSHMITARJA: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. KEHOE: [Përkthim]

22 PY. Ky është një dokument që ka vulën e OSBE-së dhe është një
23 dokument që flet për formimin e një komisioni për hetimin e
24 krimeve të luftës dhe këtu nuk thuhet që do të hetohen vetëm
25 krime lufte të serbëve ose të shqiptarëve, por është për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 83

1 krimet e luftës në përgjithësi, kështu, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. A ju kujtohet ta keni parë atëherë këtë dokument?

4 PË. Jo, nuk më kujtohet, por ka shumë të ngjarë që ta kem
5 parë.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që ky
7 dokument të regjistrohet si provë materiale.

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kundërshtojmë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
10 SITF00248172 pranohet si provë materiale dhe t'i caktohet një
11 numër nga Sekretarja.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
13 merr numrin e Provës Materiale 1D83. Dhe vërej që është i
14 klasifikuar aktualisht si konfidencial.

15 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kundërshtojmë që të
16 riklasifikohet si publik.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
18 riklasifikohet si, jo dokumenti, por prova materiale
19 riklasifikohet si publike.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Le të shohim dokumentin
21 SITF00289186.

22 PY. Është një dokument që mban datën 4 dhjetor 1999. Është
23 shkruar nga Martin Kutzner drejtuar Shahin Idrizit, kryetari i
24 komisionit për krimet e luftës. Dhe thuhet:

25 "Në vijim të kërkesës tuaj më datë 18 nëntor 1999 sa i

1 takon zhvarrimin të varrit masiv në Dragodan dëshiroj t'ju
2 informoj që komisioni juaj nuk është përgjegjës për kryerjen e
3 zhvarrimeve në zonën e mësipërme, pasi TPNJ-ja dhe UNMIK-u,
4 policia e UNMIK-ut janë autoritetet kompetente për të kryer
5 hetime për krimet e luftës sipas Rezolutës së Këshillit të
6 Sigurimit 1244".

7 Znj. Mitchell, a jeni në dijeni që Qeveria e Përkohshme
8 është përpjekur që të hetojë krime lufte, por në këtë moment,
9 siç e shikoni, Kombet e Bashkuara thonë që nuk mund ta bëni
10 dot këtë gjë, sepse për hetime sipas Rezolutës të Këshillit të
11 Sigurimit 1244 nuk ka të drejtë qeveria e përkohshme të bëjë
12 hetime për krime lufte.

13 PË. Po.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj që ky dokument të pranohet si
15 provë materiale.

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim dhe as për
17 pranimin si provë materiale as si për sa i takon klasifikimit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
19 SITF00281986 pranohet dhe riklasifikohet si dokument publik.
20 Mund të vazhdoni. Më falni, Sekretarja duhet t'i caktojë
21 numrin.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Merr numrin e Provës
23 Materiale 1D84 dhe do riklasifikohet si publike.

24 Z. KEHOE: [Përkthim]

25 PY. Është e drejtë të thuhet, znj. Mitchell dhe se duke pasur

1 parasysh Rezolutën 1244 qeveria e përkohshme dhe z. Thaçi nuk
2 kishin autoritet ligjor për të hetuar dhe për të ndëshkuar
3 krime dhe deri në masën që ata janë përpjekur që të hetojnë
4 krime të kryera ndaj çdokujt UNMIK-u ka thënë që nuk mund ta
5 bëjnë dot këtë gjë mbi bazën e Rezolutës 1244. Pra, ky është
6 thelbi i këtij dokumenti, apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. E di që keni folur gjerë e gjatë lidhur me situatën pas
9 luftës në volumin 2 të raportit. Dhe çfarë po ndodhte apo se
10 si situata u bë kaotike kur njerëzit filluan që të ktheheshin
11 nga vendet ku kishin qenë refugjatë. Pra, kur filluan të
12 ktheheshin pas përfundimit të luftës.

13 Sa për ilustrim ne e dimë që në raportin tuaj keni thënë,
14 keni përmendur që njerëzit i kanë bërë këto të veshur me
15 uniforma të UÇK-së, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. A e dini që marrëveshja për demilitarizimin e UÇK-së
18 është nënshkruar nga z. Thaçi më 21 qershor me demilitarizimin
19 e plotë të UÇK-së që ndodhi më datë 21 shtator 1999, a është e
20 saktë kjo?

21 PË. Po.

22 PY. Pas 21 shtatorit 1999 e gjithë UÇK-ja, mendoj që të
23 kishte zhdukur, të ishte shformuar, a është kështu, a apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Duhet të ketë qenë shumë e vështirë dhe ju kërkoj ndjesë

1 se e di që do ketë qenë shumë e vështirë për juve që të
2 ktheheshit në shtëpi dhe të shikonit dy veta me uniformë që
3 ishin brenda shtëpisë tuaj. Por kjo ka ndodhur pas
4 demilitarizimit të UÇK-së, apo jo? Domethënë ka ndodhur pas
5 datës 21 shtator 1999, e vërtetë kjo?

6 PË. Po, mendoj se ka qenë pas kësaj date.

7 PY. Më lejoni të them se, pra, në rastin që ju përshkruat --
8 kishte ushtarë që ishin demilitarizuar por pavarësisht kësaj
9 ishin në uniformë. Megjithatë, ju thatë që kishte, folët për
10 mashtrues dhe ju nuk e dinit që kushdo që donte të merrte
11 uniforma mund t'i merrte në Shqipëri me një çmim shumë të
12 lirë. Nuk e dini këtë gjë, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Dua t'ju lexoj diçka.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Për procesverbal është dokumenti
16 DHT01475 deri në 476. Është një raport i Komisionerit të Lartë
17 të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, data 27
18 shtator 1999. Dëshirojmë që të shikojmë paragrafin -- 102.
19 Paragrafi 102.

20 PY. Këtu në këtë paragraf thuhet që:

21 "UÇK-ja raportohej që ka kërcënuar punonjës të
22 organizatave ndërkombëtare që janë parë të ndërhyjnë në emër
23 të pakicave duke i akuzuar ata si bashkëpunëtorë, për
24 bashkëpunim. Disa viktimat të dhunës etnike janë raportuar që
25 të kenë përshirë persona të veshur me uniforma të UÇK-së,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 87

1 megjithëse është e mundur që një dhune të tillë është thjesht
2 e ushtruar nga elementë kriminal që maskohen nën uniformat e
3 UÇK-së. Kufij të e hapur në fakt kanë lejuar mbërritjen masive
4 të elementëve kriminalë, -- veçanërisht nga Shqipëria. Është
5 vërejtur gjithashtu që uniformat mund të jenë, të blihen
6 lehtësisht vetëm për 50 marka gjermane në Shqipëri dhe se
7 burra shqiptarë -- nuk kanë marrëdhënie fare me UÇK-në dhe
8 pavarësisht kësaj, pra, mund të kalojmë me uniformë, duke e
9 përdorur këtë uniformë si pasaportë përmes sektorit të gjerman
10 të KFOR-it të Kosovë".

11 Pra, sipas këtij paragrafi, a e kuptoni që kishte
12 shqiptarë, jo shqiptarë Kosove, por shqiptarë Shqipërie që
13 kalonin me uniforma, dhe kalonin, pra, në pjesën e Kosovës. A
14 e keni këtë informacion, znj. Dëshmitare?

15 PË. Po, më kujtohet ky informacion.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj që të pranohet si provë ky --
17 material.

18 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kundërshtojmë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
20 DHT01-01475 në paragrafin 2 pranohet si provë materiale.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
22 merr numrin e Provës Materiale 1D85.

23 Z. KEHOE: [Përkthim]

24 PY. Në fakt, znj. Mitchell, janë dhënë dëshmi nga dëshmitarët
25 e OTP-së, janë persona identiteti i të cilëve nuk është bërë

1 me dije që kanë dhënë dëshmi më datë 12 tetor 2023, në faqen
2 8844, rreshtat 17 deri 24. Pra, ky ish-ushtar i UÇK-së thuhet:

3 "Në atë kohë", dhe e ka fjalën këtu për verën e 1999.

4 "Në këtë kohë çdokush mund të blinte një uniformë për pak
5 marka gjermane dhe brenda disa ditësh situata u bë tërësisht
6 kaotike dhe doli komplet jashtë kontrolli. Kishte njerëz që
7 asnjëherë nuk kishin qenë pjesëtarë të UÇK-së dhe papritmas
8 filluan që të vishnin uniformat e UÇK-së".

9 A është kjo në përputhje me atë çfarë ju thatë lidhur me
10 uniformat e veshura nga UÇK-ja në atë zonë?

11 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtojmë. Për çfarë zone e ka
12 fjalën Avokati?

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, në fakt në të njëjtën zonë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Domethënë e kam fjalën për pjesën e
16 Prizrenit.

17 DËSHMITARJA: [Përkthim] Mendoj që këto raporte zbatohen
18 njësoj për zona të ndryshme.

19 Z. KEHOE: [Përkthim]

20 PY. Pra, në këtë pjesë thuhet që kishte njerëz që vinin me
21 uniformat e UÇK-së që ishin shqiptarë që kishin blerë
22 uniformat; ishin njerëz të cilët i vishnin uniformat dhe në
23 fakt nuk kishin luftuar asnjë ditë të vetme për UÇK-në deri në
24 masën që ushtarët e UÇK-së dhe personat e tjerë që ishin
25 realisht të përfshirë me UÇK-në ishin disi të shqetësuar apo

1 jo?

2 PË. Po.

3 PY. Megjithatë, në një situatë të tillë ishte komplet situatë
4 kaotike, nuk kishte as gjyqtarë, as gjykata, as polici
5 absolutisht asgjë. Dhe ndërmjet të -- tjerash kishte dhe
6 hakmarrje, apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. Gjatë gjithë kësaj kohe dhe kam përshtypjen që e cekët
9 këtë gjë edhe me Prokurorinë. Në këtë kohë z. Thaçi ishte i
10 pranishëm duke u përpjekur që të dënonte dhunën, a ka qenë
11 kështu, Dëshmitare?

12 PË. Ndonjëherë, po.

13 PY. Mirë, në rregull. Le t'i marrim njëra pas tjetrës. Dhe jo
14 vetëm që po përpiqem të dënonte dhunën, por po kërkonte
15 gjithashtu stabilizim të situatës brenda Kosovës dhe kërkonte
16 që serbët e Kosovës të vazhdonin të qëndronin në Kosovë, a ka
17 qenë kështu?

18 PË. Po.

19 PY. Ai e ka bërë këtë gjë gjatë një periudhe të
20 konsiderueshme kohe. Pra, po kërkonte pajtim kur u kërkonte
21 shqiptarëve të Kosovës të ktheheshin në shtëpi dhe po kërkonte
22 që t'i jepej fund dhunës, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. A e njihni Ambasadorin Covey, Jock Covey?

25 PË. Shefin e BE-së?

1 PY. Ambasadori që ka punuar së bashku me Ambasadorin

2 Kouchner?

3 PË. Emri më duket i dëgjuar, por nuk më kujtohet ekzaktësisht
4 tani.

5 PY. Në rregull. Megjithatë juve ju kujtohet, apo znj.

6 Mitchell, që Presidenti Thaçi po kërkonte për pajtim, bënte

7 thirrje për pajtim për mospasje dhune për një shoqëri

8 shumetnike dhe për shqiptarët e Kosovës të -- mos lejonte,

9 domethënë, shqiptarët e Kosovës që t'i largonin serbët, romët

10 apo pakicat e tjera. Këtë besoj e keni kuptuar, apo jo znj.

11 Mitchell?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe pavarësisht -- le të themi kundërshtimit që mund të

14 haste ai vazhdonte ta bënte këtë kërkesë, apo jo?

15 PË. Po.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Në rregull. Le të shikojmë një video

17 të shkurtër që mban numrin e identifikimit DHT01299.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Video nuk është e

19 klasifikuar aspak. Përpara se ta shfaqim duhet të sigurohemi

20 çfarë lloj klasifikimi ka.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Është publike.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Çfarë është?

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Është video e një fjalimi të veçantë

24 të z. Thaçi.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po, mund ta shfaqim.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Page 91

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Është e datës 17 qershor '99.

2 [Luhet videoincizimi]

3 PËRKTHYESI: "-- që të kthehen në Kosovë ata të cilët janë
4 larguar, sepse neve besojmë se këto masakra në Kosovë nuk i ka
5 bërë populli serb, sepse -- një kontribut të çmueshëm për të
6 ardhmen dhe prosperitetin e Kosovës. Ne nuk kemi zhvilluar
7 luftë për pastrimin e Kosovës. Ne kemi zhvilluar një luftë për
8 të jetuar të lirë të barabartë të gjithë".

9 Z. KEHOE: [Përkthim]

10 PY. Ky është mesazhi që e ka shprehur gjatë një periudhe të
11 konsiderueshme kohore, apo jo?

12 PË. Nuk di të them. Nuk kam lexuar lajme të -- shqiptare. Kam
13 vetëm disa pjesë të shkëputura që kemi marrë, por besoj se
14 këto porosi janë dhënë, po.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do doja ta
16 ofroja këtë video për në prova gjyqësore dhe të jetë publike
17 së bashku me të tjerat.

18 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
20 çaktivizuar]

21 DHT01299 pranohet.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
23 i caktohet numri i Provës Materiale 1D86.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për sqarim. Të
25 gjitha këto video mund të jenë publike. Nuk ka nevojë që të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 92

1 klasifikohen si konfidenciale.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për sa kohë
3 që s'janë të klasifikuara atëherë do të klasifikohen si
4 publike.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Të kalojmë tani tek materiali me
6 numër DHT; është një deklaratë e 2 korrikut '99. Pra,
7 DHT01300. Është 2 korrik 1999, jo '91, por '99.

8 [Luhet videoincizimi]

9 "Sot besoj se është hera e parë që udhëheqësit shqiptarë
10 dhe serbë të Kosovës takohen për -- të biseduar me njëri-
11 tjetrin për të ngritur një dialog për çështje më të
12 rëndësishme të momentin që janë siguria, parrezikshmëria, e
13 drejta për jetë, e drejta për pronë për të gjithë banorëve të
14 kësaj krahine".

15 "Ju lutem të gjithë qytetarëve të Kosovës, qofshin ata me
16 status civil apo ushtarak të përmbahen dhe të ndikojnë tek të
17 tjerët që të mos ndërmarrin akte dhune ndaj fqinjëve të tyre.
18 Me veprime të këtilla janë të papranueshme. Përgjegjësit e
19 veprimeve të tilla do të sillen para drejtësisë. Insistojmë
20 gjithashtu që të gjithë njerëzit e zhdukur t'i dorëzohen
21 përfaqësuesve të UNMIK-ut. Ne përkrahim përpjekjet e
22 përbashkëta që tani janë ndërmarrë nga aktivistët e bashkësisë
23 shqiptare ose serbe dhe të bashkësive të tjera që së bashku me
24 UNMIK-un dhe organizata të tjera ndërkombëtare të realizojnë
25 këto kërkesa. Rruga e pajtimit do të jetë e gjatë dhe e

1 vështirë. S'është e vërtetë që ekziston një urrejtje e
2 natyrshme mes njerëzve në Kosovë. Ne duhet të punojmë së
3 bashku. Si hapa të parë jemi marrë vesh që sot. Menjëherë të
4 vendoset një linjë komunikimi në mes nesh, UNMIK-ut dhe KFOR-
5 it dhe mbajtjen e mbledhjeve të përbashkëta si kjo sot. Të
6 lëshojmë mesazhe të përbashkëta pajtimi në TV dhe radio. Të
7 krijohet një forcë e përbashkët të krizave në rajon së bashku
8 me UNMIK-un dhe KFOR-in të cilat do të jenë në gjendje të
9 shqyrtojnë problemet urgjente kudo që ndodhen duke përfshirë
10 edhe vendet historike-fetare dhe të organizohet një mbledhje e
11 hershme ndërmjet udhëheqësve fetarë dhe shpirtërorë duke
12 thirrur për tolerancë...".

13 "Personat e dyshuar për krime lufte dhe krime kundër
14 njerëzimit do të nxirren para drejtësisë. Ne mbështesim
15 Tribunalin Ndërkombëtar Penal".

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Përpara se të vazhdojmë ju lutem te
17 kthehem te minuta e 2-të dhe ta ndalojmë aty.

18 PY. Ndërkohë, znj. Mitchell, personi i parë që po fliste
19 ishte Sergio de Mello, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. Mbase do doja ta kisha prezantuar që në fillim. Ju lutem
22 pa parë në fund shohim TVSH është një burim media shqiptare,
23 apo jo?

24 PË. Nuk e di, por po ju besoj juve.

25 PY. Presidenti Thaçi po e jep këtë fjalim krahas me Sergio de

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 94

1 Mello dhe priftin serb. Pra, këtë -- ia jep këtë mesazh jo
2 vetëm bashkësisë ndërkombëtare por edhe bashkësisë shqiptare.

3 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Unë e kundërshtoj pyetjen që bën
4 Avokati, duke thënë "të më besoni mua".

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

6 Z. KEHOE: [Përkthim]

7 PY. A keni ndonjë dyshim se kjo ka shkuar dhe në mediat
8 shqiptare?

9 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtim. Dëshmitarja tha që
10 jo.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'i
12 përgjigjet, nëse keni dijeni.

13 DËSHMITARJA: [Përkthim] Nuk e dija. E marr me mend që ka
14 qenë nëpër këto media. Nuk kam asnjë arsye për të menduar që
15 nuk është dhënë në media shqiptare. Pra, nuk mund ta
16 kundërshtoj.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] E ofrojmë këtë për t'u futur në
18 prova gjyqësore.

19 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prova me
21 numër DHT01300 pranohet me klasifikim publik.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
23 merr numrin e Provës Materiale 1D87.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Të vendosim tashti 020571 deri në
25 020572. Pra, 020571 dhe 020572. Është një artikull i Reuters.

1 Më intereson faqja me numër 020571. Pra, është artikull i
2 Reuters, i agjencisë Reuters. Flet për z. Thaçi. Ju lutem nëse
3 mund të shkojmë më në fund të faqes. Në fund të faqes thuhet,
4 "qeveria e përkohshme", nëse mund ta zmadhoni pak.

5 PY. Është 6 korrik '99:

6 "Qeveria e Përkohshme e Kosovës, dhe unë personalisht,
7 distancohemi nga këto akte".

8 E ka fjalën për sulmet, po të shohim paragrafin më
9 përpara, pra:

10 "Thaçi insistoi se UÇK-ja nuk ishte përgjegjëse për
11 sulmet kundër serbëve të cilët janë vënë në shënjestër nga --
12 personat me kombësi shqiptare të cilët kërkojnë -- të marrin
13 hak për dhunën serbe kundër tyre.

14 Qeveria e Përkohshme e Kosovës, dhe unë personalisht,
15 distancohemi nga akte", tha ai në një konferencë për shtyp.
16 "Nuk do të lejojmë anarki në Kosovë".

17 Pra, kjo përputhet shumë me atë çfarë ka thënë Thaçi në
18 këto kohëra të turbullta në fillim të korrikut të vitit '99,
19 kështu?

20 PË. Po.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Atëherë Gjykatës, e ofrojmë këtë
22 dokument për t'u futur në prova gjyqësore.

23 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT02051

25 [Sipas përkthimit] deri në 020572, në faqen 020571, pranohet.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 96

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
2 kjo faqe merr numrin e Provës Materiale 1D88.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Ky artikull është i 6 korrikut.
4 Kalojmë tani në DHT01459.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta
6 përsërisni prapë ju lutem.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Është me numër DHT01459. Është
8 video. Është 6 korrik '99 në Prishtinë. Ju lutem ta nxjerrim
9 dhe këtë.

10 [Luhet videoincizimi]

11 PËRKTHYESI: "Është e vërtetë se kohëve të fundit, sidomos
12 pas përfundimit të luftës, në veçanti këto ditët e fundit kemi
13 pasur një dukuri jo të mirë, jo të ndershme, jo të
14 përgjegjshme për situatën nga individë apo grupe të caktuara
15 të cilët janë marrë me thyerjet e banesave, me keqpërdorimet e
16 edhe me keqpërdorimin e simboleve të Ushtrisë Çlirimtare të
17 Kosovës me plaçkitje, thyerje, djegie, shkatërrime. Po ashtu
18 edhe me thyerjen e monumenteve dhe busteve të vëra nga serbët.
19 Kjo është një dukuri që neve na ka penguar dhe është duke na
20 shqetësuar. Qeveria e përkohshme e Kosovës dhe unë
21 personalisht distancohemi nga veprime të tilla të
22 papërgjegjshme".

23 Z. KEHOE: [Përkthim]

24 PY. Përsëri znj. Mitchell, e keni parë këtë konferencë
25 asokohe?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 97

1 PË. Jo.

2 PY. Po është përsëri z. Thaçi në të njëjtën ditë 6 korrik që
3 dënon sulmet kundër serbëve.

4 PË. Po.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] E ofrojmë këtë për prova materiale.

6 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT01459

8 pranohet me klasifikimin publik.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
10 marrë numrin e Provës 1D89.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] E vë re orën dhe pjesa që më ka
12 mbetur është më e gjatë. Kështu që është mbase -- për t'i parë
13 të gjitha njëherësh. Bën fjalë për situatën në -- Stari
14 Gracko. Është pak më e gjatë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
16 pushimin tani, një orë e gjysmë. Do të kthehemi në orën 14.30
17 për seancën e fundit. Ju lutem shoqërojeni dëshmitarin të dalë
18 nga salla.

19 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë këtu
21 ndërprerjen e seancës deri në orën 14:30.

22 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.59

23 --- Seanca rifillon në orën 14.31

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni ju
25 lutem.

1 Trupi Gjykses do të trajtojë tani çështjen e dokumentit
2 të shënuar për identifikim 1D000074-ET.

3 Mbrojtja e Thaçit ka paraqitur një version të korigjuar
4 të përkthimit në anglisht, dhe Trupi Gjykses urdhëron që
5 versionin i korigjuar i përkthimit të pranohet. E keni këtë
6 përkthim?

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, e kemi ngarkuar në listën e
8 materialeve.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Si thatë?

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Është ngarkuar në listën e
11 materialeve.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse nuk ka
13 kundërshtim - me sa duket nuk ka.

14 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kemi.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti me
16 numrin 1D000074-ET pranohet. Faleminderit

17 Znj. Asistente e sallës, ju lutem shoqëroni dëshmitaren
18 të hyjë në sallë.

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] Z. Gjykatës, mund t'ju informoj
20 juve si Trup Gjykses por edhe Prokurorinë që për shkak të
21 temave që ka mbuluar z. Kehoe, me shumë gjasë koha që do të
22 përdorim do të ulet në mënyrë drastike, në mos po nuk do të
23 përdor fare, kështu që do të shikojmë sesi do të vazhdoj këtë
24 gjysmë ore.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 99

1 besoj se edhe ju keni të njëjtin qëndrim?

2 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, nuk do të merremi me temat e
4 mbuluara. Besoj rreth 20 minuta.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju, besoj
6 te 40 minutëshi?

7 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Pak a shumë, mbase edhe shumë
8 më pak.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
10 vazhdojmë me pyetjet që z. Kehoe i ka për ju.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
12 PY. Mirëdita. Shpresoj që mos t'ju marr shumë kohë.

13 Siç e thamë para drekës, dua që të flasim tani për
14 vrasjet në Graçkën e Vjetër, të cilën -- për të cilën unë e di
15 që ju dini shumë. Është dokumentuar që -- mbase e kam gabim,
16 por më korrigjoni, por 14 serbët janë vrarë në Graçkën e
17 Vjetër.

18 PË. Besoj se kaq.

19 PY. Dhe sigurisht besoj kjo ka ndodhur në pjesën e dytë të
20 korrikut të vitit 1999?

21 PË. Po, e saktë.

22 PY. Por kjo i ka rritur shumë tensionet në zonë, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. T'ju tregoj tani një video, që është me numër DHT00906. E
25 njëjta është edhe në anglisht. Është një video e 24 korrikut

1 të vitit 1999.

2 [Luhet videoincizimi]

3 "Ky akt është një akt kundër demokracisë, popullit të
4 Kosovës, bashkësisë ndërkombëtare, ky akt i konvenon vetëm
5 Millosheviçit dhe regjimit të tij dhe askujt tjetër në Kosovë
6 dhe në botë.

7 Ky akt i dhunës ndodhi në ditën kur përfundoi faza e dytë
8 e procesit të demilitarizimit të Ushtrisë Çlirimtare të
9 Kosovës.

10 Me këtë rast ftoj edhe një herë serbët të cilët janë në
11 Kosovë që të mos largohen nga Kosova, që të mos kenë frikë nga
12 shqiptarët, të afrohen me njëri-tjetrin, si qytetarë të
13 barabartë të Kosovës, ta ndihmojnë njëri-tjetrin, ta
14 respektojnë njëri-tjetrin, të integrohen me njëri-tjetrin, dhe
15 të ndërtojnë një shoqëri me të vërtetë, të mirëfilltë qytetare
16 moderne."

17 Z. KEHOE: [Përkthim]

18 PY. Znj. Mitchell, këtu dëgjua sërish z. Thaçi që dënoi
19 krimin e tij [Sipas përkthimit], si -- pra, ai në këtë rast
20 është zëri i bashkësisë shqiptare të Kosovës që e dënon fort
21 krimin e ndodh -- dhe vrasjen e 14 serbëve, të 14 korrikut
22 [Sipas përkthimit] të vitit 1999, apo jo?

23 PË. Po.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj që ta ofrojmë këtë në prova.

25 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 101

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali me
2 numër DHT00906, shqip dhe anglisht pranohet.

3 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo
4 merr numrin 1D90.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe mund të
6 ri klasifikohet si publike?

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Po.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kështu do të
9 veprohet.

10 Z. KEHOE: [Përkthim]

11 PY. Kalojmë tani te një raport i monitoruesit të BBC-së,
12 020644-020645. Faqet që na interesojnë janë 020644.

13 Znj. Mitchell --

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, më falni, mund ta ngrini lart.

15 PY. Është një raport i BBC-së që kap si burime *Kosovo Press*.
16 Është sërish këtu deklarata e z. Thaçi ku dënon vrasjet në
17 Reçak. Në këtë rast jepet pra nga *Kosovo Press*. *Kosovo Press*
18 është një nga gazetatat lokale të Kosovës, shqiptare të Kosovës,
19 kështu është?

20 PË. Po.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] E ofrojmë këtë dokument që të jetë
22 në provat gjyqësore.

23 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Është e pranuar me
24 numrin e provës P527.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Po mirë, është më e lehtë atëherë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 102

1 PY. Kalojmë tani te numri 018312. Është artikull gazete nga
2 "Shekulli" dhe edhe këtu janë komentet nga Gjenerali Jackson,
3 por është edhe z. Thaçi që dënon vrasjet. Dhe "Shekulli" në
4 fakt është një tjetër burim lokal mediatik, apo jo?

5 PË. Po, është.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e ofrojmë këtë
7 dokument për të qenë në provat materiale.

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali me
10 numër 018312 pranohet, dhe të riklasifikohet si publike, nëse
11 nuk është si e tillë.

12 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo
13 do të jetë prova materiale me numrin 1D91.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Kalojmë tani në një tjetër
16 konferencë për shtyp, më pas. Është në tetor, me numër
17 DHT02796, i datës 15 tetor të vitit 1999.

18 [Luhet videoincizimi]

19 "Komuniteti ndërkombëtar nuk duhet të përsërisë në Kosovë
20 gabimet e bëra më parë në Bosnje-Hercegovinë. Është shprehur
21 sot kështu Hashim Thaçi, kryeministri i Qeverisë së Përkohshme
22 të Kosovës, i cili ka bërë pasqyrën e gjendjes aktuale, pas
23 katër muaji të menaxhimit të krahinës shqiptare nga komuniteti
24 ndërkombëtar."

25 "Perspektivën e Kosovës, mund ta sigurojnë vetëm faktorët

1 e vetëdijshëm politikë, të cilët janë koshientë për rrezikun e
2 vazhdueshëm nga hegjemonizmi serb, nga që recedivën e kësaj
3 politike po e përjetojmë të gjithë --"

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Mund të vendosim transkriptimin e
5 kësaj video. Transkriptimi ka numrin DHT02796, dhe ta kthejmë
6 nga fillimi.

7 [Luhet videoincizimi]

8 "Komuniteti ndërkombëtar nuk duhet të përsërisë në Kosovë
9 gabimet e bëra më parë në Bosnje-Hercegovinë. Është shprehur
10 sot kështu Hashim Thaçi, kryeministri i Qeverisë së Përkohshme
11 të Kosovës, i cili ka bërë pasqyrën e gjendjes aktuale, pas
12 katër muaji të menaxhimit të krahinës shqiptare nga komuniteti
13 ndërkombëtar."

14 "Perspektivën e Kosovës, mund ta sigurojnë vetëm faktorët
15 e vetëdijshëm politikë, të cilët janë koshientë për rrezikun e
16 vazhdueshëm nga hegjemonizmi serb, nga që recedivën e kësaj
17 politike po e përjetojmë të gjithë. Ndërkohë, nga Kosova kemi
18 rreth 5000 njerëz të burgosur, qe kena [e pakuptueshme], që
19 ende mbahen në burgjet serbe. Kemi Kosovën ende të ndarë.
20 Qyteti i Mitrovicës vazhdon të jetë i ndarë. Kemi qytetin e
21 Rahovecit të barrikaduar. Por ajo çka është duke ndodhur në
22 Mitrovicë, me të vërtetë mjerisht, është duke -- është duke u
23 legjitimuar edhe nga faktorët që kanë ardhur në Kosovë për të
24 eliminuar ndarjen e saj. Edhe me të dukshëm duken veprimet e
25 disa dezertorëve të luftës, që në paqe dëshirojnë për ta

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 104

1 treguar, gjoja, trimërinë ndaj qytetarëve të pafuqishëm. Ata
2 që në luftë nuk u dëshmuan kundër pjesëtarëve të makinerisë
3 makabre të regjimit serb, në paqe janë rrezikojnë
4 bashkëqytetarët e vet. Lufta kundër regjimit serb do të
5 përfundoj me sukses atëherë kur të gjithë faktorët veprues në
6 Kosovë t'i shpallin luftë primitivizmit, duke krijuar vetëdije
7 të qartë politike dhe kombëtare. Në Kosovë duhet të dominojë
8 filozofia e faljes dhe tolerancës dhe jo e hakmarrjes”.

9 “Stabiliteti i Kosovës, ka deklaruar më tej kryeministri
10 Thaçi, varet nga shkalla dhe shpejtësia e rindërtimit dhe e
11 anasjelltas. Por rindërtimi i Kosovës ka theksuar ai, nuk mund
12 të realizohet pa kontributin e komunitet ndërkombëtar. Qeveria
13 e përkohshme e Kosovës, vijoji më tej Thaçi, e konsideron si
14 pjesë të interesit të posaçëm kosovar mbrojtjen dhe afirmimin
15 e të gjitha etnive në Kosovë. nëse ne do të jemi në nivel për
16 përgjegjësinë që kemi marrë, ka përfunduar ai, shpresoj se
17 Kosova në të ardhmen do të merret si shembull i transformimit
18 të suksesshëm në Evropën juglindore.”

19 Z. KEHOE: [Përkthim]

20 PY. Pra, sërish, pra, janë fjalime të cilët ka filluar që t'i
21 japë që në qershor, dhe jemi tani në tetor. Pra, ka një
22 periudhë kohe që është ndjekur një praktikë e vazhdueshme, ku
23 z. Thaçi i ka dhënë deklarata për të shuar dhunën dhe për të
24 pasur pajtim mes të gjitha palëve etnike dhe për të pasur një
25 pajtim paqësor në të gjithë vendin, apo jo?

1 PË. Do të doja që ta zbërthenit -- po dëgjoja se çfarë po
2 thoshe dhe s'e kuptova pyetjen.

3 PY. Patjetër. Pra kemi këtu një situatë ku Presidenti Thaçi
4 flet për njerëz të cilët po lëndojnë civilët e pambrojtur dhe
5 ai e ka bërë këtë thirrje deri në tetor. Pra është diçka të
6 cilën ai e ka bërë që prej fillimit, pra -- më falni, që prej
7 qershorit dhe korrikut. Tani edhe në gusht. Jo, më falni. E
8 kam fjalën për tetorin.

9 PË. Po.

10 Z. HALLING: [Përkthim] E ofrojmë këtë për provat.

11 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT02796 si
13 video dhe transkriptimi DHT02796 që është transkriptimi i
14 përkthyer në anglishte pranohet.

15 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo
16 do të jetë prova materiale me numër 1D92, dhe është e
17 klasifikuar tashmë si publike.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Kalojmë tani te materiali me numër
19 024477 deri në 79, më intereson faqja 020478 [Sipas
20 përkthimit] që është raporti i BBC-së i datës 21 qershor i
21 vitit 1999.

22 PY. Ndryshon paksa sepse flet -- pra bëhet thirrje për një
23 Kosovë multi etnike.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju lutem nëse mund të kaloni më
25 poshtë. Është 478-a.

1 PY. Znj. Mitchell, pak durim ju lutem, sa të gjej pjesën
2 përkatëse.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] U lutem kalojmë tani te -- në fund
4 të kësaj faqeje, 477, më saktë. Më falni. Nga fundi i kësaj
5 faqeje. Po, këtu është.

6 PY. Në paragrafin në fund, dhe është 21 qershori i vitit
7 1999. Asokohe kryeministri Thaçi thotë që:

8 "Qëllimi ynë është që të kemi një Kosovë multi etnike.
9 Nuk duam që ky rajon të jetë krejtësisht, pra vetëm shqiptar."

10 Pra, që atëherë ai bënte thirrje për një Kosovë multi
11 etnike, apo jo?

12 PË. Po.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, duam që të
14 pranohet në prova gjyqësore.

15 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dhe kjo -- Prokuroria nuk ka
16 kundërshtim.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 024477 deri
18 në 024479, me pjesën në faqen përkatëse, pra 477, pranohet në
19 prova gjyqësorë.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo duam që të pranohet i gjithë
21 artikulli.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, 02447
23 deri në 79. I gjithë artikulli. Janë vetëm dy -- jo, janë
24 vetëm 3 faqe. Pranohen, në rregull.

25 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

1 thjeshtë për të vendosur numrin e saktë të ERN-së: Është
2 020477 deri në 020479 dhe kjo do të marrë numrin e provës
3 materiale 1D93, dhe është e klasifikuar që më përpara si
4 publike.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Kalojmë tani te materiali 05535,
6 05500 deri në 055550 [Sipas përkthimit], dhe e kam fjalën për
7 550-n. Është artikulli i 21 korrikut të vitit 1999.
8 PY. Është një artikull i një periodiku, ku në këtë diskutim,
9 me z. Thaçi, ai ka shprehur se dëshiron një Kosovë multi
10 etnike.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Po të kalojmë te "detyrat, pra që
12 duhet të marrë Qeveria e Përkohshme", dhe aty vëren:

13 "Duhet që të kujdeset për refugjatët dhe t'u japë atyre
14 mundësitë që të kthehen në vatrat e tyre dhe të sigurojë
15 integrimin në shoqërinë civile, dhe është -- e ritheksoj,
16 është një shoqëri -- është që të jetë një shoqëri multietnike,
17 multikulturore."

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Gjykatësi Barthe, ju e dini më mirë
19 se unë që ky periodik është gjerman. Është në gjermanisht,
20 domethënë. Nuk është më as shqiptar, asgjë tjetër. Është nga
21 të paktët që kemi ne në gjermanisht, në gjuhën gjermane.

22 PY. Pra, edhe këtu ai bën thirrje për një shoqëri
23 multietnike, multikulturore, në përputhje me atë që ju thatë
24 përpara, që siç ka vepruar më përpara. Kështu është?

25 PË. Po.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 108

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që të
2 përfshihen edhe këto materiale -- të përfshihet edhe ky
3 material në provat gjyqësore.

4 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
6 çaktivizuar]

7 Numri 05535 deri --

8 Z. KEHOE: [Përkthim] T'ua jap edhe një herë?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, se na
10 keni dhënë tre numra.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Gabimisht e
12 bëj gjithmonë. Më duket se thashë 35, por është nga 05500 deri
13 në 05502. 05500 --

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 05500 deri në
15 05502 pranohet.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
17 kjo quhet prova materiale me numrin 1D94, mirëpo dhe
18 aktualisht e ka klasifikimin si konfidenciale.

19 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim që të
20 klasifikohet si publike, por duam që të marrim parasysh që të
21 pranohet edhe përkthimi në anglishte, me shtojcën -ET.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
23 ri klasifikohet si publike dhe pranohet në prova.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] T'ju tregoj një fotografi tani që
25 është DHT00894, por duket se është një seri. Prizreni është

1 një varg, nga 894, deri në DHT00898. Më intereson fotografia
2 në 898.

3 PY. Ua tregoj këtë fotografi që është nga 21 korriku i vitit
4 1999. Z. Thaçi, Trajkoviç dhe z. Ambasador Kouchner. Z. Thaçi
5 ka një fëmijë të vogël përpara, e keni parë më përpara këtë
6 fotografinë në media?

7 PË. Jo.

8 PY. Po a i njihnit këta persona që janë këtu në këtë
9 fotografi? Kouchner besoj se e njihni.

10 PË. Po.

11 PY. Dhe z. Thaçi. Po udhëheqësit e tjerë që janë në këtë
12 fotografi?

13 PË. Nuk jam e sigurt nëse është Prifti Sava. Nuk e di.

14 PY. Nëse nuk e njihni --

15 PË. Kam frikë se jo.

16 PY. S'ka gjë, se ja tregoj një dëshmitari tjetër.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshmitarja nuk
18 e identifikon këtë, kështu që po kaloj te një material tjetër.

19 Kalojmë tani te 2 gushti i vitit 1999, deklarata politike
20 e kësaj date, me numër SITF00265677 deri në 678. Vjen nga
21 misioni i OSBE-së. Të shikojmë pak lart datën.

22 PY. Siç e shihni datën, është 2 gushti i vitit 1999, dhe
23 thotë "Deklaratë politike e qeverisë së përkohshme të
24 Kosovës". Nëse mund të shikojmë pikën 4:

25 "Qeveria e Përkohshme shpreh indinjatën ndaj vrasjes së

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 110

1 civilëve në Kosovë, pavarësisht nga kombësia e viktimave. Këto
2 krime janë bërë, kanë rënë pre e klauzolave politike, sa i
3 takon fatit të UÇK-së dhe policisë së Kosovës. Nëse do të
4 kishim dorë të lirë për të vepruar, Qeveria e Përkohshme e
5 Kosovës dhe policia e UÇK-së do të vepronin në mënyrë efikase
6 për parandalimin e krimit në Kosovë. Qeveria e Përkohshme e
7 Kosovës u bën sërish thirrje qytetarëve të Kosovës që të lënë
8 mënjane armiqësitë dhe t'i kthehen rindërtimit të Kosovës dhe
9 zgjidhjeve të drejta dhe politike të problemeve politike.”

10 Pra, edhe këtu kemi një tjetër artikull ku u bëhet -- ku
11 ai bën thirrje për t'u dhënë fund armiqësive, apo jo?

12 PË. Po.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Kalojmë tani te pika tjetër që është
14 një shirit, që është në numrin -- është numri DHT01301 në
15 video dhe transkriptimi është 0301. Duhet të jetë
16 transkriptimi në anglisht për këtë.

17 PY. Robin Cook ishte ministri i jashtëm i Britanisë së Madhe
18 në atë kohë, kështu?

19 PË. Po.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Është në Londër, në 2 shtator të
21 vitit 1999.

22 [Luhet videoincizimi]

23 “Megjithatë, dukuria negative e largimit të një numri të
24 serbëve nga Kosova ka qenë me të vërtetë një dukuri
25 shqetësuese për ne, sepse ne jemi të interesuar që në Kosovë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 111

1 të ndërtojmë një shoqëri multietnike dhe të barabartë për të
2 gjithë qytetarët e Kosovës. Ne u kemi bërë ftesë dhe i
3 thërrasim përsëri që ata njerëz të kthehen në Kosovë, ta
4 ndihmojnë paqen dhe demokracinë. Megjithatë ne duhet të
5 punojmë dhe kam bindje të plotë se në përputhshmëri me atë të
6 cilat i kemi nënshkruar ne, do të ketë sukses të plotë për atë
7 procesin e transformimit dhe demilitarizimit të UÇK-së.

8 [Gazetari] "Z. Thaçi, zotëri, a mund të na jepni garanci
9 njëqind për qind?"

10 [Folësi pa përkthim] "Ne jemi inkurajuar me faktin se
11 deri tani UÇK-ja e ka respektuar programin dhe në fakt i ka
12 dorëzuar armët përpara afatit kur ato duhej të dorëzoheshin."

13 Z. KEHOE: [Përkthim]

14 PY. Përsëri, znj. Mitchell, edhe ky është një shembull kur z.
15 Thaçi apelon për kthimin e serbëve në Serbi [Sipas përkthimit]
16 për të themeluar një shoqëri multietnike. A është kështu?

17 PË. Po.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Paraqes këtë dokument si provë
19 materiale.

20 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim, as për
21 transkriptimin dhe as për videoincizimin.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këto
23 dokumente provohen si prova materiale.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
25 këtyre dokumenteve do t'u jepet numri i provës 1D95 dhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 112

1 dokumenti është i klasifikuar si publik.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Tani përqendrohemi në një
3 videoincizim tjetër. Është materiali me numër DHT01477,
4 transkriptimi në anglisht i këtij videoincizimi mban të
5 njëjtin numër.

6 PY. Në kohën për të cilën po flas, në verë të vitit 1999
7 Wesley Clark ishte komandanti i përgjithshëm i NATO-s.
8 Gjenerali Clark. A është kështu?

9 PË. Besoj që po.

10 Dëshmitarja jep një akronim - SACE.

11 PY. Është incizimi i 1 korrikut të vitit 1999.

12 [Luhet videoincizimi]

13 [Nuk ka përkthim]

14 "M. Warner: Mirë se erdhët Gjeneral.

15 "Clark: Faleminderit, Margaret.

16 "M. Warner: Dua një herë së pari të flas për misionin e
17 KFOR-it në Kosovë. Sekretarja e Shtetit Albright dje tha se --
18 që njerëzit në Kosovë nuk janë të sigurt.

19 "Clark: Unë mendoj që kjo periudhë e rregullimit të --
20 është në vazhdim, me qindra njerëz po kthehen, emocionet janë
21 të përziera. Ka shumë serbë që janë ende aty, disa që kanë
22 mundur të kenë marrë pjesë në veprime kriminale dhe të tjerë
23 të cilët kanë frikë se mund të -- atyre t'u atribuohen ato
24 krime. Ka edhe romë, po bëhen hakmarrje, qerim hesapesh,
25 mirëpo është kohë e vështirë. Trupat tona në Kosovë po bëjnë

1 ç'është e mundur por ne s'jemi polici.

2 "M. Warner: Në qoftë se serbët vazhdojnë të largohen dhe
3 nuk kthehen, a ul kjo atë kredibilitetin e NATO-s në lidhje me
4 krijimin e një shteti multi etkin?

5 "Clark: Unë mendoj që duhet të gjejmë një farë mjedisi
6 midis asaj që është ideale dhe reale, dhe ne nuk e dimë se sa
7 të shpërndara ishin ato krime dhe nuk e dimë se sa prej këtyre
8 njerëzve kanë marrë pjesë në veprime kriminale bandash në
9 shkallë masive. Ne këtë nuk e dimë dhe disa prej atyre që po
10 largohen, mund ta konsiderojnë veten edhe si caqe, shënjestra
11 edhe për drejtësinë ndërkombëtare, dhe ndërkohë udhëheqja e
12 UÇK-së po bën thirrje për të njëjtën gjë.

13 "M. Warner: Mendoni që këto thirrje janë të singerta?

14 "Clark: Po, mendoj që janë."

15 Z. KEHOE: [Përkthim]

16 PY. Këtu z. Clark po ju bën jehonë deklaratave për shoqëri
17 multietnike në Kosovë të bëra nga z. Thaçi, a është kështu?
18 PË. Po.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj që dokumenti të pranohet si
20 provë materiale.

21 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dy gjëra: Kishte një farë -- sikur
22 shkëputje në mes të incizimit. Nuk e di në qoftë se është punë
23 e uebsaitit prej nga është marrë incizimi apo në qoftë se
24 është intervista e plotë, ose vetëm klipet e asaj intervistës.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 114

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Mendoj që mund t'i japim një numër
2 për identifikimin të këtij materiali dhe pastaj t'i kthehemi
3 më vonë për t'i dhënë numër prove nesër.

4 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po nesër nuk kemi seancë.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Do të përpiqem që këtë ta zgjidhim
6 sa më shpejt që të jetë e mundur. Nuk duhet të jetë e
7 vështirë. Po mendoj me zë se çfarë duhet të bëjmë, por
8 sigurisht që do ta bëjmë atë që duhet.

9 PY. Znj. Mitchell, gjatë gjithë kësaj periudhe -

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
11 çaktivizuar]

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
13 dokumenti DHT01477, materiali DHT01477 dhe transkriptimi në
14 anglisht, do të marrin numrin 1D96, shënuar për identifikim me
15 MFI.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit.

17 PY. Gjatë kësaj periudhe kohore, Dëshmitare, kishte grupe të
18 ndryshme etnike që po punonin bashkërisht në përpjekjet e tyre
19 për të krijuar një qeveri dhe për të krijuar, që njihej,
20 Këshilli i Tranzicional i Kosovës. A ju kujtohet kjo?

21 PË. Po.

22 PY. Dhe z. Thaçi mori pjesë në këtë këshill së bashku me
23 subjekte të tjera, si serbe ashtu edhe shqiptare, duke
24 përfshirë edhe Presidentin Rugova. A është kjo e saktë?

25 PË. Po.

1 PY. Po, ka qenë Momcilo Trajkoviçi dhe disa serb të tjerë --

2 PËRKTHYESJA: Përkthyesja nuk i kapi emrat e personave të
3 tjerë.

4 PË. Nuk më kujtohen emrat e këtyre njerëzve.

5 Z. KEHOE: [Përkthim]

6 PY. Dhe gjithashtu punohej drejt edhe bashkimit të një
7 strukture të përbashkët të përkohshme. A është kjo -- a ju
8 kujtohet kjo?

9 PË. Jo, nuk më kujtohet.

10 PY. Po a nuk do të kishit thënë që gjatë gjithë kësaj kohe z.
11 Thaçi së bashku me udhëheqës të tjerë fetarë dhe etnikë mori
12 pjesë në këtë këshill tranzitor të Kosovës?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe ai ndihmoi në krijimin e forcës policore të Kosovës.
15 A është kjo e saktë?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe ai gjithashtu ndihmoi edhe në krijimin e Trupave
18 Mbrojtëse të Kosovës, apo jo?

19 PË. A e keni fjalën për TMK-në?

20 PY. Po, për TMK-në.

21 PË. Atëherë përgjigja ime është po.

22 PY. Dhe gjatë këtyre përpjekjeve, nënshkruhet edhe
23 marrëveshja për demobilizimin e plotë në 21 shtator. A është
24 kjo e saktë?

25 PË. Po.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 116

1 PY. Dhe bëhen pra përpjekje për të krijuar qeverinë, për t'i
2 kthyer serbët, për të ndalur dhunën, dhe në të gjitha këto
3 përpjekje presidenti Thaçi merr pjesë. A është kjo e saktë?
4 PË. Po.

5 PY. Dhe ndoshta nuk kemi folur shumë për këtë, por kemi folur
6 për Mitrovicën, dhe Mitrovica të paktën mund ta quajmë se
7 ishte një vend i ndjeshëm, ku shqiptarët jetonin në një anë
8 të lumit dhe serbët në anën tjetër. A është kështu?

9 PË. Po.

10 PY. Tani do të lëshoj një video për Mitrovicën. Është i datës
11 26 qershor të vitit 1999, me numër DHT01305. Pra është data 26
12 qershor e vitit 1999 në Mitrovicë.

13 [Luhet videoincizimi]

14 "Ndihem shumë mirë që po takohemi në Mitrovicë, për të
15 cilën kemi luftuar. Ne sot me z. De Millo kemi ardhur këtu për
16 të biseduar me ju, po ashtu për të biseduar edhe me palën
17 serbe përtej urës. Ne kaluam urën, urën kufitare, shkua në
18 spital. I kemi dërguar njerëzit tanë. Kanë filluar punën. Ne
19 jemi të interesuar që gjithçka ta rregullojmë në bashkëpunim
20 të ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare, dhe do ta rregullojmë.
21 Ne si gjithmonë kemi qenë të interesuar që çdo problem ta
22 zgjidhim me të vërtetë ashtu siç na e ka hije, me një
23 disiplinë, me një kulturë. Ne edhe kemi luftuar me kulturë,
24 por, edhe do të kthehemi në objektet dhe do të ndërtojmë jetën
25 me një kulturë të mirëfilltë qytetare. Jo vetëm shqiptarët por

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 117

1 demokratike shqiptare. Ne duhet të kuptojmë se edhe serbët
2 duhet të jetojnë në Mitrovicë, ata të cilët nuk kanë bërë
3 krime, ata të cilët nuk kanë vrarë njerëz. Ne nuk jemi të
4 interesuar dhe nuk i fryjmë erës së jetës njënacionale. Duhet
5 të kuptojmë se duhet të jetojmë të gjithë në Kosovë, ata që
6 duan, dëshirojnë që të jetojnë. Kosova është e kosovarëve dhe
7 do të jetojmë këtu.”

8 Z. KEHOE: [Përkthim]

9 PY. Përsëri znj. Mitchell, kemi z. Thaçi në mesin e një
10 situate mjaft të brishtë në Mitrovicë në qershor të vitit
11 1999, duke apeluar për një jetë të përbashkët midis serbëve
12 dhe kosovarëve -- dhe shqiptarëve të Kosovës, dhe duke thënë
13 se serbët kanë të drejtë të jetojnë në Mitrovicë. A është kjo
14 e saktë?

15 PË. Po.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Paraqes këtë dokument për pranim si
17 provë.

18 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kam kundërshtim.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT01305,
20 videoincizimi i 26 qershorit do të pranohet si provë.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e
22 provës 1D97. Nëse mund të na jepet sqarim për klasifikimin
23 sepse nuk kemi një shënim të tillë.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Mund të klasifikohet si dokument
25 publik.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti do
2 të klasifikohet si publik.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, vetëm një
4 minutë më duhet të konsultohem me klientin tim. Do të kthehem
5 menjëherë.

6 [Mikrofoni çaktivizuar]

7 PY. Znj. Mitchell, kemi parë një varg videoincizimesh dhe
8 artikujsh ku zoti -- Presidenti Thaçi bën apel për t'i dhënë
9 fund dhunës, bën apel për bashkekzistencë, për ndërtimin e një
10 shoqërie multi etnike, për një bashkëpunim me ndërkombëtarët
11 dhe grupe të tjera etnike. Nuk kishte ndonjë person tjetër
12 shqiptar kosovar, për shembull si Presidenti Rugova, që në atë
13 kohë, përveç Presidentit Thaçi, bënte një veprimtari të
14 këtillë në një kohë kaq të brishtë.

15 PË. Nuk më kujtohet se kush ishte në udhëheqjen shqiptare në
16 atë kohë në Kosovë.

17 PY. President Rugova, zoti e mëshiroftë, ishte në atë kohë në
18 Itali dhe nuk ishte ndër ata që po bënë thirrje për një
19 bashkëjetesë dhe fund të dhunës.

20 PË. Nuk më kujtohet asgjë në lidhje me atë periudhë.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Me kaq përfundoj pyetjet që kisha
22 për këtë dëshmitare.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
24 çaktivizuar] Znj. O'Reilly, urdhëroni.

25 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] E ndryshova vendin që të jem

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. O'Reilly

Faqe 119

1 këtu përpara pranë një mikrofoni më të gjatë, në mënyrë që të
2 më dëgjoni më mirë.

3 Pyetje vijuese të palës tjetër nga Znj.

4 O'Reilly:

5 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim]

6 PY. Mirëdita znj. Mitchell. Nuk kam shumë pyetje për ju, dua
7 të mbuloj me ju vetëm tre tema.

8 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Për temën e parë më duhet që në
9 ekran të vendosim një hartë. Është dokumenti me numër
10 SPOE00208166. Mund ta zmadhojmë pak. Dua të fillojmë me
11 Prishtinën që është në pjesën veri-lindore këtu në hartë. Mirë
12 është.

13 PY. Dëshmitare, a e shikoni Prishtinën në hartë? Diku në
14 pjesën, si të thuash në mes të ekranit, por pak nga lindja.

15 PË. Po.

16 PY. Dhe aty ishit të vendosur gjatë kohës që ishit në Kosovë.
17 Të paktën aty ishit me vendbanim, qëndronit aty.

18 PË. Po.

19 PY. Dhe gjatë ditës dilnit në terren dhe kishit takime me
20 komandantët vendorë, me stafin tuaj nëpër qytezat në rajon dhe
21 kështu me radhë. A është kjo e saktë?

22 PË. Po. Çdo herë që mundeshim.

23 PY. Dhe kur u përgjigjët në pyetjet e ZPS-së ju thatë që
24 kishit shkuar në zonën e Prizrenit për t'u takuar me një
25 komandant të quajtur Ramush Haradinaj. A kujtohet kjo

1 përgjigje?

2 PË. Po.

3 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Tani, në qoftë se mund ta
4 zvogëlojmë pak hartën që ta shohim edhe Prizrenin. Mirë është.

5 PY. E shikoni Prizrenin tani në hartë?

6 PË. Po.

7 PY. E gjetët pra në hartë. U përpoqëm që ta identifikojmë
8 periudhën kohore se kur mund të kishit qenë atje. Ju thatë që
9 mund të ketë qenë menjëherë pas dislokimit tuaj në Kosovë
10 sepse ju thatë që serbët apo njerëz po shkonin nga ajo zonë
11 dhe ju sot përmendët edhe incidentin që kishte ndodhur në
12 Rahovec. A ju kujtohet kjo përgjigje?

13 PË. Po.

14 PY. A e shikoni Rahovecin këtu në hartë?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe ju thatë se mund të ketë qenë menjëherë mbas
17 dislokimit dhe më pas thatë që këto bisedime me Ramushin mund
18 të kenë ndodhur diku menjëherë mbas masakrës së Reçakut, që ka
19 qenë diku nga mesi i shkurtit ose para evakuimit, që ka
20 ndodhur në mars, më 20 mars. A ju kujtohet kjo përgjigje?

21 PË. Po, mirëpo besoj që kishte bisedime, u zhvilluan bisedime
22 edhe përpara kësaj.

23 PY. Në rregull. Kjo na ndihmon. A ju kujtohet se çfarë
24 titulli kishte? Komandant i çka ishte Ramushi?

25 PË. Nuk e di. Ata thjeshtë quheshin "komandant zone".

1 PY. Komandant zone, po a e dinit e cilës zonë?

2 PË. Jo.

3 PY. Po në qoftë se do të dëgjonit nga provat e Prokurorisë se
4 është komandant i zonës së Dukagjinit, a do t'ju befasonte
5 kjo?

6 PË. Jo.

7 PY. Sipas provave të paraqitura nga Prokuroria, zona e
8 Dukagjinit që përfshinte qytetin e Pejës. Ju kujtohet Peja?

9 PË. Po.

10 PY. Deçanin, që është pak më poshtë, aty te rruga për
11 Gjakovë.

12 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Në qoftë se mund ta lëvizim pak
13 hartën.

14 PY. Dhe pastaj Gjakova në jug, dhe sipas provave të
15 Prokurorisë, ka përfshirë dhe një pjesë të Klinës që është në
16 lindje të Pejës, dhe një pjesë Istogut që është në veri.

17 Pra, Dëshmitare, me sa ju kujtohet, a jeni e sigurt që
18 keni folur me Ramush Haradinajn, si zonë komandant i zonës së
19 Dukagjinit në Prizren?

20 PË. Ky është emri që më kujtohet më së shumti.

21 PY. Në rregull.

22 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Atëherë mund ta heqim këtë
23 hartë dhe dua të kaloj te vëllimi 2 i librit "E treguar ashtu
24 siç është parë". Është SITF0001529. Më duhet faqja që mbaron
25 me numrat 1554.

1 PY. Për një apo dy minuta do ta kalojmë edhe një herë atë që
2 quani ju metodologji.

3 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Të shkojmë poshtë faqes, veç
4 një moment. Kërkoj ndjesë, a mund të kthehemi në krye të
5 faqes, te paragrafi i parë që fillon me:

6 "Raporti përqendrohet në informacion të mbledhur nga
7 OSBE-ja. Në pjesën më të madhe trajton nëpërmjet intervistave
8 të drejtpërdrejta me viktimat, anëtarët e familjes dhe
9 dëshmitarë. Informacione të tjera përdoren për të
10 verifikuar ose mohuar, ose për të pasur një farë konteksti për
11 të dhënat kryesore. Ky raport prandaj nuk trajton shkeljet që
12 ishin jashtë objektit të veprimit të misionit të OSBE-së. Ky
13 raport dokumenton pretendime ose akuza të mirë bazuara të
14 drejtave të njeriut -- për shkelje të të drejtave të njeriut.
15 Hetime të tjera të këtyre aktakuzave janë të nevojshme për të
16 përcaktuar natyrën e saktë të krimeve dhe/ose të shkeljeve të
17 kryera të të drejtave të njeriut, dhe të kryerësve të tyre."

18 Tani, për mendimin tim kjo përputhet me atë që na e keni
19 thënë gjatë dëshmisë tuaj gjatë këtyre ditëve. A pajtoheni?

20 PË. Po.

21 PY. Tani, do t'ju çoj te një faqe tjetër e vëllimit 2.

22 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Është faqja SITF00001750. A
23 mund të shkojmë në krye të faqes? Duhet të jemi te data 26
24 shtator. A është faqja me numrat në fund 50? Po, 1750. Ndoshta
25 ja dhashë numrin gabim Sekretares. Të shkojmë te pika e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. O'Reilly

Faqe 123

1 katërt, nëntitullin e datës 26.

2 PY. A mund të na e lexoni këtë pikë, Dëshmitare?

3 PË. Nuk pa problem por vetëm tregoni se ku është pika e parë.

4 PY. Është pika që fillon "Në orën 21.00".

5 PË. "Në orën 21.00 një shqiptar kosovar u qëllua dhe u vra
6 nga një shqiptar kosovar tjetër para një depoje të pronësisë
7 shtetërore në qendër të Pejës".

8 PY. Nuk keni përdorur poshtëshënime në lidhje me këtë
9 pretendim. Dhe nuk keni dhënë asnjë farë informacionesh të
10 tjera në mbështetje të këtij pretendimi. A është kjo e saktë?

11 PË. Po.

12 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Tani të shkojmë te një
13 poshtëshënim, ju lutem.

14 Është raporti i situatës për datën 27 dhe 28 shtator. E
15 kemi gjetur këtë raport. Nëse mund ta vendosim në ekran. Është
16 dokumenti me numër SITF00388674. A mund të shkojmë diku në
17 fund të kësaj faqeje.

18 PY. Mirë është. Tani me siguri e shikoni shënimin përkatës
19 për atë që e lexuam nga raporti, Dëshmitare. A mund, të lutem
20 të na e lexoni me zë këtë pjesë, aty te titulli "Vrasje".

21 PË. "Një shqiptar kosovar u vra me armë zjarri nga një
22 shqiptar kosovar tjetër para një depoje të pronësisë
23 shtetërore në qendër të Pejës, në qendër të Pejës, në orën 21,
24 me 26 shtator të vitit 1999. Sipas informacionit fillestar
25 është për shkak të një mosmarrëveshjeje personale".

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. O'Reilly

Faqe 124

1 PY. Pyetja ime për ju është, Dëshmitare se pse këto dy fjali
2 nuk janë përfshirë në raport në aneksin "E treguar ashtu siç
3 është parë"?

4 PË. Nuk e di.

5 PY. Dëshmitare, e keni të qartë se kemi pak të vështirë që të
6 mbështetemi në këto burime tuaja sepse siç e shihni edhe vetë
7 një pjesë e informacionit në ato burime nuk është përfshirë në
8 raportin përfundimtar.

9 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Është argumentative dhe kërkojmë -
10 - kundërshtojmë këtë pyetje.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet
12 kundërshtimi.

13 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim]

14 PY. Atëherë vazhdojmë më tej, më datën 5 dhjetor të vitit
15 2023. Znj. Mayer, që është Prokurorja, ju bëri disa pyetje që
16 kanë disa pyetje që kanë të bëjnë me takimet tuaja me stafin e
17 UÇK-së. Fillon në faqen 10594 dhe ju shpjegoni, dhe po lexoj
18 këtu nga transkriptimi. Thoni që ju mund të kishit qasje te
19 ta, ishte goxha e lehtë dhe në rreshtin 20 ju thoni:

20 "Unë mendoj që singërisht ata po përpiqeshin që të
21 rifillonin dhe të rindërtonin Kosovën kështu që kishte
22 gatishmëri nga ana e tyre që të takoheshin me bashkësinë
23 ndërkombëtare."

24 Prokurorja më pas vazhdon:

25 "E kuptoj. Pyetja ime kishte të bënte më tepër me bisedat

1 që keni organizuar komandantët lokalë, ose që stafi juaj ka
2 pasur me komandantët lokalë, dhe në qoftë se ata e kanë
3 trajtuar çështjet e personave që kishin sigmat, distinktivët e
4 UÇK-së dhe që i merrnin personat. Në qoftë se e keni ngritur
5 këtë çështje me komandantët lokalë. Pyetja ime ishte e
6 kufizuar.”

7 Dhe ju thatë që:

8 “Më vjen keq.”

9 Dhe Prokurorja thotë:

10 “Edhe një herë sa i takon zonës gjeografike, a ishte
11 diçka që ishte e përqendruar në një zonë gjeografike apo ishte
12 në të gjithë Kosovën?”

13 Përgjigja ishte: “Në të gjithë Kosovën.”

14 “PY. A do të ishte e drejtë të thuhej që kjo ishte e
15 koordinuar, përderisa kishte një ngjashmëri nga një zonë te
16 tjetra dhe nuk është se ju dha vetëm një person ose një
17 kategori të caktuar këtë informacion?”

18 Dhe ju jepni përgjigjen:

19 “Po. Dhe gjithashtu citohet edhe dokumenti i UNMIK-ut
20 lidhur me këtë.”

21 A keni të njëjtin qëndrim edhe tani lidhur me këtë
22 çështje, Dëshmitare?

23 PË. Po.

24 PY. Dëshiroj që të shikojmë përsëri raportin, volumin 2 të
25 tij. Thjeshtë një çast ju lutem.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. O'Reilly

Faqe 126

1 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] A mund të shohim faqen që
2 përfundon me faqen 1534. Është parathënia e raportit tuaj që
3 është nënshkruar nga Bernard Kouchner. Do i kërkoja Sekretares
4 të kaloni më poshtë në faqe. Jo, ngrihuni edhe pak më tepër në
5 faqe, vazhdoni më sipër ju lutem.

6 PY. Nga rreshti i katërt, dhe më poshtë. Dhe thuhet:

7 "Nuk është e drejtë që të bëhen krahasime me situatën
8 përpara ose gjatë luftës. Në atë kohë, dhe për të paktën një
9 dekadë, ka pasur politika sistematike të aparteidit. Status
10 nën-njerëzor, të paktën një status nën-bashkësie për
11 shqiptarët e Kosovës. Nuk është më rasti ky sot. Mbase mund të
12 duket po aq keq situata sot për serbët për romët të cilët
13 jetojnë në frikë, të cilët nuk mund të lëvizin lirshëm dhe që
14 nuk mund të mbrojnë fëmijët e tyre. Por kjo politikë nuk
15 ekziston kështu më sot. Të gjithë partitë në Kosovë, të gjithë
16 liderët, të gjithë udhëheqësit serbë dhe shqiptarë kanë
17 deklaruar qëndrimet e tyre pro shoqërisë multietnike dhe
18 bashkëjetesës ndërmjet të gjitha bashkësive. Krimet që shohim
19 janë akte individësh. Asnjë parti politike nuk ka marrë
20 përsipër përgjegjësinë për to. Përfaqësuesit e tyre në
21 këshillin e përkohshëm të Kosovës e kanë dënuar këtë abuzim në
22 çdo kohë për gjithmonë, dhe kanë shprehur gjithashtu edhe
23 shqetësimet e tyre sa i takon këtyre rasteve intolerance. Ne
24 nuk mund të përjashtojmë mundësinë e qëndrimeve të dyfishta
25 dhe as nuk mund të presupozojmë që ka qenë njëri qëndrim apo

1 tjetri.”

2 A i qëndroni këtij qëndrimi edhe sot, Dëshmitare?

3 PË. Z. Kouchner dhe unë shpesh i shikonim gjërat ndryshe. Nuk
4 e vë në pikëpyetje atë çfarë thotë ai.

5 PY. A ju duket befasuese që ai, i cili kishte një panoramë
6 të përgjithshme të situatës, kishte mbërritur në këtë
7 pikëpamje tërësisht të ndryshme, mbështetur në deklaratat që
8 ai kishte dëgjuar nga udhëheqësit politikë, me të cilët kishte
9 marrëdhënie shumë herë më të ngushta se sa ju?

10 PË. Jo.

11 PY. Në rregull nuk kam pyetje të tjera. Këtu përfundojnë
12 pyetjet për dëshmitaren

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. Roberts?

15 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi pyetje të tjera në këtë
16 fazë. Ju falënderojmë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis?

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit. Thjeshtë më lejoni një
19 minutë sa të organizohem.

20 Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis:

21 Z. ELLIS: [Përkthim]

22 PË. Mirëdita, Dëshmitare. Unë quhem Aiden Ellis, jam
23 përfaqësuesi i Jakup Krasniqit. Për shkak të kohës që kemi në
24 dispozicion, unë i takon që nuk do të marr shumë kohë me juve
25 sot pasdite, por përderisa jam i fundit, i takon që disa nga

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 128

1 temat do t'i kaloj përderisa janë shtjelluar më parë.

2 Tema e parë është kjo: Sot paradite z. Kehoe të tregoi
3 një pjesë të deklaratës që keni dhënë përpara Trupit Gjykues
4 në korrik të vitit 2006.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të paraqiste
6 në ekran dokumentin IT0574 deri në 0578 [Sipas përkthimit] në
7 faqen 615, ju lutem.

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Duket sikur ngriu transkriptimi.
9 Jo, ju kërkoj ndjesë. Është Okej tani.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Për këtë dokument e kisha fjalën,
11 faleminderit.

12 PY. Pra, dua që të shikoi rreshtin 9 këtu. Është një pyetje
13 që ua bëri edhe më herët z. Kehoe, që:

14 "...UÇK-ja nuk ishte e unifikuar në mënyrë qendrore të
15 koordinuar, të bashkërenduar. Kishte komandantë të ndryshëm
16 dhe kishte pamje të ndryshme ose ishe -- dukej ndryshe në
17 pjesë të ndryshme të Kosovës."

18 Dhe ju thatë "Po, komunikata është e vërtetë", apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Në rreshtat 23-24 në të njëjtën faqe ju thoni që ata mund
21 të silleshin ndryshe në varësi të faktit se kush ishte
22 komandant zone. A është e vërtetë kjo?

23 PË. Po.

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Të kalojmë te pjesa e parë, nga
25 rreshti 6 deri në 12, përsëri. Ju kërkoj ndjesë, rreshtat 14,

1 15, 16.

2 PY. Ju në atë kohë ishit të informuar që ishin krijuar grupe
3 të natyrshme për mbrojtjen e fshatrave, të cilët e quanin
4 veten UÇK, apo jo?

5 PË. Po.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Më tej në rreshtin 11 dhe 12 ju
7 thoni që ishte e vështirë ndonjëherë që ju ta dinit se kush
8 ishte pjesë e UÇK-së. Ose me fjalë të tjera, ju ndonjëherë nuk
9 e dinit se kush ishte pjesë e UÇK-së, sepse këta grupe
10 njerëzish e thërrisnin veten, e quanin veten UÇK, kështu?

11 PY. Po.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Vazhdojmë më tej me transkriptimin
13 në faqen 520 [Sipas përkthimit].

14 PY. Është në fakt faqja 620, është pjesë e dëshmisë tuaj që
15 keni dhënë në vitin 2006 për TPNJ-në. Pyetja që ju bëhet është
16 në qoftë se e dini nëse UÇK-ja ndonjëherë vishej me rroba
17 civile dhe ju thoni "Po". Kështu mendoni edhe sot? Këtë
18 qëndrim keni edhe sot?

19 PË. Po.

20 PY. Më pas ju pyeteni:

21 "A është e vërtetë të thuhet që stafi i MVK-së ka
22 mbërritur në përfundimin në raport që pjesa dërrmuese e
23 radhëve të anëtarëve të UÇK-së ishin fshatarë me disa -- ishin
24 fshatarët me armë."

25 A mendoni kështu edhe sot e kësaj dite?

1 PË. Po.

2 PY. Në rreshtin 13 deri në rreshtin 15 të së njëjtës faqe, ju
3 bëhen pyetje lidhur me vendet e strukturave që po krijoheshin.
4 Dhe në përgjigje ju thoni që:

5 "Pa diskutim që ishin struktura që orientoheshin mbi bazë
6 fshati. Ishin të ndërtuara mbi bazën e fshatit."

7 Është e vërtetë kjo?

8 PË. Po.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund ta hiqni këtë dokument nga
10 ekrani.

11 PY. Tani dëshiroj që t'ju bëj disa pyetje lidhur me vizitat
12 që ju thoni që keni bërë në vendet e ndalimit të UÇK-së në
13 përudhën përpara evakuimit, para largimit tuaj nga Kosova,
14 domethënë përpara marsit të vitit 1999. Ju gjatë këtyre ditëve
15 ju janë bërë pyetje lidhur me vizitën në shkurt të vitit 1999,
16 që e keni bërë së bashku me znj. Ringgaard me Remin dhe Fatin
17 në Llapashticë. A ju kujtohet dëshmia e dhënë lidhur me këtë
18 pikë?

19 PË. Po.

20 PY. Prokurorja ju tha që ju keni vizituar qendra të ndalimit
21 pesë apo gjashtë herë, dhe megjithëse nuk ju kujtohej shumë
22 mirë, ju thatë që ishte shumë e mundur që të keni vizituar kaq
23 herë.

24 PË. Nuk e kam shumë të qartë, po mund të ketë qenë disa herë.

25 PY. Ju treguan disa dokumente sa i takon vizitës tuaj në

1 Lllapashticë në shkurt të vitit 1999 dhe besoj se ju konfirmoni
2 që këto dokumente si procedurë ose hartoheshin të nesërmen e
3 ditës së vizitës ose në darkën e ditës së vizitës, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Kjo ka qenë procedura e zakonshme për të shkruar raportet
6 kur bëheshin vizitat në qendrat e ndalimit? Domethënë që
7 raportet të shkruheshin sa më shpejt pas vizitës, sa të ishte
8 e mundur?

9 PË. Po.

10 PY. Por juve nuk iu tregua ndonjë dokumentacion, ndonjë
11 shkresë që mbështeste vizitat tuaja në qendrat e ndalimit në
12 atë kohë, apo jo?

13 PË. Jo.

14 PY. Dua që të shikojmë një pjesë te volumi i librit "Siç
15 është parë ashtu edhe është treguar".

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Referenca për dokumentin është SPOE
17 dhe dua që të paraqitet dokumenti që përfundon me 198220. Mund
18 të jetë një dokument që në fakt është pranuar dhe më herët. Të
19 kalojmë më poshtë në faqe.

20 PY. Paragrafi që është në fund të ekranit, do ju kërkoja,
21 znj. Mitchell, që ta lexonit këtë paragraf. Kjo ka të bëjë me
22 qasjen ndaj të ndaluarve në një rast apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Në qoftë se do shikojmë poshtëshënimin, që është
25 poshtëshënimi numër 39, që besoj që do na çojnë në faqen që

1 përfundon me 224 në dokument, dhe është qoftë se do ta lexojmë
2 atë që është shkruar në atë poshtëshënim -- ja ku është.
3 Mendoj që kjo është referenca që ka të bëjë, domethënë që
4 përmend në takim një takim që ju keni pasur me komandantin e
5 zonës në Lllapashticë me datë 18 shkurt, apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Duket se i vetmi rast i vizitës që ju keni bërë një
8 vizitë në një qendër ndalimi nga ato që pasqyrohen në raportin
9 tuaj, është vizita që keni pasur me Remin dhe me Fatin në
10 Lllapashticë, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Në qoftë se do të kishte pasur vizita të tjera besoj që
13 kjo do të ishte dokumentuar apo jo? Pra mendoj që do të ishin
14 dokumentuar. Dhe në qoftë se do të kishte pasur vizita të
15 tjera i takon që duhet të ishin dokumentar apo jo?

16 PË. Duhet të ishin dokumentuar dhe dokumentet duhet të ishin
17 lënë në Kosovë.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të shkojmë në provën
19 materiale P3?

20 PY. Ky është një dokument i cili është përgatitur nga Susanne
21 Ringaar. Ka të bëjnë me një takim me komandantin e zonës në
22 Petrov, në shkurt të vitit 1999. A ju kujtohet që të keni
23 shkruar në një takim ku e keni shoqëruar znj. Ringgaard?

24 PË. A mund ta shoh pak më poshtë dokumentin.

25 PY. Doni të shikoni pjesën e fundit të dokumentit?

1 PË. Po, faleminderit.

2 PY. A ju kujtohet, a e keni shoqëruar znj. Ringgaard në këtë
3 rast në Petrov?

4 PË. Nuk më kujtohet.

5 PY. Dua të shihni paragrafin e dytë, paragrafin e dytë që
6 fillon që:

7 "E informova komandantin e zonës..."

8 Më duket se znj. Ringgaard është përpjekur që të përdorë
9 shembullin e Llapashticës për ta bindur komandantin e kësaj
10 zone për të biseduar me të ndaluarit. E kuptoj ashtu siç duhet
11 këtë paragraf?

12 PË. Po.

13 PY. Në këtë rast, komandanti i zonës në Petrov nuk e ka
14 lejuar vizitën, kështu?

15 PË. Po.

16 PY. Pra ky është një shembull tjerë që komandantë të ndryshëm
17 të zonave silleshin në mënyra të ndryshme apo jo?

18 PË. Po.

19 PY. Por nuk u parashtrua, nuk i është thënë komandantit të
20 zonës në Petrov që ka shumë komandantë të tjerë të zonave të
21 cilët lejojnë vizitat e të burgosurve ose të ndaluarve. Por i
22 përmendet vetëm një vizitë, vizita në Llapashticë, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Por është kjo vizita të cilën në të cilën ju nuk ju
25 kujtohet personeli, personat e përfshirë dhe kështu me radhë,

1 apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. A mund të ndodhë që në fakt vetëm një rast mund të ketë
4 qenë vizita. Është pikërisht ky rasti i cili ju e keni të
5 pasqyruar në raportin tuaj.

6 PË. Nuk më kujtohen biseda të tjera, por fatkeqësisht, për
7 arsye të ndryshme, dokumentacioni nuk ekziston kështu që nuk
8 mund ta them me siguri.

9 PY. Mirë, në rregull. kalojmë në një temë tjetër.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund ta hiqni këtë dokument nga
11 ekrani.

12 PY. Në raportet për të drejtat e njeriut përpara marsit të
13 vitit 1999 ju nuk kishit shumë bashkëpunim me autoritete
14 serbe, apo jo?

15 PË. Ishte shumë e përzier situata, megjithatë në përgjithësi
16 nuk kishim bashkëpunim.

17 PY. Dokumentet që merrnin prej tyre ishin kryesisht
18 propagandë apo jo?

19 PË. Kryesisht po.

20 PY. Çdo gjë ishte e paragjykuar dhe nuk kishte shumë
21 mbështetshmëri ose informacion që merrnit nga ata nuk është
22 se ishte shumë i mbështetshëm apo shumë i kredibil, apo jo?

23 PË. Po, të paktën në dosjen që kemi parë neve.

24 PY. Në rregull. Z. Kehoe ju bëri disa pyetje sa i takon
25 operacionit të maskues dhe dua t'ju bëj disa pyetje lidhur me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 135

1 këtë operacion ku i hidhej faji UÇK-së nga forcat serbe.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Kështu që dëshiroj që të shkojmë një
3 video që identifikohet me numrin DJK00568.

4 [Luhet videoincizimi]

5 PËRKTHYESI: Një pjesëtar i UÇK-së i armatosur deri në
6 dhëmbë, kështu?

7 "PË. Po. Kështu.

8 "PY. Dhe ju e keni ndryshuar uniformën shpesh, apo jo?

9 "PË. Po.

10 "PY. Kur flas për ndryshimin e uniformës, flitet vetëm
11 atëherë kur ka qenë e nevojshme?

12 "PË. Kjo është e saktë.

13 "PY. Pra ju keni qenë ushtar i UÇK-së në qoftë se ju
14 duhej të hiqni këtë rol?

15 "PË. Në qoftë se është e nevojshme po. Slavko Nikiç jam
16 unë. Njerëzit janë përpjekur ndonjëherë që këtë fotografi t'ia
17 tregojnë publikut si fotomontazh -- si fotomontazh, dhe unë ja
18 kam institutit të sigurimit këtë gjë. Në qoftë se ata më
19 provojnë që ishte fotomontazh, do ua paguaj unë kostot. Në
20 qoftë se ata nuk e provojnë, do më japin mua atë
21 dëmshpërblimin. Ata nuk bien dakord sepse e dinin që kjo ishte
22 uniforma të cilën unë kam veshur në një kohë.

23 Z. ELLIS: [Përkthim]

24 PY. Pra duket që personi që foli këtu ka veshur uniformë dhe
25 kishte bërë edhe një fotografi me këtë uniformë sepse ishte më

1 e thjeshtë për të komunikuar në qoftë se do të kishte këtë
2 uniformë. Këtë besoj që dëgjuam nga videoja.

3 PË. Po.

4 PY. Do ju tregoj një tjetër dokument.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Dokumenti tjetër gjendet në listën e
6 dokumenteve të z. Selimi. Në rrethanat përkatëse dua që t'ju
7 kërkoj leje, të nderuarve Gjykatës, që të përdoret dokumenti
8 që është në listën e dokumenteve të Selimit dhe jo të klientit
9 tim.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
11 çaktivizuar]

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Bëhet fjalë për dokumentin DRS0096.

13 PY. Besoj që ju bënë disa pyetje dje lidhur me incidentin në
14 kafenenë Panda nga z. Kehoe. Ky është një artikull nga
15 shtatori i atij viti. Dëshiroj që të shikoni paragrafin që
16 është i theksuar, që është paragrafi kryesor. Këtu thuhet që
17 të afërm të viktimave i bëjnë një kërkesë zyrës së Prokurorit
18 Publik dhe presidentit serb Aleksandër Vuçiç që të ndjekin
19 rastin, të ndjekin penalisht rastin. E shikoni këtë?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe në qoftë se kalojmë te paragrafi i tretë dhe ju thoni
22 që arseja që pse ju pyesni që të bëhen pyete, të merren në
23 pyetje, është që Vuçiç ka bërë deklarata për sa i takon
24 masakrës së Pandës në disa raste dhe ka pretenduar që krimi
25 nuk ishte kryer nga shqiptarët dhe ka pretenduar "që

1 praktikisht ai e di se çfarë ka ndodhur në atë kafene atë natë
2 të pafat.”

3 E shikoni këtë pjesë, Dëshmitare?

4 PË. Po.

5 PY. Ky është informacion i cili është zbuluar më vonë, është
6 informacion që ju nuk e keni poseduar, nuk e keni pasur në
7 vitin që keni nxjerrë raportin tuaj “Siç është parë ashtu
8 është treguar” apo jo?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe nuk ka ndonjë mekanizëm, nuk ka ndonjë procedurë për
11 përditësimin e informacion ose korrigjimin e informacionit të
12 raportit tuaj pasi raporti është bërë publik.

13 PË. Është e saktë unë nuk punoj më për OSBE-në por nuk mendoj
14 se ka ndonjë procedurë ose mekanizëm për të korrigjuar
15 raportet e mëparshme.

16 PY. Në atë kohë OSBE-ja nuk kishte as burimet dhe as mandatin
17 që të ndiqte raste individuale dhe të konfirmonte identitetin
18 e kryerësve të pretenduara apo jo?

19 PË. Jo, nuk i kishim.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që këto
21 dy materiale të pranohen si prova materiale. Videon,
22 transkriptimin dhe artikullin e gazetës.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Video

24 DJK00567-TR-ET [Sipas përkthimit] dhe përkthimi i saj 00568
25 pranohen si prova materiale dhe mendoj që neni që -- artikulli

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 138

1 i gazetës DRS00096 është vetëm një faqe, apo jo, z. Ellis.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Mendoj se vazhdon edhe te faqja
3 tjetër, faqja e dytë, që është DRS00097, të nderuar Gjykatës.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe DRS00096
5 dhe 97 pranohen si prova materiale. Si mund të klasifikohen si
6 publike? Besoj në qoftë se nuk kundërshtim, duhet të
7 klasifikohen si të tilla.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund të klasifikohen si publike, nuk
9 ka problem.

10 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kundërshtojmë. Dokumentet sa i
11 takon klasifikimeve janë materiale të cilat paraqiten nga
12 Mbrojtja.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
14 videoja dhe transkriptimi do të marrin numrin e provës
15 materiale 4D15 dhe artikulli do të marri numrin e provës
16 materiale 4D16.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

18 PY. Grupi i fundit i pyetjeve ka të bëjë me raportin "Sikurse
19 është parë ashtu është treguar", volumin 2.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
21 vazhdoni z. Ellis, mund ta zgjasni edhe pak më tepër deri sa
22 të përfundoni.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit. Nuk është shumë e
24 gjatë ndërhyrja ime, por ndoshta mund të jetë më e gjatë sesa
25 ora 16.00.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
2 çaktivizuar].

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Ndoshta pesë minuta më shumë se
4 është parashikuar, të nderuar Gjykatës.

5 PY. Është e vërtetë apo jo që sa i takon metodologjisë së
6 këtyre raporteve, ju nuk jepnit emrat e viktimave dhe
7 dëshmitarëve dhe të kryerësve të pretenduar si rregull i
8 përgjithshëm, apo jo?

9 PË. Po, si rregull i përgjithshëm, po.

10 PY. Dhe oficerët e të drejtave të njeriut në terren janë
11 personat që kanë marrë rrëfimet apo tregimet e dëshmitarëve
12 fillestarë që përbënin më pas bazën e raportit, apo jo?

13 PË. Po, mund të kenë qenë edhe anëtarë të OSBE-së.

14 PY. Por në rastet kryesore nuk keni qenë ju vetë, apo jo? Ka
15 qenë dikush tjetër?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe sa i takon procedurës në atë kohë, pas regjistrimit
18 të përgjigjeve për pyetësorët të dokumenteve tip?

19 PË. E keni fjalën pas evakuimit?

20 PY. Po flasim për volumnin 2.

21 PË. Ju kërkoj ndjesë. Pas evakuimit, kur u kthyem, ne kemi
22 pasur ca lloj shabllonësh, kështu që kemi pasur edhe kompjuter
23 të lëvizshëm, kështu që thjeshtë jepnim -- plotësonim
24 seksionet e ndryshme të formularëve.

25 PY. E kuptoj, por procedura ka qenë e tillë që oficeri i të

1 drejtave të njeriut ose kushdo person tjetër që mund të ketë
2 qenë me ekipin që ka kryer intervistën, intervistën e ka kryer
3 përmes një përkthyesi në terren, apo jo?

4 PË. Kjo është e saktë.

5 PY. Dhe në qoftë se kishte ekipe të cilët nuk flitej
6 rrjedhshëm shqipja ose anglishte në atë kohë, çfarë ndodhte?

7 PË. Nuk më kujtohet ndonjë rast i tillë.

8 PY. E kuptoj, por sa i takon shkrimit të dorës? Çfarë ndodhte
9 me shkrimin e dorës? Si bëhej transferimi ose hedhja e të
10 dhënave nga shkrimi i dorës te formularët?

11 PË. Po.

12 PY. Po, dhe këto formularë fillestarë pastaj a përpunoheshin
13 në nivel qendror dhe pastaj a transferoheshin ato në histori,
14 të cilat më pas i keni shkruar në raportin tuaj "Siç është
15 parë ashtu është treguar"?

16 PË. Jo domosdoshmërisht. Në qoftë se më lejoni, dua që ta
17 shpjegoj. Në fushat ku mblidhej informacioni, kishim zyra
18 rajonale të cilat e mblidhnin informacionin dhe bënin edhe
19 komentet e tyre dhe më pas i dërgohej informacioni Alison
20 Jolly.

21 PY. Në rregull.

22 PË. Dhe ndonjëherë ktheheshin, behshin pyetje për ata që
23 kishin marrë shënimet fillestare.

24 PY. Domethënë, ajo çfarë po bënit ju është që po dokumentonit
25 pretendime për procesverbal historik, ose për historik të

1 përgjithshëm. Nuk ishin hetime të mirëfillta penale, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe ne kemi parë në një pasazh nga një pjesë e znj.

4 O'Reilly që e tregoi pak më herët që OSBE-ja nuk i ka kërkuar

5 llogari, ose nuk është se ka bërë apel për hetime penale në

6 ndonjë fazë tjetër të mundshme apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. Por ka pasur edhe raste kur individë që pretendoheshin të

9 kishin kryer vepra janë larguar nga Kosova kështu që e keni

10 pasur të pamundur që t'i gjurmonit këta persona, apo jo?

11 PË. Po, e saktë.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Do kërkoja që të kalonim në një faqe

13 konkrete, që besoj që jua tregoi Prokurorja. Referenca për të

14 është volumi i dytë i "Siç është parë ashtu është treguar", më

15 konkretisht SITF00001529. Faqja që po shihja më konkretisht

16 ishte faqja 1675 e cila është pranuar si provë materiale

17 P743.2.

18 PY. Shkurtimisht me znj. O'Reilly edhe këtë e keni parë. Pra

19 disa prej këtyre pikave kanë poshtëshënime, disa jo.

20 PË. Po, kështu është.

21 PY. Aty ku s'ka poshtëshënime është se nuk është bërë punë

22 pasuese dhe nuk është hapur ndonjë dosje. Të paktën nga ana e

23 OSBE-së. Kështu?

24 PË. Po.

25 PY. Aty ku ka një poshtëshënim, nëse shohim numrin e

1 referencës për një dosje, çështje, janë këto dy shkronjat
2 nisëtore dhe një shifër. Kjo do të jetë referenca dosjesh për
3 një çështje të OSBE-së, kështu?

4 PË. Po. Po përpiqem që të bëj një pauzë, jo se po shmang
5 përgjigjen tuaj.

6 PY. Ju po e bëni këtë punë më mirë sesa unë. Unë harroj që të
7 ndaloj që të bëj pauzë. Po është në fund të faqes. Pra,
8 GN/GN/0013/99. Pra kjo do ishte referenca, numri dosjeje --

9 PË. Po, dhe është Gjilani.

10 PY. Pra është Gjilani për shkak të shkronjave nisëtore GN?

11 PË. Po, kështu është.

12 PY. Por nëse dikush do dallon -- që ta kontrollonte edhe në
13 mënyrë të pavarur se çfarë ka kjo dosje, cilat janë raportet
14 mbi të cilat bazohet kjo, nuk duhet që të bëhej kjo. Duhej që
15 të shkonit te dosja e OSBE-së, ta hapnit dhe ta lexonit.

16 PË. Po.

17 PY. Dhe këto nuk janë nxjerrë, nuk janë dhënë. Dhomat e
18 Specializuara të Kosovës?

19 PË. Unë nuk e di.

20 PY. Faleminderit, kaq kisha.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Dhe faleminderit që më lejuat që ta
22 kapërcja pak kohën e orarit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
24 z. Ellis.

25 Znj. Dëshmitare, këtu mbyllet dëshmia juaj për sot por jo

1 në përgjithësi. Do t'ju duhet të ktheheni ditën e hënë. Ju
2 kërkoj ndjesë. Për këtë më vjen keq. A është e mundshme?

3 DËSHMITARJA: [Përkthim] Po.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
5 kënaqeni me këtë qytet të mrekullueshëm gjatë fundjavës.

6 DËSHMITARJA: [Përkthim] Unë kam plane për t'u kthyer në
7 shtëpi. A mund ta marr me mend se do të përfundojmë ditën e
8 hënë?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, po.
10 Domethënë të kujdesemi që të përfundojë ditën e hënë.

11 DËSHMITARJA: [Përkthim] Faleminderit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë, shumë
13 mirë. E bëjmë këtu ndërprerjen e seancës deri ditën e hënë në
14 orën 09.00.

15 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

16 --- Seanca mbyllet në orën 16.03

17

18

19

20

21

22

23

24

25